


DRITERO AGOLLI

BIBLIOTEKA

854-1

D 37



Lutjet e Kambanës

Poezi të zgjedhura





B5H-1
D37

DRITËRO AGOLLI

Lutjet e kambanës

Përgatiti

BASHKIM KUÇUKU



BOTIMET TOENA
Tiranë, 1998

Redaktore: Sadije Agolli
Korrektore letrare: Rina Çela
Arti grafik: Irena Toçi
Kopertina: Gëzim Qendro

Botues: Fatmir Toçi

© Copyright 1998: Sh.B.TOENA

ISBN 99927 - 1 - 075 - 6

SHTËPIA BOTUESE TOENA
Rr. "Muhamet Gjollështa", K.Postare 1420
TIRANE

Tel.: (042) 401 16; 401 17

Tel-Fax: (042) 272 32

E-mail: toena @ icc.al.eu.org

Internet: <http://www.toena-al.com>

Më prit se po vij shpejt

Më prit se po vij shpejt

Nëse sëmundja vjen tek unë,
Ju mos më shpini në spital,
Më merrni fshehur e pa zhurmë,
Më ngjitni lart diku në mal.

Atje dyshek e shtrat nuk dua
Dhe as çarçaf e as jorgan,
Por te një çezmë e te një krua
Më shtroni dushk e jargavan.

Ma lidhni kokën me një kulpër,
Ma njomni buzën në burim,
Dhe kur të vijë andej një flutur
S'ka gjë se rri mbi ballin tim.

As infermier nuk dua pranë,
As nevrolog, as profesor,
Të kem përkrah një dash të bardhë,
Të kem përbri një cjav përçor.

Të m'i lëpijë faqet dashi,
Të qajë cjapi laraman,
Ta ulë sqepin shpejt larashi
Me mors të japë telegram.

Të presë plot trishtim fshatari,
Në shkop mbështetur me mërzi,
Duke përtypur fije bari,
Duke këputur kullumbri.

Nga guvë e lisit të moshuar
Të derdhet bleta gjithë zgjim,
Mbi trupin tim e turbulluar
Si lëmsh të sillet me tërbim.

Të ndalet udhëtari i mirë,
Të pijë heshtur një duhan,
Të thotë: mjaft qëndrove shtrirë,
Për ty e gjora rrugë qan!

Dhe, ju betohem, po s'u ngrita
I madh, i bukur, plot shëndet
Dhe rrugës sime nga u nisa
T'i them: më prit se po vij shpejt!...

Zuska botë

Judë e Krisht

*Ma do qejfi, shkoj drejt dhimbjes
Dhe prej dhimbjes ik sërish;
Nisem plot inat mes grindjes,
Kthehem zbutur si dervish.*

*I kanosem ashpër fisit
Dhe përlotur fisin fal;
I penduar shkoj drejt Krishtit,
Ik nga Krishti, bëhem djall.*

*Hesht në prehje, rend në lodhje,
Njëren ndreq e tjetrën prish;
Kur mbledh lule, dua rrodhe,
Guvë e jetës - Judë e Krisht!...*

Nëntor, 1995

Hyjmë dhe dalim

Çdo ditë ne dalim nga dita dhe hyjmë në natën,
Nga nata në ditë, nga dita në natë e mbajmë të hapur kanatën.

Ne hyjmë dhe dalim, udhëtarë të ditës dhe natës ngaherë,
Gjersa përfundimisht të mbyllet çdo kanatë e çdo derë...

1994

^ Njerëzit

Ka njerëz që ecin me këmbë,
Ka që me këmbë shtypën;
Ka njerëz që hanë bukë me dhëmbë,
Ka që me dhëmbë mbytën.

Ka njerëz që puthen me buzë,
Ka që me buzë pështyjnë;
Ka njerëz që flasin me gjuhë,
Ka që me gjuhë ndyjnë.

1991

Moment

Gjithmonë na bren në shpirt trishtimi
Dhe thonjtë në tru na i ngul si bushtër.
Sa i gjatë mjerimi
Në jetën e shkurtër.

Pak e kuptojmë se jemi të ngratë,
Ndaj bëhemi ujqër.
Me thonj të gjatë
Në jetën e shkurtër...

1991

Pak nga pak

Kalojmë një shteg, kapërcejmë një prag,
Çdo ditë udhëtojmë e vdesim nga pak.

Nga pak e nga pak në trup e në shpirt
Diku vetmitarë e diku bashkërisht...

Gusht, 1992

Ankimet

Ankime nga miqtë, ankime nga rruga,
Ankime nga gruaja ime;
Veriu fshikullon, ngre pluhurin juga:
Ankime, ankime, ankime...

Ankime në letër, ankime në gjellë,
Ankime në lopët në fushë.
U çmenda, do të iki të fshihem në shpellë
Të fle pa ankime me një ujk a arushë.

1988

Inflacion në shpirt

Firosje ditësh brenda teje,
Si në inflacion një pare shterpë:
Mëngjesit pije, mbrëmjes dehje,
Mbarim i kohës - varg pa qepë.

Pastaj në rrugë kot së koti,
Një përçafim, një zgjatje dore:
“Ah, ç'bën, si vete, burrë i zoti,
Do kemi shi, a mot dëbore?” ...

A ke parà, a shkon me gratë
Dhe kalli flamën politikës!
E zbrazet jeta, kohë e ngratë,
Mjerim në shpirt dhe vdekje ditësh.

Po ku ta gjesh një shteg për dalje.
Dhe si t'i lutesh Jezu Krishtit?
Ky inflacion s'ka kryq për falje,
Është inflacion i madh i shpirtit.

Dyert

Sa ngrihemi herët nga shtrati
Fillojmë e hapim kaq dyer,
I hap i lumturi, i hap i ngrati,
I hap i heshtur, i hap i rrëmbyer...

I hapim tërë ditën, i hapim tërë jetën
Mos rrimë brenda të ndrydhur
Dhe çuditërisht e shohim veten
Ende të mbyllur...


1991

Në pritje

Në rrugë është vonë e ngrin heshija,
Zverdh hëna në perden e qiellit si buka e misrit;
Në guvën e duarve të mia ndrit shkrepjsja,
Të ndizet cigarja me filtër.

Në guvën e gjoksit më digjet ngadalë,
Kandili i shpirtit;
Pres një grua nga porta të dalë,
Si dita e fundit të vitit.

Ta pijmë tok nga cigarja helmin e hidhur,
Dhe vrerin e verdhë nga hëna,
Mbase kështu do bëhemi pak më të ditur
Në botën e çmendur me shpresa si fletë të rëna...



Qeni i braktisur

Ngre kokën i lodhur prej ecjes,
Përgjunjet në prag të portës dhe ngrin,
Nxjerr gjuhën si flaka e shkrepes,
Dhe këmbët e para lëpin.

Qëndron i mjeruar e kockë e lëkurë.
Dhe gjuha i feks fap e fup!
E shkretë shtëpia e bari i sëmurë,
mes gurëve humb...

Ka ikur i zoti nga vatra me kohë,
Diku në arrati mërgimtar
Dhe qeni kërkon në lagje një kockë,
Dhe kthehet në prag vetmitar.

Vështroton ndonjë mik të shtëpisë së mjerë,
Tund bishtin e zemra i ther.
Kujton pak të zotin që kishte njëherë.
Dhe gjuhën si flaka e shkrepes e nxjerr.

Po ç' thotë kjo flakë, po ç' thotë kjo gjuhë?
Askush s'e kupton, askush nuk e di...
Veturat gjëmojnë e lagja bën zhurmë,
Mbi pragun e portës ngre kokën ai ...

Heshtja

Cigarja u dogj gjer në fund,
Mbi tryezë gjumi më mori,
Në xhamet era perdet s'i tund
Dhe hesht korridori.

Me kokë në tryezë të flesh,
Të shohësh ëndrra të blerta...
Sa ndot!... Të zgjohesh e prapë të gjesh
Në qoshe të vjellat e lëna nga jeta!

1990

I harruari

U volën pemët e ranë fletët
Dhe veriu për dimrin psherëtin me drithmë;
Qëndron një zog i vetmuar në degët
Si një frutë e harruar nga të gjithë.

Po kush do ta ftojë për rrugë të gjatë
Këtë fillikat të braktisur?
Dhe pret ai në degën e thatë
Me vetminë i mërzitur.

1988

Lypësi i kohës

Atij i ikën të gjitha: ditët, javët, muajt e vitet,
I ikën ashtu pa kuptuar sa gati s'arriti t'i shohë.
Ishin vitet e tij, kur njeriu urdhëron, vërtitet e rritet,
Po ikën dhe mbeti pa kohë, dhe thotë: "na ishte një kohë"!

Njeri pa kohë, i zbrazur nga koha që pate!...
Të jesh pa kohë, më i mjerë se të mjerët,
Askush s'të pyet ku shkove, ku vajte,
Atëherë ti bëhesh lypës i kohës që kanë të tjerët.

Ai ushqehet e rron, po rron si kufomë,
Fle dhe zgjohet sipas instiktit dhe normës,
Veçse ka mbetur pa kohë, ka mbetur një qenie pa formë,
Nëse do ta quanim kohën përmasë të formës.

1994

Përpjekje e kotë

Një buketë me lule kërkoj se më duhet.
 Është puna ime se për çfarë ngul këmbë e ç' e dua.
 Plehra dhe leckë përreth. Po lulet?
 Në qiell rrufeja u ndez dhe u shua,
 Pastaj brekushet e reve këputën ushkuret.

Teshat për shitje në kangjella rrugësh tundën e ftojnë.
 Mbi teshat fqinja ime përkulet
 Të vrasë mendjen për çmimet që xhepin ia shpojnë.
 Buketa me lule në tru si gozhda më ngulet,
 Është puna ime, mbase më duhet për zbukurim dhe aromë.

Apo kam qejf buketën me lule ta ble për një grua,
 Që e pata harruar, siç thonë, në kohë e hapësirë,
 Apo t'ia shpie një pisi, që i kam pak para të nëmura hua
 Dhe më duhet ta marr me të mirë,
 Është puna ime se për çfarë e dua.

Një buketë me lule kërkoj rrugë më rrugë,
 E di, qyteti është ngushtë për lule, por më duhen patjetër.
 Fqinja ime mbeti në tesha deri në mbrëmjen e mugët
 Dhe s'bleu ndonjë rraçe të lirë e doemos të vjetër,
 Ndërsa unë? Është puna ime që ende s'po shkoj të ha bukë.

Në kaos sendesh mendja të shkon dhe tek pjata me lugë,
se vetëm zorrët në kaos gjërat e tyre aspak s'i harrojnë...
Tani filloi sërishmi të fryjë rrugëve jugë
Dhe pikat e shiut të pëlçasin mbi teshat që varen lart në ballkone,
Lart të pëlçasin si kakërdhitë e dhënve mbi urë.

Po lulet? Ah, lulet s'e di se ku janë,
Në kaos mbase harrova, a mbase vërtet nuk i gjeta!
Në kangjella ende varen teshat, çarçafë e jorganë,
Me sy kalimtarët hedhin shigjeta
Përmbi tregtarët rrufjanë.

Është puna ime përse për lulet rrugëve mbeta...

Prill, 1995

Pela

Pela do mëz, po kali është i tredhur,
Dhe tjetër kalë nuk ka.
Pela me barrë nuk ka për të mbetur,
Plepin me dhëmbë e ha.

Pela do mëz, po kali është i tredhur,
Me jargë veç vithet ia lan.
Pela bishtin përçjetë e ka hedhur
Si shatërvan...

1994

Zuska botë

Do ndahem shpejt nga zuska botë,
Po keq më vjen për zuskën,
Ndaj mblidhuni t'ju jap një gotë,
Se keq më vjen për zuskën!...

Sa keq më vjen për veten time,
Aq keq më vjen për zuskën,
Të dy ne jemi prej një thërrime
Me botën time, zuskën...

Janar, 1993

Në vendin tim

Në vendin tim e në vendin tënd
E shpojnë lakrën i hedhin mënd.

Në vendin tim e në vendin tënd
Njërit i kruhet e tjetrit i dhëmb.

Në vendin tim e në vendin tënd
Hënën si petull e pjekin në shkëmb.

Në vendin tim e në vendin tënd
Një kokë e çmendur një vend e çmënd...

1992

Ndihmësi i Zotit

O Zot, përmbyste botën mbarë,
Pastaj ndërtoje përsëri,
Themelet hap, hidh gurë e parë,
Se ke përvojë e mençuri.

Po veç një lutje, Zot, kam unë
Dhe gjuhëzuar po të flas:
Ndërtim i botës ka mjaft punë,
Ndaj mua ndihmës merrmë pas.

Na duhet dhe një krah i tretë,
Se puna ndofta tepër zgjat,
Prandaj ti shko dhe zgjidhe vetë
Ndonjë të shquar për argat;

Veç për argat ndër presidentët
Asnjë nga vendi im mos merr,
Se bëhet gjel dhe lart ngre pendët,
Pastaj mes nesh ndez zjarr e sherr.

Dhe kur të dy na kap uria
Në prush të punës plot mundim,
Ai nga mendjemadhësia
S'na sjell dot torbën me ushqim...

Nga vendi im i mirë i vjetër
Mjaftoj veç unë e tjetër s'ke!...
Poet i madh jam, - mend e letër,
Dhe mjekrën tënde di ta kreh;

Po kam një ves, s'e mbaj dot gojën
Për pakëz verë e plot raki...
O Zot, më fal, siç fale Noen,
Kur pinte lakuriq nën shi.

Se çdo njeri i madh, të paktën,
Një ves e ka si trashëgim:
Sarhoshi Noe bëri Varkën,
Shpëtoi një botë e njerëzim.

Ndaj ti më ke për Noe mua:
Përmyse botën, bëje shesh,
Ta ngre dhe Varkën, vetëm dua
Si Noen ndihmës të më kesh.

O Zot, kur fund t'i japësh botës,
Provomë e mua sa më shpejt:
Po ngrita Varkën si të Noes,
Gjeni mbi Noen jam vërtet ...

Dreqi i dreqërve

Kështu ligjëroi para dreqërve, Dreqi i Dreqërve:
“Dëgjoni, vëllezër dreqër, dëgjoni,
Me kockat e thata të pleqve
Do bëjmë ura përrenjsh e parmakë ballkoni,
Dëgjoni, vëllezër dreqër, dëgjoni”!

Më tej zgjati fjalimin Dreqi i Dreqërve:
“Mendoni me gishtin në tëmbthin e kokës,
Do marrim hirin e historisë së pleqve,
Ta hedhim arave, t’ia heqim acidin e tepërt tokës,
Mendoni me gishtin në tëmbthin e kokës”!

Dhe u fsheh Dreqi i Dreqërve hendeqeve...

1993

Guri i Shenjtë

Një ditë plasi Guri i Shenjtë,
S'u nda në dysh, po copë-copë.
Shkalluan njerëzit nga mendtë,
Ah, plasi Guri i Shenjtë!

Nga se? Mëkati a lavdia?
Apo iu hapën brenda zgavrat?...
Pastaj ra shi dhe njerëzia
Kërkuan çadrat...

Ah, plasi Guri i Shenjtë,
Siç ndodh dhe me shkëmbinjtë.
Asgjë! Në pllaja bari mbiu për dhentë,
Fryu erë e lashtësisë nga ullinjtë...

Vjen njeriu i çuditshëm

Nuk mund t'i themi të gjitha gjërat e fshehura kurrë.
 Macja lot me një zog që ka mbytur,
 Qeni kap me thonjtë e tij një kockë në gurë,
 Andej zuzarë e djaj me ëngjëjt përfytur.
 Ndaj s'mund t'i themi të gjitha gjërat e fshehura kurrë.

Nëse mund t'i themi të gjitha,
 Na mbajnë mëri e na shajnë,
 Vjen nata me ankth e mbushet shtrati me hithra,
 Me hithra nervash që kruhen e hanë,
 Ndaj s'mund t'i themi të gjitha.

Për shembull, unë i mbaj rezervat e mia:
 Ç'më duhet t'i them ato që s'i thonë as të tjerët?
 Nuk dua të ketë aq trazira shtëpia,
 Nuk dua të ngrihem me sy të mbufatur mëngjeseve herët,
 Ndaj s'mund t'i themi të gjitha nga pika tek vija.

Nuk mund t'i themi të gjitha gjërat që thuhën,
 Se brinjët e gjoksit ndërgjegjen e mbajnë burgosur
 Dhe dhëmbët s'e lenë të dalë dhëmbëve gjuhën
 Se dhëmbët janë hekura burgu mjaft të përsosur,
 Ndaj s'mund t'i themi të gjitha që duhen.

Do vijë dikush e do t'i thotë të gjitha.
Ai s'do ketë as turp, as brinjë në gjoksin e fryrë.
As ka për t'u trembur nga shtrati i ndërgegjes plot hitura.
S'do ketë as smalt në dhëmbë, as cipë, as fytyrë.
Ndaj s'mund t'i themi të gjitha.

Maj, 1995

Ligjërimi i ujkut plak

Mua ujkun më ndjekin me britma e sharje,
Mua që botës i dhashë vërtet një kulturë,
Mua heronë e përrallave me kurthe, kanosje, hakmarrje
Në vatha dhënshe dhe ahurë.

Sikur mos isha unë, as gjysma e përrallave s'do të ishte
Dhe ndofta s'do të ishte as gjysmë e folklorit,
Se mendja poetëve aspak s'do t'ua priste
Të bënin rrëfime pa bëmat e mua të gjorit.

Ju pyes, a nuk e vlejné përrallat e mia
Një dele të zgjebur që marr diku në një vathë,
Apo një gomar që pëllet nga uria
Me miza në veshët e gjatë?

Po ju, të thinjur në librat e trashë,
Ju, folkloristë, kritikë, poetë e shkrintarë,
Me honoraret që merrni nga bëmat e mia brenda dhe jashtë.
A nuk gëlltitni më tepër se unë mijëra viçer, dele e gomarë?

Lëvizja e madhe

Vrapojnë njerëzit të blejnë, të shesin, të hanë e të shajnë;
 Vrapojnë të nxjerrin fekalet, jashtëqitjen e hedhur pa parë;
 Vrapojnë të shtrihen, të shohin ëndrra, të qajnë;
 Vrapojnë të vdesin,
 Të futen me gojë të mbyllur në varre.
 Mblaçisin mish të therur në shesh, në thetore a shtrungë,
 Mbi mishin tjetër të shtrihen në shtrat a në kashtë.
 Mbi mishin plot epsh të blerë në park, në hotel a në rrugë,
 Mbi mishin e femrave tepër mjerane
 Të vendit me sedër të lashtë.

Lëvizin të gjitha organet e trupit,
 Gjymtyrët e dukshëm, gjymtyrët krejt të padukshëm:
 Lëvizin duart, këmbët, buzët dhe veglat e turp;
 Kafshojnë, përtypen, gëlltisnin dhe ndukin
 Të veshur dhe krejt lakuriqër si pushtër...

Llahtarë! - një gjak me këmbë, gjak këmbësor në arteriet e tokës:
 Të fortë, të dobët, të lodhur, të kuq e të zbehtë
 Me thonj të nxjerrë e me gishta pas kokës,
 Me plot përqaftime, mërira, mallkime,
 Të mbrojtur e fare të shkretë.

Vrapojnë në varg, një nga një, në turmë e rrëmujë
Me sy të çapluar, me veshë plot dyllë, me besë e pa besë;
Vrapojnë me vjersha, me prozë, me filma, me këngë e me kujë

Të mbajtur veç pas të vetmit litar,
Litar që shpesh i themi dhe shpresë...

1996

Mbarim celulash

Vdekja s'u ndahet celulave gri,
Vdesin celulat, - s'merr vesh asnjeri.

Vdekjen e tyre s'e shohim të dy,
S'mundet celulat të duken me sy.

Vdekja s'u ndahet celulave gri,
Vdesin dhe s'duken nga unë e nga ti.

Vdekje të vogla më shpesh e më shpesh!...
Vdekjen e madhe pastaj e merr vesh...

Shkurt, 1996

Një dem nën shi

Bie shi dhe toka rënkon si grua me barrë,
Një dem përtypet nën shelgun lotues mbi plisa,
Një dem i lodhur nga lopët që i mbarsi me farë
Që nesër të dalin nga barku i tyre mushqerra e viça.

Nga hundët e demit shpërthejnë dy vazhda me avull,
Dy tuba kazani nga dalin tymra të nxeh të...
Vërtet ky dem i tëri zjen si kazani shpatull më shpatull
Nën shelgun që rrjedh nga shiu i rrebeshtë,

Dhe unë që andej nga kolibja ime me kashtë të thekërt
Demin vështroj tek përtypet i ngathët
Dhe mendja më shkon në mushqerrat e viçat e nesërm
Që vijnë pa njohur atin e tyre trim e të pashëm.

Bie shi dhe toka nga barra zë dridhet
Dhe demin nën shelg përhumbar hap gojën e madhe...
Qyqari s'e di që nesër për majmje do tridhet,
Se mjaft është ligur tek mbarsi lopë në oborre e livadhe.

Megjithatë nuk është e keqe jeta

Megjithatë nuk është e keqe jeta,
I fryjnë buzët xhezvet me kafë,
Largohet miku: “Rrofshi, mirë ju gjetsha”!
Dhe bulkthi bën kri-kri nën sixhadë.

Një tullumbackë e kaltër fryrë e ngrehur
Në bredhin e Krishtlindjeve pëlçet
Nën strehët mackën një maçok ka zgjedhur
Dhe merret me dëfrim të madh e seks...

Ndaj them vërtet se jeta është e bukur,
Mos qesh me fjalën “bukur”, miku im!
Po natën ç'bën kjo ëngjëllushe flutur,
Pse veten djeg rreth llambës pa kuptim?

Dhjetor, 1995

Peizazhi i rrugës

Vështroj nga dritarja tek rruga fundoset në vapë,
 Tek ecën një djalë i vogël nga dielli përzhitur,
 Tek ngjit të përpjetën e gjatë
 Dhe krahët tund si degë e kokën mban ngritur.

Ec, o djalë i vogël, i djegur nga gushti,
 Ec e rrugën e largët si pelë zbutë,
 Si pelën me qimet e ngjyrës së prushit,
 Zbutë dhe grykës së gjelbër të malit fute.

Këtë po ta them se rruga fëminë e bën burrë,
 Siç bën fluturimi zoçkën e turtullit turtull;
 Këtë s'e harroj në jetën e ashpër kurrë,
 Në rrugë njeriu gatuhet me vaj e me uthull!

Rruga ngarkuar nga vapa zgjatet e zgjatet,
 Ecën djali i vogël e lisat e ndjekin,
 Me hijet e tyre hija e trupit të tij matet e çmatet
 Dhe degët e tyre pëllëmbët e gjelbra përpjekin.

Ç'i thonë djalit degët dhe zogjtë, ç'i thonë?
 Ç'i thotë çezma që ngriti një murator i paemër?
 Ec, ec, ec, se nata vjen vonë,
 Ec, ec, ec, se dita të jep, si vajza e bukur, zemër!

Revoltë ndaj pagjumësisë

S'ia dua asnjërin pagjumësinë,
 E mira nga kjo drejtë semundje s'del:
 Jam i pagjumë e natën kam vetminë
 Jam i pagjumë i madh si kriminel.

Pagjumësinë, thiken, revolverin
 I ka tri armë ndofta çdo kusar:
 Këto tri armë trembin, vrasin, therin
 Paçka se njëra s'nxjër as gjak, as zjarr.

S'ido mend në luftëra vlen pagjumësia
 Për luftëtarin fshetur në hendek
 Dhe për atë që heq mbi harta vija,
 Që shpesh i themi gjel apo strateg.

Pagjumësia rri me peshkatarin
 Që rrjetat hedh e pret me ankth në det,
 Apo me konstruktorin dhe shkrimtarin,
 Që natën gdhijnë e nata shpesh i vret.

Por unë flas për tjetër gjë me miqtë,
 Për kurthet që pagjumësia sjell:
 Të vete mendja drejt në ligësitë,
 Kur zgjuar errësirën e përcjell.

Dhe miqve haptazi u them ta dinë,
Se ligësirat mpleksur lesh e li
Më shfaqen kur jetoj pagjumësinë
Dhe fillikat në tryezën time rri.

Dhe unë i bindur jam se sundimtarët
Pagjumësinë e çmonin si tabor,
Për kurthe mblihdnin natën oborrtarët
Dhe natën helmet fshiheshin në oborr.

Ndaj asnjëri s'ia ndjell pagjumësinë,
Të mira nga kjo drejt sëmundje s'pres;
Jam i pagjumë i madh, jam me vetminë
Dhe natën orët njoh si një këndez.

Shkurt, 1996

Vitin tjetër

Po majmen retë mbi male përditë,
Sivjet do kemi një dimër të ftohtë...
S'ka gjë! Do bëjnë vitin tjetër lajthitë,
Do bëjnë dhe thanat dhe stonjtë.

Dëgjoni të diturin ç'thotë:
Sivjet do kemi dëborë dhe ngricë...
S'ka gjë! Më shpejt do na rriten thonjtë,
T'i çjerrim njëri-tjetrit turinjtë!

Nëntor, 1992

Lypsarët

Mbi luspa bananesh e mollësh flenë lypsarët.
 Si buste idhujsh mbi krye koshat me minj e me plehra u rrijnë;
 Këndojnë xhamive duvâ për Allahun e madh hoxxhallarët,
 T'u sjellin në mend Arabinë.

Mesnata bashkë me lutjet dërgon të qelburat erëra,
 Përmbi endacakët e pistë lypsarë.
 Tek flenë i shohin në ëndërr koshat me plehra,
 Të mbushur plot me dollarë.

Dhe minjtë mes ëndrrash në viça kthehen,
 Në viça të majmë e në dema të majmë...
 Lypsarët buzët lëpijnë e mjaft mallëngjehen:
 "Të kemi një viç e një dem, mish viçi e demi të hamë"!

Ndërsa hoxxhallarët i bëjnë Allahut duvâ në xhamitë,
 Që zemrën e vet e bën për shqiptarët kurban si dashin te pragu:
 "Evlatë lypsarë, flini të lumtur, se minjtë,
 Në viça e dema shpejt do t'i kthejë Allahu.
 Që Evropën ta kapim si motër për krahu"!

Rosat e buta

Rosat futin sqepin dhe kokën në baltë
E llokaçitin në llucën e trashë si pelte,
Pastaj lëkundin trupin e majmë si gjalpë
Dhe ecin njëra pas tjetrës nën gjethe.

Kokën s'e ngrenë mbi llucë,
Kokën nën llucë e mbajnë,
Kërkojnë brenda me sqepin si lugë,
Se duan të venë dhjamë...

Paçka se shpezët e tjera maten me retë!
Rosat e buta gërmojnë batakun
Dhe ulin kokën dhe janë modeste
Dhe s'prishin qejf me rosakun...

Kufoma

Vdiq dhe u bë i vërtetë,
U kthye në send, në kufomë;
Kufoma - ky send i llahtarshëm, i zbehtë -
Nuk flet as me sy, as me gojë.

Vdiq dhe u bë i vërtetë,
Vërtetësisht i shtrirë në dhomë...
Kufoma s'ka gojë e sy të gënjeshtërt,
Kufoma - krejt e vërteta e vonë...

1994

Rastësitë

Në supin tim papritur erdhi të ulej një flutur.
Një sup të tillë kjo flutur ç'pati që zgjodhi?
Të thuash se ishte një sup i bukur,
Gjepura! Kjo duhej të ndodhte dhe ndodhi!

Shumë gjëra s'dimë pse ndodhin në luftë a në paqe.
Për shembull, s'të zuri mes luftërave plumbi,
Në paqe të vjen një grerëz, me thumb të thumbon në faqe
Dhe ti, që s'vdique nga plumbi, vdes një ditë nga thumbi...

Shkurt, 1996

Një botë tjetër

Ndodh shpesh të jesh i dëshpëruar
Dhe shpesh të heshtësh tek një gotë,
T'i flasësh gotës nëpër duar:
"Sa pak të mira ka kjo botë"!...

Dhe sytë e tu t'i ulësh poshtë
I vrarë i shtypur prej mërzisë,
Sikur kërkon një tjetër botë
Aje në fundin e rakisë.

Kërkon, kërkon me sy të tretur
Në gotën plot, ku ndrit një valë;
Kujton se bota është e fshehur
Dhe pret se ndofta mund të dalë...

1996

Gjëra të thjeshta, por të dobishme

Një shkop, s'ka rëndësi si të jetë, i lëmuar a mbushur me gunga,
 Është i vlefshëm gjithmonë e veçanërisht për qorrat.
 Por domosdo u duhet topallëve të lodhur nga rruga,
 U duhet dhe njerëzve të ndershëm të mbrohen nga horrat.

Një shkop, s'ka rëndësi si të jetë,
 Mbase i duhet çdo njeriu në portë a në arë,
 Se ka nevojë të ruhet nga sqinji i keq kokëshkretë,
 Apo, të themi, nga qeni i zgjebosur i marrë.

Një shkop, s'ka rëndësi nga pamja, i ndotur qoftë a i bukur,
 Është i dobishëm, thjesht edhe për gjëra të tjera,
 Fjala vjen, të shkundësh thesin me pluhur,
 Ose, kur s'ka buton elektrik, të trokasësh tek dera.

Një shkop, sido që të jetë, i lypset në rrugë policit,
 I lypset hetuesit qelive plot lagështi të burgut.
 Një shkop e mbante pas dhe Shën Pjetri, apostulli i Krishtit,
 E mbante Homeri qorr nën diellin saç në viset e Jugut.

Shkurt, 1996

Plazhi

Ç'që kjo hata e madhe që bëre, o Plazh?
 Të gjithëve rrobat si fletët e pemëve ua hoqe,
 I le lakuriq, i shtrive në shesh pash më pash
 Dhe qetë-qetë në skarën tënde të nxehtë i poqe!

Ja, ky i zynti zyrtar plot mish e plot tul,
 Ujk i vjetër, me njerëz në jetë i thekur,
 Skuqur i tëri dhe bërë nga djersa qull,
 Mbi prushin e rërës platitet si pite e pjekur.

E kush mund ta piqte atë më mirë se ti,
 Ta guduliste në kofshë me rërën e imët,
 Ta bënte të qeshte, ta kthente në bri,
 Ta shtynte pastaj të tregonte në gjoksin e majmë qimet?

Ja, kjo damë e rëndë që sytë nën diell s'i hap,
 Kjo damë që rrugës kokën ta priste me jataganin vetull,
 E zhveshur vjen rrotull në hellin e rërës si shishqebap,
 Si shishqebapi lëng lëshon nën qafë e nën sqetull.

Ja, ky shoku im në rërën e lagur na hapka një pus,
 Ky shoku im, që Drinin si kaun në Koman e mbreu,
 Tani të duket vërtet kolopuç,
 Që lot me fëmijët me kulla rëre e dheu...

Ja, unë me sedër, i urtë si shenjt e dervish,
 Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve,
 Hidhem përpjetë se rëra më futet në mish,
 Rëra që djeg si prushi i ahishteve...

Ja, një poet që kokën me vjersha mban lart,
 E uli kokën në rërë e me rërën mundohet;
 Kurrizi iu dogj e qan e s'thur dot një varg
 Dhe gruaja lëkurën ia lyen me kos, t'i shërohet.

Çudi si iu dogj kurrizi këtij poeti madhor,
 Kurrizin s'ia dogji kritika kurrën e kurrës,
 Bile e lëmoi me pomada studimesh përmbi kraharor.
 E lëmoi që t'i ndriste përherë cipë e lëkurës!...

Po ç'që kjo hata e madhe që bëre, o Plazh?
 Të gjithë i vure t'i nxjerrin sheshit lëkurët e tyre,
 Lëkurët e njëri-tjetrit t'i shohin plot gaz,
 Në trupat e njëri-tjetrit të shihen si në pasqyrë!

Fëmijë u bëmë me gra, me burra, me pleq
 Dhe gradat tona nuk duken mbi skarën tënde të nxehtë.
 Të gjithë i përkulemi diellit që sytë nga ne s'i heq.
 Të gjithë u bëmë papritur pak mendjelehtë.

Mendjelehtë vërtet, po vetëm një çast, një çast!
 Sikur me nxitim të lidhim kravatat e rrobet të veshim.

Pastaj llafosemi bashkë në daç,
Pastaj ta shohim si qeshim!

Ç'që kjo hata e madhe që bëre, o Plazh?...

1981

Me një prift në tavernë

Në një tavernë atje në Romë,
Më hodhi era tek një prift,
E donte prifti Ciceronë,
E pinte verën latinisht.

Dhe duke ngrënë e duke pirë,
Më tha mos isha katolik.
Por ndodhi prift vërtet i mirë,
Ndaj s'desha të isha unë i lig.

Ia ktheva butë e qetë-qetë:
"Kjo vera qenka si balsam,
Këtë e duan gjithë fetë,
E do dhe ndonjë mysliman.

I kam të parët katolikë,
I kam të dytët bektashinj,
Dhe unë i treti asnjë çikë,
S'besoj në shpirtra dhe qirinj.

Se m'u mërzitën gjyshërit shumë,
Që fetë i kthenin mot për mot,
Ndaj hoqa dorë i shkreti unë,
Nga çdo besim e nga çdo zot..."

Po prifti foli tepër vonë
Dhe ndofta tepër rastësisht,
Si recitoi pak Ciceronë,
Si mërmëriti latinisht:

Në sytë i feksi një shkëndijë,
Iu drodh dhe gjer në fund iu fik.
Dhe qeshi çiltër si fëmijë:
“Gjynah që s’qenke katolik”!

Me sy kërkova tinëz derën,
Kur prifti thirri: “Mos, or mik!...
Megjithatë ta pijmë verën,
Në verë qenke katolik!”

Harroi një çast për Ciceronë,
Harroi të tjerat, sigurisht...
I madhi prift me Dritëronë
E pinin verën latinisht...

1993

Përmes vreshtave

Çdo njeri që ka kaluar
Anës vreshtave me rrush
Goja lëng i ka lëshuar,
Buza flakë e gjuha prush.

Edhe unë ndalem pakëz,
Hyj në vreshta dhe s'dal dot!
Ç'më rrëmbyet përmes flakës
Ti, kallmet, e ti, merlot!

Punë e madhe se thur vjersha,
S'kam qeder se jam poet,
Me lëng rrushi nëpër vreshta
Le të bëhem për ibret!

1983

Shakatë e dimrit

Në shtratin e ftohtë e të lagët në dimër
S'kam mall të shfletoj një Kuran a një Bibël.

Kuranin dhe Biblën që mbahen nga bota
Profetët i shkruanin në vende të ngrohta,

I shkruan pa dimra, ku flihet pa brekë,
Ku s'ka as jorganë dhe s'ka benevrekë.

Ndaj unë i mbëshujellë me rraqe në dimër
S'kam mall të shfletoj një Kuran a një Bibël.

Do desha të futej në shtrat Perëndia,
Ajo të ma ngrohte, të shkoja të flija;

Pastaj Perëndisë provimin në dimër
Ia jepja me qejf për Kuran a për Bibël...

Janar, 1991



Shpresa e thyer

Kjo natë e gjatë

*Më tremb kjo natë e pagjumë,
Më duket sikur diçka do të ndodhë,
Kjo natë pa fërfërimë e pa zhurmë,
E qulltë, e ligavectë si bollë.*

*Të paktën një bulkth të kish kërkërirë,
A fundja të kishte kukatur një kukuvajkë
Nën strehët ngjeshur plot errësirë,
Ose në plepat e fjetur kavakë.*

*Apo mbase më mirë do të ishte
Të binte një zjarr këtu në mëhallë,
Kjo natë si bollë e zezë pakëz lëkurën ta ndriste
Dhe unë i shkundur nga ankthi të dilja në shkallë.*

1990

Një shkrepse

Ndizmë, vëlla, një shkrepse
Nën qiellin e zi,
Një shkrepse të brishtë shprese
Në errësirën me shi.

Në errësirën e dhjamur si pelte
Kur pritet të zbresë acar
E dini ç'do të thotë një shkrepse
Një fije e hollë si bar?

Peizazh i mjerë

Mbi pellgjet me letra dhe gurë
Qielli vjell tym,
Dhe hënë e sëmurë
Gëlbasë pështyn.

Kolliten muret e ftohta
Në muzg...
Hesht koha
E mbyllur në burg.

Dijetor, 1989

Ta shtyj natën

Po si ta shtyj me bërryle natën
Që më mbështjell me lesh të zi,
Të hap një shteg, të çaj mbi baltën
Dhe larg të nisem në arrati?

E dua jetën si dy sytë.
Me bërryle natën si ta shtyj?
Të dal nga leshi i saj i dylltë
Dhe prapa shpinës të pështyj...

1995

Tymi i ditëve të djegura

Më dhembin kapakët e syve nën vetulla,
Më shpojnë nga tymi i ditëve të mia të djegura,

Më djegin nga pluhuri që ngritën këmbët e viteve
Tek i përplasën potkonjtë në rrugë vrapimeve.

Është tymi i ditëve të djegura dhe s'është i pyjeve,
Është pluhuri i viteve bashkë me hirin e yjeve...

Ah, sa ditë kam djegur të ngrohesh m'ëzitur prej ngricave,
Ndaj tymi i tyre sytë m'i shpon me majat e spicave!

1995

Pelegrini

Unë jam prej kohësh pelegrin,
 Udhëtar në vendin e shpresës së thyer,
 Jam ndarë padashur nga karvani im
 Mes shtigjeve nga vapa e shirat gërryer.

Kërkoj karvanin tim në rërë e në shpat,
 Karvanin që e ka ndërruar drejtimin me kohë,
 Ndaj në udhë jam krejt i humbur, jam fillikat
 Me shami të grisur lidhur në kokë.

Për ujë buza ime u dogj, u bë zhur
 Dhe sytë më shpojnë nga shterja e lotit
 Më duhet të arrij karvanin e tretur qëkur
 Çapitur mes vapës, mes shiut e të ftohtit.

Unë jam prej kohësh pelegrin,
 Shtegtar i karvanit të humbur
 Dhe bart në kurriz një premtim
 Të dhënë në hirin e gjyshërve të mundur.

tetor 1991

Kuajt e erës

-Baladë-

I solli Marsi kuajt e erës
Dhe ne shaluam dy:
Banket i shtruar i pranverës
Të priste bujshëm ty:

Po rrugës kali yt theu këmbën.
S'arritëm dot në vend.
T'u grisën ëndrrat e t'u shembën
Si këmbë e kalit tënd.

Atje banketi i pranverës
Na priti sa u lodh...
Sa keq që kali i murrmë i erës
Ty nuk të shpuri dot!

Ç't'i bësh! Kështu na thyhen shpresat,
Nuk kemi fat të dy!
E di, më ndjekin mua tersat,
Të marr më qafë dhe ty!...

Para fatit

Të njëllojtë para fatit s'dalim
Dhe njëlloj as rrugën nuk e nxjerrim,
Fati njërit i dhuron veç kalin,
Tjetrit edhe kalin, edhe frerin.

Edhe unë e njoha fatin herët,
Nga kjo njohje sofra pati bukë,
Veçse më dalloj pak nga të tjerët:
Më dha kalë e fre, më la pa rrugë...

Pritja e diçkaje

Çdo gjë është e shkretë, e thatë, si drizë,
Në tokë asnjë gjeth, vetëm kashtë,
Në qiell asnjë zog, asnjë buburizë,
Në lumë asnjë rosë, asnjë zhabë...

Në fushë as erë, as shi, as ngricë,
Në shpirt gërvisht si miu pikëllimi,
Ndaj dua dhe pres një ditë
Të nisë çdo gjë nga fillimi...

1991

Gri

Shumë ujë gri, shumë qiej gri,
Gri në dritare, gri në vetmi,
Ikin lejlekët larg në arrati,
Shumë ujë gri, shumë qiej gri.

Pikojnë strehët melankoli,
Shumë strehë gri, shumë pika gri.
Postier përtaci vjen në shtëpi
Me pallto gri, me letra gri.

Hesht pas dritares maçoku i zi,
Gazeta hapet me tituj gri,
Gri në dritare, gri në vetmi,
Ikin lejlekët larg në arrati...

1991

Idhulli i rënë

Vdiq dhe lypsari më i madh i Tiranës,
Që mbante Tre Qentë e zinj si gorilla
Në qoshen e lumit të turbullt të Lanës,
Ku hidhen kutira LM-je, DASH-i, prezervativa.

Tani s'do mblidhen së bashku Tre Qentë,
S'do flasin më gjuhën qenore rreth tij duke ngrënë,
Mbaroi uniteti i çeliktë përjetë,
Njëherësh të tre s'do lehin në hënë.

Lypsari, idhull i tyre, ka rënë!...

1995

As prehje nuk gjen

Me sa duket nuk bëj për të sotmen.
Në të sotmen unë pakëz kam vend:
Në çdo gjë e shoh lodhjen dhe ftohjen
Dhe çdo gjë më mërzit e më çmend.

Në të nesërmen mendja ka shpresë,
Në të sotmen as prehje nuk gjen;
Por e sotmja nuk është banesë,
Me një tjetër tani s'e shkëmben...

1994

Këmborët e çara

Nga vjen ky shi nën qiellin lara-lara?
Kam mbetur një bari pa kërrabë tek një stan.
I kam këmborët e dhenve të mia të çara
Dhe gunën me vrima e kam.

Nga vjen ky shi nën qiellin lara-lara?

Trishtimi

Po iki me trishtim i zhgënjyer nga miqtë,
E mbylla dhe derën që rrinte e hapur
Për lajkatarët, për rrenacakët e smirëzinjtë,
Që shireshin engjëj të dashur.

Ku vete, s'e di, veç s'dua të kthehem
Sërishmi në rrenat e jetës;
Diku në një skaj të largët do prehem
Me qafën e futur në jakën gri të xhaketës.

1991

Natë në rrugë

Në ecje i grisëm këpucët dhe mëngët,
Na dhëmbin nga udha kockat,
S'dëgjuam zogj, kur na mpiheshin këmbët,
Dëgjuam vetëm bretkosat.

Për dreq, u mësuam me këtë këngë,
Këngë bretkosash e mjerë,
Plot dhimbje dhe brengë
Anës lumenjve në zheg, në shi dhe në erë.

Sot pasdite

Sot pasdite dua të vdes.
Më bëni gati pa dalë yjtë,
Gjeni shaminë e ma lidhni gojën,
Mos harroni të m'i mbyllni sytë...

Mos ngjitni nekrologji me vija të zeza
Dhe mos ftoni farefisnin dhe miqtë,
Askush mos mbajë fjalim në varreza,
Mos qajnë e mos lavdërojnë të ligjtë...

Tharja

Unë jam tharë si trari në hijen e murit,
Jam tharë në hijen e trishtimit,
Por do kthehem tek ti, kur të ngrihesh prej gjumit,
I rraskapitur krejt prej mundimit.

E di, asgjë s'ke ç'të bësh tani jam i tharë,
Një penë zhveshur prej gjelbërimit,
Megjithatë pak nga lëngu yt kam për të marrë
Unë, ky tra i tharë nën murin e njerimit.

prill 1991

I vetmuari i largët

Udhëtoj i vetmuar luginës,
Pantallonat m'i lag vesë e natës,
Pas një reje më ndjek hëna tinëz,
Vajzë e turpshme që prapa kanatës;

Nën një shpat vezullon një dritare
Fillikate si hëna dhe unë;
Ah, sikur të më thonë: "Udhembarë,
Ktheu të flesh se je lodhur aq shumë!"

Regëtin dyshek i luginës,
Rruga dergjet me gurë e me baltra,
Pas një reje përgjon hëna tinëz,
Në zgërbonjë vajton kukuvajka.

1991

Një kalë i bardhë

Kur dielli rrinte heshtur në kupën e qiellit,
Një kalë i bardhë kalonte ledhë
Dhe ngrinte kokën mes luleve të diellit
Një kalë i bardhë mes arës së verdhë.

Nga vinte ky kalë e ç'donte ky kalë
I ndarë nga kuajt e tjerë?
Mos donte prehje të gjente vallë
Larg nga karrocat e botës së mjerë?

Me ndershmëri

Dhe kur njeriu nuk ndien as mall, as brengë, as dhuimbye,
Nuk ndien as gaz, as hidhërim, as shpresë,
Një gjë ju them me ndershmëri dhe bindje:
Lëreni të vdesë....

1986

Në kënetë

Këneta fle si truri i lodhur shumë
Dhe herë-herë e zgjon diçka e fshehtë.
Pastaj sërish fundoset krejt në gjumë,
Fundoset domosdo si një kënetë.

Tek fle nën bark e gudulisin peshqit
Dhe duket sikur qesh një qenie e trashë.
Të shëmbëllen nga larg si leshi i qelqit,
Ndërsa nga afër zien si truri i kafshës.

Në bark miliona jetë i bëri torfë,
Miliona jetë u lindën dhe jetojnë,
Ndaj truri i saj, megjithëse i amorftë,
Lëviz dhe shpesh trazon dhe gjumin tonë.

Shkurt, 1996

Shpirti

Eshtë natë dhe dhoma u fundos në errësirë,
E vetmja dritëz u venit dhe u shua;
Tani për asgjë s'kam dëshirë,
U drodh çka ishte e shenjtë për mua.

Veçse ka mbetur si mall e kujtim i hershëm
Dhimbja për hirin e të dashurve në varret,
Ndaj në gërmadhat e shpirtit tim të djeshëm
Ende digjen e tymojnë zjarret...

1991

Njeriu dhe koha

*U ngrit një re prej pluhuri
E purpurt, e keqe, si unë...
E Sollogub*

Vërtitet një re e zezë mbi botë,
E zezë si unë;
Leh natën një qen i tërbuar nën portë,
Tërbuar si unë.

Zvarritet një gjarpër nga tokë e vithisur,
Një gjarpër si unë;
Kalojnë në shtigje plot njerëz të krisur,
Të krisur si unë.

Lëkunden në qoshet e rrugëve kurvat,
Lëkunden si unë;
Bërtasin lypsarët si kafshët në guvat,
Në guvat si unë.

Kërcejnë majmunët në pyjet e xhunglat,
Majmunçe dhe unë;
Jeton botë e çmendur me vallet dhe plumbat,
E çmendur si unë.

Tmerrohet njeriu, kur lind Mbinjeriu.
Tmerrohem dhe unë;
Kur vdes Mbinjeriu, merr zemër fatziu.
Marr zemër dhe unë...

Nëntor, 1995

Në gërmadhë

Çdo gjë e rrënuar e çdo gjë gërmadhë,
Gërmadhë në rrugë e gërmadhë në shpirt,
Vajton kukuvajka, vjen korbi vërdallë,
Çdo gjë e rrënuar e çdo gjë gërmadhë.

Çudi! Në gërmadhë cicërin harabeli:
Miss Albania, Albania Miss!
Ndërsa veç një vrimëz e ndritur nga qielli,
Çudi! Në gërmadhë cicërin harabeli!

1992

Mëngjes i lodhur

Qëndroj i lodhur shumë
Mbi urën me qemer,
Agim i kuq në lumë
Përgjakur zjarr po merr.

Rënkon luginë e mjerë
Tek era fryn në breg,
Unë kokën time prerë
E shoh me gjak në pellg...

1991

Pritja

Gjysma e qiellit me re dhe gjysma tjetër e kaltër.
Këtë harmoni shkrepëtima e prish.
Gjysma e shpirtit e ngrirë dhe gjysma tjetër e vakët
Dhe në gjoks një ankth si iriq.

Ndaj sot nuk do shkojmë kurrkund,
As në koncert, as në park, as në varre;
Ti shko në dhomën tjetër dhe mbesën përkund
Dhe unë po ndez një cigare.

Mbase kujtohet im bir arratisur në botë
Dhe prish heshtjen e dhjamur mbi telefon!
Ah, kjo cigare që pi është e fortë,
E ndiej kur në gjoks më shtrëngon.

1992

Ëndrra e prerë

1.

Mos vdis, se pas shirave arën e mbushi bari,
Ka rënë në ullishte mizë e ullirit
Hardhia duhet spërkatur shpejt me gurkali
Dhe ende s'ka dalë nga plisi kërcelli i misrit.

Ne ëndërronim të bënim një anije,
Kurrkush s'e mendonte me ç'dru do ta ngrinim,
Kishim ndërmend ta ndërtonim me degë hardhie
Dhe vela t'i vinim,

Bodrumet e saj t'i mbushnim me poçe me verë
Dhe të lundronim në ishujt e Havajës,
Ta pinim verën me vajzat e ishujve në belvedere,
Zezaku të bënte fresk me fletën e palmës.

2.

Mos vdis, se kalit i ra vrapim një patkua
Dhe nisi ta ngrerë nga dhembja këmbën e parë,
Kërkojmë patkonj e s'na jep njeri hua.
S'e gjejmë as nallbanin e marrë.

Ne ëndërronim të shkonim në hipodromë
Në vende të lumtura ku munden me kuaj.
Tani dhe kali çalon e s'e ha barin e njomë;
Me sytë si gota na sheh si të huaj.

3.

Mos vdis, se dielli në oborr e ka shtruar sofrën e madhe
Dhe presim të vijnë vajzat të gjitha,
Të gjitha ato që ti u thoshe "sorkadhe"
Kur grisinin fustanet në driza.

Mos vdis në dhomën e heshtur i shtrirë,
Eshtë turp kaq shpejt të rrih e të vdesësh.
Ne ëndërronim një vdekje pak më të mirë:
Duke vdekur fytyrat tona t'i shihnim në pikën e vesës.

E sotmja

Prapa s'kthehem nga rruga,
Le të më presin mundimet e tmerrshme,
Le të më therë me brisk veriu dhe juga,
s'dua të rroj me të djeshmen.

Le të më joshte e djeshmja nga cipë e fildishtë.
Për të aspak s'do më merrte të qarit;
Më mirë e sotmja e hiçit,
Se e djeshmja e arit...

1994

Pendim i vonuar


Pushuan në Ishullin e Madh këmborët:
 U bë përbindësh një xherah papritur.
 Me njëri-tjetrin flisnin në ankth banorët
 Në vrima skutash duke murmuritur:

- “Na vuri poshtë keq ky qen bir qeni,
 Po vret e pret, sfilit e bën të vetën...
 Nga doli ky? Ku vallë i fshihej helmi,
 Që na helmon me ditë e natë jetën?”-

Më plaku në Ishull foli qetë-qetë:
 - “Xherahun e harruat? Bashkë e qeshnim,
 Kur me shaka synet i bënte djemtë;
 Tani në doni, talluni me helmin!

Xherahun e harruat? Vallë a s’ ishte
 Ai që thoshte: “shpejt do bëhem lider
 Në Ishullin e Madh me kallamishte”,
 Ndërsa ne qeshnim dhe mblaçitnim pitet.

Ne qeshnim kur xherahu mblidhte horrat
 Dhe digjte kallamishtet dhe të mbjellat.
 I thoshim shakaxhi dhe zbraznim gotat,
 Kurse xherahu turrej nga këshjtjellat?!...-



Mjegulli i dashurisë

Mundja e Lekë Dukagjinit

1.

*Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin
E fjalë këmbeva në malet me fletë,
Po Lekë Dukagjini ishte trim e bir trimi
Dhe s'mundej dot lehtë...
Po Lekë Dukagjini nuk ishte Leka i Lecit,
Që bën njëqind lëshime në punë;
Lekë Dukagjini i rrepti i të rreptit
Ma tundte para syve kanunë
Dhe gjëmën lëshonte si shkëmbi kur bie në përrua:
“O mbaje gruan kështu si them unë,
O lëre gruan, se s'je për grua!”*

2.

*Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin
Me gjyshin tim të nderuar;
Dhe pritë njëri-tjetrit i ziuim
Në malet me shkrepa mbuluar...
Dhe unë herë-herë i bëja lëshime
Dhe ty të munda dhe brënda të mbaja
Dhe jetën ta mbushja plot hidhërime;
Sus!*

me zërin e egër të shaja,
Se Lekë Dukagjini ma tundte kanunë
Dhe gjëmën lëshonte si shkëmbi kur bie në përrua:
“O mbaje gruan kështu si them unë,
O lëre gruan, se s’je për grua!”.

3.

Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin,
Se donte lëshime nga unë.
Pritë në male njëri-tjetrit i zinin,
Ai mburrte kanunë, unë shaja kaniunë.
“Eh, gjysh, ti je hedhur për gratë në flakë,
Po pse në kanun i ke sharë?”
Eh, gjysh, ti gruan tënde s’e ke dashur pakë,
Pse mua që e dua më quan të marrë?”

4.

Një ditë kanunin ia mora nga dora
Dhe copë ia bëra mes malesh të lartë.
Iu drodh ajo mjekër e bardhë dëborë
Pas çetinës së lashtë...
Dhe unë thirra:
E munda Lekë Dukagjinë!
(Natyrisht e munda kanunë;
I heq kapelën për trimërinë;

Ka qenë trim si furtunë...)
Ti, grua, më pyete e sytë të ndrinin,
Më pyete ngadalë mënjanë:
“Vërtet e munde Lekë Dukagjinin?”
Dhe unë të thashë: E munda, po sytë ç’më panë!

1967

Që rrinte në bankë
me penë në dorë,
Me kokë mënjanë,
me sy në fletore,
Që nuk i pëlqente
aspak gjeometria:
Figura, figura,
figura e vija!
...Dhe ja, unë i vojtur,
dhe ja, unë i rritur,
Te porta e shkollës,
nga kali kam zbritur,
Me flokë mbi ballë,
tridhjetëvjeçar,
Më njeh ti, prashitës,
më njeh ti, rojtar?
Jam unë ai çuni
me xhybe të murrinë,
Që shkoja rrugicës
i zbathur, pa zhurmë.
Ç'u bë ajo çupa,
dikur, aq e qetë,
Me fjongo të gjelbër,
si gjeth, në gërshetë?
- Sa ujë ka shkuar
nga malet në det,
Kujton se një fjongo
e gjelbër të pret?

Dhe qeshën dy burrat:
prashitës, rojtar.
Pse bëhem fëmijë
tridhjetëvjeçar?
Ku dinë njerëzia
se ku do të jetë
Ajo, që kish fjongo,
dikur, në gërshetë!?

1959

Si shiu

Më prit se një ditë do vij,
Në shkretëtirën tënde atje,
Do vij si një shi,
Veç pa gjënim e rrufë.

Do vij dhe barin tënd do ta lag,
Barin e vyshkur në shpirt,
Po duhet ta dish që jam larg,
Ndaj pakëz më prit...

Malli i parë

*O ti që largohesh nga vatra e parë,
E di se vatra ndez mallë dhe zjarrë?*

Në bulevard qëndroj një çast i heshtur
Përballë apartamentit tim të vjetër.
Dritaret anembanë janë ndezur,
Atje ku sot i lumtur rron një tjetër.

Ngjatjeta, byrazer, i them me vete
Nga larg duke shikuar në dritare.
Nga pemë e trotuarit vjen një fletë
Dhe bie në jakën time me kollare.

Sa vjet jetova qetë dhe me zhurmë
Këtu ku janë ndezur sonte dritat!
Poema e artikuj shkrova shumë
Dhe dasmë bëra dhe fëmijë rrita!

Pa gjumë gdhiva netët herë-herë,
Menduar mbi fletore e mbi libër
Dhe prita miq, kur ndalën te kjo derë,
Dhe prita miq pa lodhje dhe pa qibër.

Dhe ç'pata shkruar e lexonin miqtë
Të urtë, shamatorë, kokëshkretë...
Gëzoheshin, thartonin dhe turinjte
Dhe thoshin: "Presim vargun e vërtetë"!

Dhe kushedi sa herë mora rrugët
Me ta në gjithë Shqipërinë time!
Në djall kuzhina, pjatat, kupat, lugët,
Ta gjejmë vargun tok në udhëtime!

Po përsëri me libra dhe fletore
Te ky apartament i vogël vinja
Me pantallona mbushur plot me rrodhe,
Me flokët mbushur hala nga dëllinja...

Në bulevard qëndroj e ndez cigarë
Përballë apartamentit tim të vjetër.
Nga xhami i ndezur ndizet malli i parë,
Që s' transferohet në shtëpinë tjetër.

1976

Dashuri e vështirë

Ti në kanape tani dremit,
 Ndofta gjumi ende s'të ka zënë,
 Abazhuri mbi qerpikët ndrit
 Libri nga gishtërinjtë të ka rënë.

Para teje ndal mendimi im:
 Jemi dashuruar edhe sharë,
 Jemi ndarë shpesh në udhëtim,
 Po drejt njëri-tjetrit kemi ngarë.

Dhoma hesht e rruga larg gjëmon,
 Ti sheh ëndrra kaltëroshe shumë,
 Unë, ndonëse pi dhe mogadon,
 Mezi fle, se jam njeri pa gjumë.

Të kam pasur ëndërr çast e orë,
 Ëndërr të trishtuar e të mirë,
 Po të jem vërtet një Pitagorë,
 Ti je teorema më e vështirë...

Pas ndarjes

Ajo më la përngaherë atë natë
Dhe unë i mundur si një kalorës
Me plagë kthehesha rrugës së gjatë,
Kur shkrinte fundi i dëborës.

Oxhaku i shtëpisë vilte shkëndija
Në kthina kërcisnin nallane dhe enë,
Më priste qeni im tek avllia
Si Argusi plak Odisenë.

Në ahur çukisnin brirët e qeve
Dhe hundët rëndonin erën me vlagë;
Në qiellin e turbullt lecat e reve
E lidhnin hënën si plagë...



I përndjekuri i dashurisë

Unë jam i burgosuri yt.
Rroj me pranga që ti m'i ke vënë.
Po çudi, as qelia s'më mbyt
Dhe s'më mbyt as dritarja e zënë.

Kur ti prangat m'i hodhe në mish,
Unë i putha duart e tua.
Është rast i pashembullt, ta dish,
Që xhelatin ta puth e ta dua!

I përndjekuri yt erotik,
I përndjekur të mbetet gjithmonë!
Erotik i mirë a i lig,
Hidhmi duart në fyt, torturomë!

Ky burgim sa do zgjasë s'e di
I përjetshëm do kisha dëshirë.
Veç ti eja më shpesh në qeli.
Të përndjekurit tënd i vjen mirë...

Kur bie dëborë

Bie dëborë këtej, bie dëborë;
Unë jam në kasolle në mal,
Toka duket e bardhë, e bardhë,
Toka botën e përrallës më ngjall.

Nuk më rrihet rreth vatrës së vjetër,
Do të ngrihem dhe malin do bredh,
Le të bjerë dëborë mbi mua
Siç ka rënë përmbi atë bredh.

Unë vetë kreshniku i përrallës
Çdo bregore e skutë do shkel;
Kur të lodhem, do ulem nën pishë
Edhe ty nëpër mend do të sjell.

Sytë e tu kaltëroshë të dashur
Përmes flokësh dëbore do shoh...
Malet duken të bardhë si ëndërr,
Malet unë me frymën i ngroh.

Tre pleqtë e lajthitur

Vdiq pardje dhe më e madhja putanë
Në moshën e thellë të një pleqërie pak të vështirë
Në një pijetore diku në Tiranë,
Vdiq nga cironka e prishur, por vdiq duke pirë.

E qanë tre pleqtë, e mbetur ende të gjallë,
Në pijetoren me tym me emrin "Omar Khajami".
Kur ishin të rinj i shkonin shpesh në mëhallë,
Këpucën e saj me raki e mbushnin, e pinin dhe qanin.

Ndaj qajnë dhe sot tre pleqtë putanën e ikur
Dhe flasin përçart: "Si s'la ndonjë çupë t'i ngjante pak nënës"!
Vërtet, tre pleqtë e mëhallës mbetën të tre të lajthitur
Në pijetoren, ku xhamin e shpon briri i hënës...

Ëndërr

Më dukej sikur të kisha harruar edhe në ëndërr,
Po ti diku në qenien time ishe ulur.
Dhe një ditë kur në qytet binte një shi i vëngër,
M'u shfaqe papritur në asfaltin e qullur.
Me balerina të vogla m'u mbush asfalti e sheshi,
Me balerina të vogla e flutura.
Ti qëndroje mes tyre e qeshje
Me buzët e bukura...
Dhe nuk dija ku ndodhesha
Mes balerinave, a pikave të shiut të dendur
Drejt teje afrohesha,
Si afrohemi në ëndërr...

1971

Për kujtim

Unë tregoj histori të bukura,
Ti bëhesh si foshnjë kureshtare,
Shikon me faqe të skuqura
Dhe hesht e humb fare.

E di historinë e Van-Gogut,
Historinë e veshit të tij?
Ty zemra të rreh si zogut
Dhe thua ngadalë:
S'e di!

Van-Gogut i thoshte një femër:
"Vinsent, ke veshë të bukur!"
Dhe qeshte me gjithë zemër,
Siç qesh ti me mua,
moj flutur!

Van-Gogu në këmbë kërceu,
E nxorri thikën një ditë
Dhe veshin e bukur e preu
Dhe tha:
"Mbaje kujtim, moj dritë!"

Habitesh?

Kështu ka ngarë
Njëherë një mëngjes.
Pse trembesh?

Ai ish i marrë.
Pse trembesh?
Unë veshin s'e pres!

1963

Turkesha

1.

Dikur kam njohur një turkeshë
 Nga vend i largët Adanà
 Me sy të zez e vetullzezë,
 Me flokët lyer me këna.

Ajo në vesh më pëshpëriste
 Si fërfërima në zabel,
 Po fërfërima ish turqishte
 Si varg divani: “Çok gjyzel!”

Çudira pranë saj mendoja,
 Çudirat merrnin rrugën vrap,
 Këtë turkeshë tek pushtoja
 Unë Anadollin bëja zap.

Nga buzët rridhte një turqishte,
 Siç rridhnin rimat në gazel;
 Turkesha këngë pëshpëriste:
 “Ah, arnaut, gjyzel, gjyzel!”

2.

Turkeshë e dashur, kjo që ndodhi
 Të kishte ndodhur atëherë,

Kur Krujën digjte Anadulli,
Ç'do kishim bërë, moj e mjerë?

S'do mend që kokën Skënderbeu
Ma kishte prerë si karpuz:
“Tani kur flakë digjet dheu,
Ti puth turkeshën, mor domuz?”

Dhe ti mbi trupin tim do bije,
Do shaje Krisht e Muhamet,
Mes kujës faqet do t'i çirrije;
“Ah, arnaut, medet, medet!”

...Por gjer këtu s'do kisha rënë,
S'do kisha kohë për sevda,
Pusi diku do kisha zënë,
Atje mbi muret në kala.

3.

Kjo histori është e trilluar,
Kur isha larg në Adanà,
Betohem, hiç s'kam dashuruar
Ndonjë turkeshë me këna!

E ku ta lija një lanete,
Një xhinde Shkodre, një kaproll,
Ajo me not do çante dete
Dhe do më gjente në Anadoll.

Po kjo s'do thotë që s'i dua
Syzeskat turke si gazel,
Kur çel si bahçe, rrjedh si krua
Nga buzët verbi "Çok gjyzel!"

1982

Pranë saj

Merrmi kryet e vemi në gjoks:
 Dua të çlodhem
 nga rruga.
 Shih si buza udhës m'u poq,
 Më fshiku veriu e juga.
 Hiç mos më pyet,
 ç'ndodhi andej,
 Nga brodha poshtë e përpjetë,
 Vetëm më lër prehje të gjëj
 Në gjoksin tënd
 të qetë!
 Kohë kemi,
 do flasim pastaj
 Për erëra,
 lule,
 limonë...
 Hesht e kryet në gjoks m'i mbaj,
 Flokët ngadalë ledhatomë.
 Është i etur
 për ledhatim
 Ai që baltëra ka çarë,
 Ai që ka parë muzg e agim
 Dhe duart e rënda ka vrarë.

Në amfiteatrin e Butrintit

Erdhën të dy në Butrint, në amfiteatrin e vjetër;
 Kish hënë e zbardhte mermeri i lashtë;
 Erdhi këtu edhe Orfeu ngadalë nëpër fletët
 Dhe u ul pranë statujës së bardhë.

I lodhur duke kërkuar Euridikën e humbur,
 Filloi të shkruajë në pentametër një këngë të gjatë.
 Ndërsa ata të dy rrinin të përqafuar nën kulpër
 Mbi mermerin në amfiteatër...

“Unë ty të nxora nga nëndheu,
 Unë ty të nxorra nga ferri e ti prapë më ike!”
 Këndonte a ndofta vajtonte Orfeu
 Për të bukurën gruan e tij Euridikë!

Po ata të dy s’e kishin mendjen atje;
 Nën kulpër thoshin fjalë për dashurinë e pastër
 Më të fuqishme se fjalët e këngëtarit Orfe
 Dhe të aktorëve, që kanë luajtur në këtë amfiteatër...

Vërtet, cilët kanë qenë ata që kanë lojtur,
 Ata që kanë luajtur “Edipin-mbret” e “Prometenë”
 Në këtë amfiteatër buzë Jonit të ngrohtë,
 Ku yjet e kaltër bien?

Vërtet, në këtë mermer kanë shkelur
Stërgjyshërit tanë edhe si artistë, edhe si spektatorë
Dhe janë trishtuar e kanë qeshur -
Thonë ballë statujës dashnorët...

Vërtet, në një mbrëmje si kjo ka qenë plot amfiteatri,
Në një mbrëmje si kjo jonike,
Dy mijë e ca vjet më parë, vazhdonte akoma spektakli
Dhe aktori që lozte Orfenë, thërriste:
- Ku je, Euridikë?!...

Ja, ta provoj edhe unë njëherë
Dhe të thërres si aktori, që lozte Orfenë,
Kur nga Joni jodi binte erë:
“Irenë, Irenë, ku je, Irenë?”

Dhe ata qeshnin e statujat dëgjonin,
Statujat që dy mijë e ca vjet qëndruan në këmbë,
Qëndruan në këmbë e ranë e u ngritën me fytyrë nga Joni.
E fjetën nën dhe e prapë u përmendën...

Vërtet, Irenë, ti kësaj statuje i ngjan çuditërisht,
Ndofta skulptorit stërgjyshja jote i ka pozuar
Për të skalitur një perëndeshë në Butrint;
Kështu ndodh, Irenë, perëndeshat kështu janë krijuar...

Kështu ndodh! Edhe Afërdita, e dashur,
Edhe Artemida, perëndesha e hënës,
Fytyrën e stërgjysheve tona kanë pasur,
Ja, si ti, Irenë, kanë qenë...

Dhe ata ndenjën në amfiteatër
Aq sa zgjaste një dramë e Euripidit,
Një dramë e madhe me pesë akte
Për spektatorët e Butrintit...

Dy pritje

Natën

Lulja mërzetet për diellin,

Natën

Vajza mërzetet për djalin,

Natën

Të dyja presin mëngjesin

Që dielli dhe djali të dalin...

1984

Kjo grua

Kjo grua që bie erë çokollatë
 Me mua ra dikur në dashuri;
 Tani jeton me burrin në pallate,
 Që ngritëm vjet në bulevard të ri.

Dhe nuk e di, e lumtur është vallë,
 Me burrin zemërbardhë e shtatlartë.
 Qëndroj ta përshëndes, t'i them ca fjalë,
 Si kalimtar, si mik e shok i largët.

Po kokën nuk e kthen ajo nga unë,
 Trak-trukun e sandales më lë pas...
 Atë në djalëri e desha shumë
 Betohehim të çanim çdo tallaz!

Po bashkë s'patëm fat të lidhnim jetën,
 Se donte apartament e telefona...
 Unë bëja veç artikuj për gazetën
 Dhe flija redaksive mbi poltrona...

Po unë e di, akoma natën në ëndërr
 I shfaqem, e hap derën bojë hiri,
 I shfaqem dhe i futem drejt në zemër,
 Megjithëse pranë saj fle zemërmiri.

Kjo grua që bie erë çokollatë,
Që desh nga unë apartament të ri,
Tani jeton me burrin zemërbardhë;
Jeton e lumtur?
Nuk e di!

1958



Mjegulli i dashurisë

Kur ikja larg, drejt teje vija;
Kur vija afër, ikja larg.
Për dreq më trembte largësia
Dhe afërsia bëhej çark.

As e kuptoja si të desha,
Një mjegull pus, një çmenduri,
Si një poet që shkruan vjersha
Dhe ndez një shkrepse, i bën hi.

Dhe ndofta kjo ish dashuria:
E çakërdisur kuturu...
Për dreq më trembte largësia
Dhe afërsia gjithashtu.

E bukura

E bukur, tokësore, e thjeshtë, lozonjare,
E tillë për mua je ti.
Unë vë kokën e zezë, si ugar, në supet e tua ledhatare

Dhe rri.

Unë rritem kur jam me ty, si Anteu,
E gjaku muret e aortës godet.
Të dy jemi bërë nga lulet, nga dheu,
Të dy njëri-tjetrit i duhemi me ditë, me net,
E bukura, tokësorja, e thjeshta grua!

1964

Natë në arë

Si mace e verdhë fshihet hëna
Përtej mullarëve me bar.
Ne pranë ledhit kemi rënë
Të flemë bashkë në ugar.

Dhe erë bar e kashtë bie,
Puhë e lumit fryn ngadalë,
Një plis me këmbë kali shtie,
Një lakuriqkë vjen vërdallë.

Dhe gjer përtej te buzë e zallit
Dëgjohen zilet e një tufe,
Bariu ia merr me mall kavallit
Dhe ia lot mendjen ndonjë çupe.

A mund të fle dot këtë natë
Në fshatin tim, në mes të ugarit,
Kur kundërmon tërfil i thatë,
Kur hënë mban sup i mullarit?

Kali

- *Baladë* -

1.

Limo Labinoti hipi kalin
Dhe u nis të blinte një qemane.
Në pazar takoi evgjit nallbanin,
Ia la kalin, hyri në mejhane.

Pa ia nisi gotave t'i zbrazte,
Pa ia nisi lodrat me çingjitë,
Pa çingjive ç'iu pëlqente nazet,
Ç'iu pëlqente këmbët, gjinjtë.

Mburrur mes çingjive tha një fjalë:
- Kush e ka qemanen më të mirë,
Për qemanen unë i jap një kalë,
Që s'e ka arab në shkretëtirë.

- Unë e kam! - tha një nga muzikantët
Dhe qemanen vithe - femër ngriti.
Sytë e tij të tubullt e të vakët
Feksën në lëkurën prej evgjiti.

Limo Labinoti i ra ballit:
Si t'ia jepte kalin një zuzari?!
Ky evgjit nuk vlen sa bisht i kalit.
Kali im këtij i ve samarin!

Kalë, o kalë, plumbin s'e përfillje,
 Me revan ia pritje rrugën plumbit;
 Kalë, o kalë, hënën e përpije,
 Kur e ngrije kokën anës lumit.

Kalë, o kalë, ç'm'u fanit qemania,
 Ç'më plagosi këngë e saj pa emër,
 Do ta nxjerr qemanen nga mejhania,
 Do ta ngjit në mal t'i fut një zemër!

Harkun e qemanes ta bëj kalë
 Dhe qemanen kodër mbi një fushë,
 Të trokasin thundrat valë-valë,
 Kur ta vë nën sup, ta mbaj nën gushë.

2.

Ky evgjit nallbani qimedrizë
 Solli kalin drejt e në mejhane,
 Ia dha sazexhiut mustaqespicë,
 E la Limon vetëm me qemane.

Limo Labinoti sazexhinë
 E vështroi me dy thëngjinjtë e vëngër:
 - Merre kalin, hidhu në lëndinë,
 Të krekosesh ti, çomagë e shtrëmbër.

Po më prit, evgjit, nga hija e ftonjve
 Të dëgjosh me smirë e ngashërimë
 Nga qemania trokun e potkonjve,
 Vërshëllimë jelesh, hingëllimë...

Dhe i tha: - Evgjit, unë ta jap kalin,
 Veç ma ler çingjinë ta nxjerr jashtë,
 T'i tregoj si hëna rri mbi malin.
 Si përgjon mullarin tim me kashtë;

Ta mësoj si barku i mullarit
 Bëhet shtrat nga shtretit më të lumtur,
 Ku pikon nga hëna pikë e arit
 Dhe vjen erë e lumit të përhumbur.

3.

Limo Labinoti hop! në kalë,
 Hop! mbi kalin bashkë e me çingjinë
 Dhe vrapuan ngjitur në një shalë
 Një kurriz, një bark plot përcëllimë...

Vrap e vrap dhe zbritën pas mullarit,
 Ku këndonin bulkthet këngë shumë,
 Ku përgjonte breshkëz e ugarit
 Zgjatur qafën samari i murrinë.

Heshtni, bulkthe, mos më kërkëri,
 Dhe ti, breshkëz mbaje brenda qafën!
 Limo Labinotin do ta shihni,
 Kur mullarit plak t'i futë flakën!

Obo-bo mullar, ç'të panë sytë,
 Obo-bo ti kashta e florinjte!
 Hënë e kallajsur tok me yjtë
 Panë si kërcejnë valle gjinjte!

Panë si kafshon çingjia kashtën,
 Kur përdridhet si purtekë e thanës,
 Panë si shalon një pelë natën
 Limo Labinoti i qemanes.

Panë si ky Limo Labinoti
 U bë hark qemane mbi çingjinë,
 Harku nxirrte tinguj, pika loti,
 Në fërkim me barkun dhe me gjinë.

Lumë, o lumë, mos i trego fushës
 Britmat e çingjisë dhe ofshamat,
 Kur ia vinin buzët zjarrin gushës
 Tek kumbonin cicat si kambanat!

Kalë, o kalë, mos rrëfe ç'ke parë,
 Mos rrëfe për pelën që kam hipur,
 Kjo çingjia-pelë krejt mullarë
 Ma rrëzoi përdhe me këmbët ngritur...

4.

Kur u kthyen gjithë evgjitët panë
 Qafën e kafshuar të çingjisë
 Dhe qemaneve në aheng u ranë
 Shtrembëruar sytë prej rakisë

Lëre, lëre Limo Labinotin,
 Nga qemania mendtë seç iu prishën!
 Jashtë kali qante për të zotin.
 Brenda kurva në akull ftohte sisën.

Mjegull i mejhanes ra mbi brengat,
 Gjokset e çingjive u mbuluan.
 Heshtën harqet, u nemitën këngët.
 Gotat flakën blu në buzë e shuan.

Limo Labinoti ngriti telat
 Pa i ra qemanes më të qarë.
 Qau për kalin gjersa thirrën gjelat
 Dhe kur shkoi në fshat i thanë: "I marrë"!!!

Për malësoren dhe për vete

Më qëlluan natën prej frëngjive
Edhe rashë anës lumit Drin.
Qofsh mallkuar Qafa e Gjarpinjve,
Që ma mpikse gjithë gjakun tim!

Më qëlluan!...

Qave ti mbi mua,
Me bucelë Drinë e madhe ma dhe,
Loti nga qepallat t'u thërrmua,
"Lage buzën pak!"
Në vesh më the.

Ç'më vështron?

Kjo s'është e vërtetë,
Jam poet dhe stisa një tregim!
Mund të ndodhte dhe kështu në jetë
Para njëzet vjet mbi lumin Drin.

Mund të ndodhte po të na kish parë
Ati yt i ashpër me çibuk.
Me dyfek të dyve na kish vrarë
Dhe do rridhte gjaku tej në lug.

Ç'më vështron?

Yt atë do kish shtënë

Nga frëngji e mureve të gurtë.

- "Çupa më turpëroi, - do kishte thënë -

Çupa në shtëpi më mbeti murgë!"

Dhe kjo përrallë e shkurtër e harruar

Nuk do ishte përrallë, o shpirti im!

Përrallë u bë se ne jemi takuar

Njëzet vjet më vonë në lumin Drin!

1964

Qafa e Martës

Pse ti qafë e malit thirresh Martë?
Qafë e Martës, dreqi i kuq të marrtë!

Tek ky shteg ku njerëz shkelin rrallë
Ç'donte Marta vetmitare vallë?

Mbase kur kalonin krushqit malit
Marta-nuse ra nga shalë e kalit,

Ra dhe vdiq atje nën shkëmb të lartë
Dhe pastaj e thirrën qafën Martë.

Mbase qafa mori thjesht një emër
Në nderim për shtojzovallen femër,

Në nderim për Missin mbi një kalë,
Kur akoma misset s'kishin dalë.

Qafë e Martës majave të kaltra,
Hape shkëmbin shpejt të shfaqet Marta,

Ta përcjell për Miss të konkurojë
Pa unaza dhe pa thonj me bojë...

Malli

Hëna brirët lan në lumë, uji yllin e spërkat,
Unë sillem nëpër shelgje sonte natën fillikat.

Bulku fshehur pas një drize lumit iso po i mban,
Natë e viseve të mia bie erë jargavan.

Si një rrahje flete molle një të puthur afër ndiej,
Sonte njerëz dashurohen te ky mal nën këta qiej...

Edhe unë, dashurova dhe me jetën pata fat,
Ndofta edhe puthjen time e dëgjoi një fillikat.

Ndofta ndezi një cigare pranë shelgut tek ky vend,
Ndofta buzët i lëvizi dhe diç solli nëpër mend...

Ndofta, ndofta... lumi derdhet, fladi thinjat m'i shpërndan,
Natë e viseve të mia rreh në xham me jargavan...

1960

Trëndafilat e turkeshës

1. Kënga e parë

Marmaraja bojëgjelbër, bojë e çallmës së sulltanit,
Ndrin nën gjunjët e Stambollit, portës plakë të vatanit,

Cipë e trupit tënd të bukur e lëmuar si tespihe
Shket në varkën e përgjumur, feks me naze dashurie.

Ti më thua se për varkat s'bëj dot vjersha unë i zitt,
Sipas teje vargje thurte veç poet Orhan Velit.

Të përgjigjem se Orhanin e njoh mirë e ma ka ënda,
Ky për varkat bukur shkruan, unë këndoj ç'ka varka brënda!

Ti zë qesh e thua prapë: "Ka poetë Arnaut-stani"?
Të përgjigjem: "Kish poetë që kur priste jatagani.

Në Stamboll nën jataganin ngrinte këngë e ligjërime
Një sulltan i poezisë, Naim beu i tokës sime!"

Marmaraja bojëgjelbër, bojë e çallmës së sulltanit
Përkund varkën tek turkesha e këndon Arnaut-stanit.

2. Kënga e dytë

Yzmetçiu me enë turke si kapele të mëdha
Tundet si patok i majmë dhe sjell “elbasan-tava”.

Erë e viçit turk të pjekur i lëmon perdet e tytit,
Unë turkeshën myslimane e vështroj me bisht të syrit:

- “Kjo tava është vepra jonë, e pëlqente dhe sultani,
E krijoi një mendjehollë, një qejfli nga Elbasani”.

Deh! turkesha rreh shuplakat, gishtit i bardhë nxjerr inxhi;
- “Arnaut, shejtan me brinë, qenke tepër shakaxhi”! -

Ndizem prush si pallë e turkut, një mendim nga larg më zbardh:
- “S’lamë vetëm emra gjellësh në Stambollin tënd të madh.

Ndofta, zonjëz, të kujtohet arkitekti bash Sinan,
Në Stamboll i grenë vithet dy xhamitë e tij me nam.

Mbase ish nga Tepelena, mbase nga Librazhdi ish,
T’i ka ngritur ty xhamitë që të falesh arabisht.

Dhe kur falesh s’e ke mendjen tek një hoxhë me kuran,
E ke mendjen në kupolat, ku fton arti sinanian.

Në Stamboll ne kemi pasur tri armata, tri ushtri...” -
U gajas kunadhja turke: - “Qenke tepër shakaxhi”!

Dale, dale! them me vete tek fshin djersën yzmetçiu:
 - “Një armatë ish vetë Abdylë dhe një tjetër ish Samiu

Dhe e treta - gjenerali, gjeneral poet Naimi,
 Që lëshonte nga Stambolli divizione vjershërimit!

Dhe të tri këto armata nuk i preu dot jatagani,
 I mëkonte turku vetë fshehur turçe nga sulltani.

E dëgjon një zë armate si përhapet valë-valë?
 Vjen nga larg e më merr mua dhe më mban me shpirt të gjallë:

“O malet e Shqipërisë dhe ju, o lisat e gjatë,
 Fushat e gjëra me lule, që ju kam ndër mend ditë e natë!”

Top Kapia humb në mjegull, Marmaraja fle në paqe,
 Mua katër pika loti më vrapojnë nëpër faqe.

Dhe turkeshën e rrëmbejnë tri armata, tri ushtri,
 Yzmetçiu patok i majmë vjen e sjell “Jeni Raki”...

3. Kënga e tretë

Në “Xhenet Bahçe” turkeshat hidhen turçe hula-hup,
 I fryn trompës dhe gërnetës turku Abdullah Jakup;

I bie frëngçe tamburasë turkja Selime Hashef,
Po turkeshat turçe hidhen, tundin siskat me sedef.

Katër turq, turkesha pesë, me raki, turshi e mish,
Yzmetçi Kasëm Murati na zgjat dorën për bakshish.

Hula-hupi turçe sillet, turçe gotat mbushen plot,
Nga “Jeni Rakia” turqit dehen turçe, s’mbahen dot...

Katër turq dhe katër mjekra në pëqi të turkes ranë
Dhe të katër si fëmijët e turkeshës zunë e qanë...

Po turkesha nxori sheshit jataganë e gjuhës turke
Dhe me gjuhë jatagani përmbi turqit u vërsulke:

- “S’kini turp, o turq nga turqit, ju ka dehur arnauti,
Erdhi piu rakinë e turkut dhe me lëngun turk ju mundi!

Ky na marrka gotën turke dhe me gotë turke tallet,
Ah, o turq, na nxitë faqen dhe kjo faqe nuk na lahet!”

Unë i them: - “Më fal, turkeshë, gjyshërit një zakon më lanë,
Të marr shpatat e sulltanit dhe me to të pres sulltanë!

Ky zakon i keq më mbeti dhe në shpatën e rakisë,
Zbraz “Jeni Raki” të turkut dhe deh burrat e Turqisë”.

Më vështrojnë e qeshin turçe katër turq, turkesha pesë:
-”Eh, kjo luftë dashurie!... Shpatë e saj le të na presë!”

Pimë turçe, hamë turçe; s’flasim turçe, po frëngjisht.
Të jetonte gjyshja ime, mund të fliste dhe turqisht...

I fryn trombës turku turçe, turku Abdullah Jakup.
I bie turkja tamburasë, siskat hidhen hula-lup.

Në “Xhenet Bahçe” turkeshat kush s’i do, kush s’i pëlqen?
Marmaraja xha Stambollit ia lan këmbët në legen.

4. Kënga e katërt

Bashkë i shohim dalngadalë mrekullitë e Top Kapisë
Tek na shfaqen nëpër mjegull varg sulltanët e Turqisë.

Duke ecur pranë xhamesh me florinj e jataganë
Vanë sytë e mi të lodhur në dy çallma, dy sulltanë

Ti në çast nis ligjërimin për sulltanë e për vezirë...
Hesht, turkeshë, se sulltanët që të dy unë i njoh mirë!

Që të dy në tokën time kanë pirë e kanë ngrënë,
Nën bedenat e kalave medalionet kanë lënë;

Që të dy i ulën çallmat: dhe Murati, dhe Mehmeti
Dhe pas mureve të Krujës gjysmëhënë e tyre mbeti.

Ah, s'ia ditke emrin Krujës? Kruja turçe Ak-hisar,
Dy sulltanët pallëthyer s'e harruan gjer në varr!...

Vetullvrenjtur ti më thua: "S'ishin trima, po guhakë".
Jam modest, turkeshë e dashur, i pranoj dhe frikacakë.

Mos u vrenjt se ke në xhame mbi tridhjetë e ca sulltanë,
Vetëm dy të mori Kruja dhe të tjerët ja ku janë!

Falemnderit nga sulltanët, namin shekujt po na shtojnë,
Sa më e mprehtë pallë e tyre, aq më e nxehtë shpata e jonë!

Paske qejf t'i mburr sulltanët!...Po t'i mburr për trimërinë,
Ata derdheshin furtunë dhe ne digjnim vetëtimë!

Dhe turkesha rrahu doçkat: "Arnaut shejtan gjyzar,
Në pallatin e sulltanit me sulltanët bën pazar"!

Unë i them: "Tani sulltanët për pazar vërtet u bënë,
Po dikur stërgjyshërit tanë me ta kokat kanë ngrënë"!

Dhe në vesh një këngë malesh i këndoju me mall turkeshës
Pranë çallmës së sulltanit në konak të sulltaneshës:

Zylyftar mustaqeverdhë
Prit nizamët se t' u derdhë!

- Dhe në ardhshin, le të vinë,
Pranë pusit kam Mersinë...

Melesini maja-maja
E rreth topi, kumbaraja.

Njëzet trima me Mersinë
Buzë pusit seç u shtrinë.

Dhe te portë e Zylyftarit
Varur kokë e bashnizamit...

Ah, turkesha uli syçkat si dy gurë xhevahiri,
Vinte Zylyftari i Podës hipur kalit bojëhiri,

Vinte mbushur plot me plagë nëpër urën e Gallatës,
Vinte përmes këngës sime nëpër vargjet e baladës...

5. Kënga e pestë

Me turkeshën ishim shtruar në "Kafe Sari Salltik",
Yzmetçi Ali Oglliu shtinte çajin me ibrik.

I tregoja se në vargje komunist i ndershëm jam...

- “Çok gjyzel, - më tha turkesha, - komunist e mysliman”! -

Unë u plaka në fytyrë, kuvendimi vuri bisht,

Dhe ia ktheva: - “Nuk bashkohen mysliman e komunist”!...

Po turkesha hapi buzkat si dy sure në Kuran:

- “Mos ma prish dëshirën mua, komunist e mysliman”!

Ama mendje! - them me vete, - mendje e zbrazur si ibrik

Pika neve që kullosim në livadhin politik!

- “Ç’ke që ngrysesh, - tha turkesha, - apo sytë s’m’i pëlqen?

Sytë e mi në “Kapitalin” i Karl Marksit nuk i gjen,

Këta sy i gjen si perla në çdo sure në Kuran,

Mos ma prish dëshirën mua, komunist e mysliman”!

Yzmetçi Ali Oglliu na jep çajin me ibrik

Dhe ma bën përshesh turkesha materializmin dialektik.

Po ndërkohë ajo rrudh ballin dhe ul sytë e zez përdhe:

-”Komunist një lëmsh i mjegullt, lëmsh shejtanësh nëpër re!”

Unë i them: - “Ne komunistët jemi djaj të kuq në botë,

Po hanëmet si zotrote na pëlqen t’i mbajmë ngrohtë.

E shikon se komunistët janë popull simpatik?
Shtina çaj, Ali Oglliu, myslimani me ibrik!" -

Shkoi e vate komunisti, dialektikë e "Kapital"
Dhe në gjirin e hanëmes ngriti krahët dhe u fal!

O bo- bo ç'qenkësh kjo falje mbi kuranin që iu taks.
Lamtumirë ju, mjekrroshë, Lenin, Engels, baba Marks!..

6. Kënga e gjashtë

Rri në breg të Marmarasë mu në gjunjtë e
Stambollit,
Vjen nga larg një valë e shurdhër, regëtimë e
Anadollit.

Kullat shpuar nga fenerët sytë i mbyllin, sytë i hapin
Dhe vaporëve të majmë shenjë u marrin, shenjë u japin.

Këto shenja më lëndojnë, sepse jam vapor i gjallë,
Jam vapor që vjen nga kohërat i sflitur nëpër valë;

Jam i mbushur me vajtime dhe i zbrazem Marmarasë,
Ku turkesha thyen gishtin në një tel të tamburasë.

Unë vajtoj një këngë mali, një baladë pleqërishte
Për një Tiko Kapedani me takije shqiptarishte:

Marmaraja det i turkut,
Çau vapori tatëpjetë,
Çau me dyzet kapedanë
Dhe me treqind e ca vetë.

Në vapor u ça kazani,
Humbi Tiko kapedani...
Thonë u mbyt e thonë u shua,
Lëreni dhe mos e ngani!

Po mahnitet dhe Stambolli,
Kur del Tikua nga vapori,
Në një shkëmb qëndron i gjori,
Shokët deti i shkretë i mori...

E derdh drithma si purtekë
Në atë shkëmb ku mblidhen retë,
Mbetur fillikat pa shokët
Hidhet përmbi valët vetë...

Marmara t'u shoftë nami,
Humbi Tiko kapedani!
Thonë humbi, thonë doli,
E kërkon, s'e gjen Stambolli...

Marmaraja hesht pasdarke nanuritur e përgjumur,
Me turkeshën e kërkojmë Tiko kapedanë e humbur

Ndofta dergjet nën Gallatë, ndofta prehet mes Bosforit.
Ndofta duart ka shtrënguar në kazanin e vaporit

Unë po ndahem nga turkesha, nga stërnipja e sulltanit.
Po turkeshën do ta ndjekë shpirti i Tiko kapedanit...

Stamboll 1980

Lisi bleron vonë

Blerojnë gjithë pemët e tjera në fusha e kreshta
Dhe në fund bleron lisi e vesh malë.
Pastaj ikën pranvera e vera e vjeshta,
Pemët zhvishen, po lisi zhvishet ngadalë.

Ai i shëmbëllen atij që dashuron vonë,
Po zjarrin e dashurisë e mban të ndezur si furrë:
Dhe njerëzit tundin kokën e thonë:
I çuditshëm, s'u plak kurrë!

Përjetësisht me njëri-tjetrin

Takohet vala në bregdet me shkëmbin,
Nga shkëmbi shkon dhe ndahet me nxitim,
E duan njëri-tjetrin dhe e trembin
Me ndarje e takime pa mbarim...

Malli për heronjtë

Krevati i Perandorit

*Partizani Meke kish opinga të rënda llastiku,
Kish opinga të rënda e pushkë të rëndë
Dhe në brez kish vezme me plumba belgjiku,
Dhe një koburë të vjetër me nëntë...
Atë ditë kur hyri në pallat ishte i pangrënë,
Ish i pangrënë dhe për gjumë i kapitur:
Ç'të bëjmë, partizani Meke, ç'të bëjmë!
Edhe pa bukë e pa gjumë duhet pritur!
Dhe hapi një dhomë e në dhomë pa një krevat të bukur;
Krevat të tillë kurrë s'kishte parë,
Të pastër si slutur;
Të ndritur si pika e vesës në arë.
Në krevat pat fjetur Viktor Emanueli i Tretë,
Atë natë, kur shpëtoi nga plumbi i Vasilit.
- Eh, koburë virane, e luajte tytën e shkretë!
Tha partizani Meke para krevatit ngjyrë trëndafili...
E u ul në jorgan, e hapi kutinë e lashtë,
E ranë në jorgan coprat e duhanit të fortë,
E ranë në jorgan shkëndijat që nxori masati,
Shkëndijat që nxori masati nga stralli i flohtë.
Dhe u hap në dhomën e perandorit
Era e eshkës e era e duhanit,
E eshkës të sjellë nga grykat e Mezhgoranit...*

E ty mi mbuloi fotografinë e perandorit në mur
 Dhe mustaqet e perandorit në fund të tymit ranë
 Mustaqet perandori i krehu në dhomë dikur.
 Ditën që shpëtoi nga plumbi në një bulevard në Tiranë.
 - Shpëtove mirë aherë, - tha partizani Meke. -
 Palo burrë ke qënë, megjithëse perandor,
 Dhe mustaqet me krehër sedefi m'i krehke,
 Dhe qeshke me zor!
 Tju! as duhan të fortë si imi s'ke pivrë,
 As eshkë si imja s'ke ndezur me masat!
 Tju! dhe tri pëllëmbë njeri je shtrirë
 Nën këtë jorgan, mbi këtë krevat!...
 Kam pasur dy djem unë Mekja
 Tri herë më të gjatë se ti,
 Dhe ti m'i rrëmbeve si vdekja
 Dhe m'i degdise në ishujt në Itali...
 Dhe vdiqën djemtë e mi dhe i hodhe në det
 Dhe më le mua e plakën kërcure
 Dhe më le arën pa mbjellë pesë vjet,
 Dhe më le selishtën mbuluar me hithra e shkurre.
 Edhe Kasëmit të Aliut ia vrave djemtë,
 Edhe Kiços së Gagos ia vrave çupën,
 Atë natë kur sillnim duaj në lëmenjtë,
 Atë natë kur gratë zinin në magje bukën...
 Më ke dëgjuar mua, Meken, ndonjëherë,
 Të them, më ke dëgjuar në Itali?
 Domosdo emrin tim do ta kesh shkruar në dëfterë,
 Domosdo emrin ma di...

Ja, unë jam Mekja, me opinga llastiku e me opinga lëkure,
 Me masat, kobure e vezme në brez,
 Unë të dogja kazermat e ushtarët t'i zura,
 Që në Sicili e gjer në Bradashesh.
 Kudo jam unë Mekja e kudo kam qenë
 E do të jem kudo e ti do dridhesh nga unë,
 E data të ka për të zënë
 Edhe zgjuar, edhe në gjumë...
 Tfu! të pështyj në serrat, perandor;
 Një palo burrë dy pëllëmbë,
 Një palo Viktor
 Me dy gisht këmbë!
 E i erdhi gjumi partizanit Meke
 Dhe u shtri në krevat të perandorit
 Dhe opingat s'i hoqi partizani Meke
 Dhe vezmet nga brezi s'i nxori.
 Dhe tha ngadalë partizani Meke
 Me dorën e madhe në kraharor:
 - Farë e keqe,
 Tani jam vetë perandor!...
 Dhe humbi në mjegull Viktor Emanueli i Tretë,
 Dhe humbi në mjegull perandoria;
 Opingat e llastikut qëndronin majëpërpyjetë
 Në jorganin sjellë nga Italia...
 Nën jastëkun e bardhë me pupla
 Rrinte koburja nëntëshe e partizanit Meke,
 Në kokë të krevatit varej pushka
 Eh, ç'vajti, partizani Meke!

Sofra e historisë

Në sofën e shtruar të historisë
Presin të marrin lugët të gjithë.

Vështronë thelat dhe duan të hanë
Kurnacë, grykës, batakçinj, pehlivanë:

Po historia u jep nga një kafe në këmbë
Dhe thotë e përmbajtur diçka nëpër dhëmbë

“Na falni, se presim në sofër të vijmë
Ata që bëjnë vërtet historinë”.

Kështu mund të ndodhte

Sikur të bija nga plumbi i nxehtë,
Nëna s'do merrte telegrame.
Do vinte korrieri i çetës
I veshur me tallagane,

Do shtrohej i lodhur në vatër,
Me shkop do trazonte zjarrin
Do sillte mendimet në hatër,
I heshtur do pinte cigarin;

Do thoshte: "Yt bir, nënë..."
Dhe dora e nënës me deje të trasha
Nga dridhmat në gju do kish rënë,
Në prush do shpëtonte masha...

Pastaj do çonte kokën e bardhë,
Do mbyllej në odën tjetër...
Do ngrihej korrieri nga vatra
E pas do t'i binte çetës.

A s'mund të ndodhte një vdekje e tillë?
Me gjakun tim të përgjakja hënën,
Dhe ju të shihnit të mbillte trëndafilë
Mbi varrin tim nënën?...

Pleqtë e qytetit tim

Dhe ndodhet në qytetin tim të lashtë
 Një kafene e vogël nën një rrap.
 Atje karriget verës rrinë jashtë
 Dhe rrapi mbi karriget degët hap.

Mëngjeseve pa dalë dielli mirë,
 Kur deg' e rrapit zë e fërfërin,
 Fillojnë e mblidhen, kafe për të pirë,
 Të bardhët pleq që mburr qyteti im.

Dhe ndihet tavolinës ndonjë kollë
 Dhe rrokulliset fjala si një gur:
 “Ky rrap ka qenë at’herë pak më i hollë,
 Po ndofta dhe ka mbetur si dikur!”

Këtej Çerçizi zbriti tatëpjetë,
 Pas portave të vjetra me qemer
 Pastaj në Mashkullorë vrau nja tetë,
 Pastaj bimbashi ra në gjak pa nder...”

Dhe përsëri bie heshtja tavolinës
 Dhe rrapi plak, më plaku se çdo plak,
 Ia merr si këngë malli fërfërimës
 Dhe fërfërima zbret nëpër sokak.

Troket në gur një shkop me fund të ngrënë,
Vërtitet ndonjë ljalë mbi filxhan:
“Ne bashkë me Selamin kemi qënë
Në qafën e Koçiu në istikam.

Në tela gunë e murrme shkoi e vate,
E lashë si kujtim atje mbi gjëmb.
Kam marrë dhe një plagë asaj nate
Dhe plaga kur bie shi akoma dhemb”.

Dhe zë kërcet kurrizi në karrige,
Në tavolinë shuhet një çibuk;
Dhe kulm’ i kafenesë si kaike
Mes degëve të rrapit humb në muzg.

“Kur ra Bajrami thellë Dragobisë
Ne ishim me Fan Nolin në arrati
Dhe thirri: “Trim tribun i vegjëlisë”,
Dhe lotët i pikuan në pëqi”.

Fryn era sipër rrapit nëpër degët
Dhe pleqtë ulin kokat mbi një bllok,
Dhe duken të menduar si strategët,
Me supe të bashkuar shok me shok:

“Këto i kam shënuar atë ditë
Në batalionin tonë partizan,

Asim Zeneli tankut i zu pritë
Dhe mbeti i pamort në Mezhgoran!

Këtu me Muço Matohitin dolëm,
Fotografi në malet mbi Përmet;
Eh, vitet si burimi rrodhën, rrodhën,
Po Muçoja me mua prapë flet...”

Dhe rrapi krahët ul mbi tavolinë,
Dëgjon se ç’thonë pleqtë e kokën tund.
Dhe fjalët dalngadalë si fërfërimë
I merr e nëpër degët i përkund.

Ai qëndron i gjelbër dhe i heshtur,
Mban vesh çdo kuvendim e çdo rrëfim;
Dhe monument i madh ka për të mbetur
Për nder të pleqve të qytetit tim...

1977

Komisari

Baladë

Nën një shkëmb murrash të shtrembër,
Që mban emrin Gur-Kusar,
Rrugën gjeti gjer në zemër
Plumb i nxehtë, komisar!

Re në krah nën shkrep të vjetër,
Re në krah e s'lojte dot.
Pishë e re qepallëgjelbër
Nga qepalla derdhi lot.

Lot i gjelbër ra në faqet
Afër shkëmbit Gur-Kusar,
Dhe nën shpatull manushaqet
U lën kokën, komisar!

Unë rrija pranë teje,
U dhën sillja nëpër mend:
Si u hodhëm në beteja
Shteg më shteg e vend më vend,

Si naganti nuk na ngeci
Që në Kuç e në Korab,
Kur na thërriste Shëfqet Peçi,
Komandanti ynë lab,

Kur vraponim ne si retë
 Pranë shkëmbit Gur-Kusar;
 Shtininim shtatë e vrisnim tetë
 Për lirinë, komisar!

Unë rrija pranë teje
 Me nagant e me mauzer,
 Nga mërzia nëpër deje
 S'rridhte gjak, po rridhte vrer.

Ç'do më thoshte nëna plakë,
 Kur të shkoja prapë në fshat?
 “Ju përcolla të dy bashkë,
 Ti më kthehesh fillikat!”

Nëna s'tha të tilla fjalë
 Buzë vatrës me pak zjarri,
 Vetëm pyeti: “mos ka dalë
 Majë shkëmbit Gur-Kusar,

Që dushmanin ta shikojë
 Dhe ta ndjekë shteg më shteg;
 S'ma merr mendja të pushojë
 Një nagant e një dyfek...”

...Dhe naganti nuk na ngeci
 Që në Kuç e Vishegrad;

Ngriti këngë Shfqet Peçi
Komandanti ynë lab...

Nën një shkëmb murrash të shtrembër
Që mban emrin Gur-Kusar,
Rrugën gjeti gjer në zemër
Plumb i nxhtë, komisar!

Malli për heronjtë

S'ka heronj, heronjtë i përzumë,
Me lavdi përditë i nanuritëm
Dhe me lajka dalngadalë i vumë
Një nga një në prehje dhe në gjumë.

S'ka heronj, heronjtë u mërzitën,
Prisnin ëndrrat, ëndrrat u vomuan,
Duke pritur heshtën dhe dremitën
Dhe ne nina-nana u kënduam.

Ç'digjeni nga malli për heronjtë?
Kushedi kur kthehen nga kjo anë!
Ç'i kërkon? Pritja është e kotë,
S'ka heronj, tani ka pehlivanë!

1991

Maro Podgozhani

1.

Duke udhëtuar nëpër Mokër
Ç'm'u kujtove, Maro Podgozhani!
Jemi shtruar bashkë në një sofër
Unë dhe xha Meke partizani.

Po xha Mekja vdiq, i ndrittë shpirti,
Vdekjen duke pritur me shakara;
Dhe vështron malluar nga Pleçishti
Nga dritare e varrit nën dy arra.

Dhe vështron a kanë rrush hardhitë
Dhe dëgjon a zien në zjarr kazani
Dhe mban vesh a sillen rreth dollitë
Dhe gëzon kur zë zinxhir filxhani...

2.

Maro Podgozhani kish një djalë;
Për atë s'përtonte dhe të vdiste...
Ky Bajram Trebinja hapi fjalë
Djalim fillikat në mal t'ia vriste.

T'ia shkretonte strehën e mjeruar
 Dhe pa zjarr ta linte mu në vatër,
 Që me shkop të shkonte e munduar
 Nëpër botë si lypsare e varfër!

3.

Ç'pate që trazove mendtë e mia,
 Maro Podgozhani me kobure!
 Më kujtohet kur Bajram Trebinja
 Zverdhur dyllë u fsheh nëpër ahure.

Zverdhur dyllë hyri nëpër grazhde,
 Kur i dole me nagant në dorë:
 "Dil Bajram Trebinja, qimekashtë,
 Ta kopsit me kopsa kraharorë!"

Ti Bajram Trebinja je betuar
 Djalin tim ta vrasësh me tre plumba,
 Të më lësh kërcure të mjeruar,
 Të m'i lësh dhe strehët pa pëllumba!

Dil, Bajram Trebinja, nga ahuret,
 Dil, Bajram Trebinja, qimekashtë,
 Të t'i jap peshqesh të dy koburet,
 Një me dhjetë, një me pesë a gjashtë!

O dobiç, që Mokra s'të ka pjellë,
 Që lëpin me Ballin dy sahanë,
 Mos m'u fut nën grazhd, nën bark të pelës,
 Hajt tani, ma shpall në sy fermanë!"

4.

Obobo, ç'u lag Bajram Trebinja
 Gjer në thonj prej etheve me djersë,
 Fshehur nëpër kashtë si mëllenja,
 Duke humbur trimëri dhe erzë!

Obobo, ç'na qe kjo gjëmë e madhe
 Për Bajram Trebinjën me mustaqe,
 Vjen një ketër bredhi, një kunadhe
 Dhe të bën të çjerrësh flokë e faqe!

"Lipsu, xhind, nuk qeshet me kobure,
 Lipsu, xhind, dhe shko me vrap te djali,
 S'ta trazoj, më djegtë kjo hashure,
 S'ta trazoj, më rëntë kokës mali!

Lipsu, xhind, s'kam punë me një femër,
 Lipsu, xhind, valofsha si kazani!"
 Lutej kapedani dhe në zemër
 Gjaku rrihte krahët si fazani.

5.

Maro Podgozhani fryu dy herë
 Në dy grykat ngritur si qysqira.
 Ky Bajram Trebinja gjunjëprerë
 Thoshte: Maro, shko, të marrtë e mira!

Dhe u drodh prej Maros si purtekë
 Dhe jetoi me turp të zi në Mokër,
 Vezmet i ngarkoi me plot fishekë,
 Frika s'i largohej as në sofër...

Dhe xha Mekja ngriti shumë bejte
 Dhe tregoi romuze për Bajramin.
 Dhe kujtimet unë i mbaj me vete
 Dhe këndoj për Maro Podgozhanin...

6.

Larg nga Podgozhani në varreza
 Maroja po fle në katër mure,
 Sipër saj e kaltër dridhet dredhëza
 Dhe nën kokë rrinë dy kobure.

Duke udhëtuar nëpër Mokër,
 Ç'm'u kujtove, Maro Podgozhani!
 Jemi shtruar bashkë në një sofër
 Unë dhe xha Meke partizani.

Elegji partizane


Ti s'duhej të vriteshe atje, xha Rexhep,
Ti gjysmën e udhës s'e kishe bërë.
Ta gjetëm kutinë e çibukun në xhep,
T'i gjetëm opingat me gjak e me rërë.

Ti kishe lënë në kuti pak duhan,
Pak sa të mbushje çibukun një herë,
Duhani selishteje grirë me havan,
Nga plaka jote e mjerë.

Ç'e pije të shkretin, kur vritej ndonjë!...
Çibukun e mbaje me dhëmbët e rrallë,
Mendoje e flisje pa zë,
Shtrengoje pëllëmbën e trashë në ballë.

Të thamë të gjithë mos shkoje andej,
Po kishe mall të shihje fshatarët,
Që tokës parmendën ia fushnin në dej
E hidhnin farë.

Ti s'duhej të vriteshe atje, xha Rexhep,
Dhe s'duhej ta lije duhanin pa pirë,
Se arat të prisnin diku nën një shkrep
T'i mbillje më të gdhirë...



Ndjej kudo (naimjane)

Fshehtësitë e qiririt

*Qiriri ka vërtet diçka të fshehtë,
Diçka që s'mund ta marrësh thjesht me mend,
Qiriri derdh me dyllin lot të nxehtë
Dhe ti vështron tek tretet si një shenjt.*

*Sjell frymë e tij një mirësi mistike
Dhe qënien tënde ta pushton në çast.
Pastaj ti humb mes ëndrrave biblike
Dhe kotësitë e jetës mbeten pas.*

*Të zbresin tok me dyllin nga shandani
Fytyra fisi fshehur në ngujim...
Të shfaqen varg Buzuku, Budi, Bardhi dhe Bogdani,
Të shfaqen lotët e të treturit Naim...*

*Dhe zbutesh krejt si shenjt që del nga hiri,
Nga shkruamb i viteve që shkuan varg e varg,
Ti s'flet dhe pret të flasë veç qiriri,
Siç pret një mendimtar që vjen nga larg.*

Kur më pushtoi malli për detin

Det në jetë kurrë s'kisha parë,
 Detin e mendoja me bajlozë,
 Me topuzë e thika e hanxharë,
 Me një sy në ballë e faqet blozë;
 Det në jetë kurrë s'kisha parë.

Pa më zuri gjyshi im për dore,
 Pa me fshehtësi më tha ngadalë:
 - Hajde, bir, të nisemi në Vlorë,
 Ta takojmë detin mbushur valë!
 Pa më zuri gjyshi im për dore.

Pa atje në Vlorë mes ullinjve
 M'u fanit një qiell i madh i gjelbër,
 Qiell të tillë, ndritur prej florinjve,
 Kurrë s'kisha parë herë tjetër;
 Pa atje në Vlorë mes ullinjve.

-Deti! - thirri gjyshi përmalluar
 Dhe më vetëtinë mijëra diej,
 Mes ullinjve, Vlorë e kaltëruar
 Ishte kaltëruar nga dy qiej.
 - Deti! - thirri gjyshi përmalluar...

Dhe në tokë u ul t'i falej detit
Si dervishi pragut të teqesë,
Nën ullinj një lot i ra të shkretit,
Nën ullinj një lot i ra si vesë
Dhe në tokë u ul t'i falej detit.

Deti me kurriz me luspa të arta
Hidhej lart sikur e gudulisnin,
Pulëbardhat silleshin si karta
Që në zarf nga largësitë i vinin
Detit me kurriz me luspa të arta.

Mrekullia vetë kishte zbritur!
Ishte qenie krejt me shpirt të gjallë
Ngrinte shpinën lart duke bërtitur,
Ndriste, qeshte, hidhej, lonte valle,
Mrekullia vetë kishte zbritur!

Vallë mund të dilte dot bajlozi
Sipër kësaj qenie të çuditshme?
Shpirtin do t'ia merrte faqeblozit
Si kafshore shpejt do ta gëlltiste;
Vallë mund të dilte dot bajlozi?

- Eh, ka dalë, bir! - tha gjysh'i shkretë
Po këtej nga malet jemi derdhur
Dhe bajlozin poshtë nga shkëmbenjtë,

Si një thes në det e kemi hedhur,
- Eh, ka dalë, bir! - tha gjysh'i shkretë.

Dhe pastaj ne tok me gjyshin ikëm,
Deti na përcolli me gjëmime,
Ikëm grykave, në mal u ngjitëm,
Po në Vlorë mbeti zemra ime,
Se pastaj ne tok me gjyshin ikëm...

Me zili u mbusha për një djalë
Djali pse të kishte det me shkumë,
Kur në fshat unë kisha vetëm male,
Vetëm një luginë dhe një lumë.
Me zili u mbusha për një djalë.

Dhe ky djalë mund të qe Lavdoshi,
Mund të qe Andrea e Shefqeti!
Pa gjëmonte grykave Gramozi:
- Ja, nga maja ime duket deti,
Ç'ke zili, se rron në det Lavdoshi?

Pa në fshat për detin ëndërroja,
Sikur bridhja valësh me vaporë
Dhe piratët dallgësh i gjurmoja
Me hanxhar në gojë e me pisqollë;
Pa në fshat për detin ëndërroja.

Unë e gdhija natën në kuvertë
Tok me kapedan Haxhi Alinë,
Dhe m'i kripte flokët det i sertë,
Bisht i peshkut ngrinte suferinë;
Unë e gdhija natën në kuvertë.

Ngrihesha, bërtisja keq në gjumë;
Zëri oshëtinte nëpër trarë;
Gjyshja ime gjyshin shante shumë:
- Pse në det e shpure, mor i marrë!
Ngrihesha, bërtisja keq në gjumë.

Gjyshi thosh: - Lanet, më çave veshin!
Le t'i shtohet nipit tim një ëndërr,
Një e ka për malin, një për detin,
Që në botë mos ta shohin vëngër!
Gjyshi thosh: - Lanet, më çave veshin!

Dhe në mal jetoja, po përditë
Larg më ftonte deti mbushur zhurmë,
Larg më joshnin valët dhe stuhitë,
Larg më merрте ëndrra nëpër shkumë
Dhe në mal jetoja, po përditë

Deti më kërkonte në furtunë...

Atdheu

Atdhe, të ndiej edhe në kokrrën e rërës së detit,
 Edhe në thërrimen e padukshme të nektarit,
 Edhe në pikën e kaltër të vesës së mëngjesit,
 Edhe në plisin e vlagët të ugarit.

Atdhe, të ndiej edhe në zhurmën e rrapit të lashtë,
 Edhe në fijen e brishtë të barit,
 Edhe në qerpikët si kallëza gruri të vashës,
 Edhe në vijat e ballit të ushtarit.

Atdhe, të ndiej në çdo qelizë të indit të tokës sime,
 E në çdo molekulë të ujërave që më lajnë,
 E në çdo fërfërimë ere e frymë suferine,
 E në çdo copë qielli që malet mbi kokë e mbajnë.

Atdhe, të ndiej në bulat e djersës së ndershme,
 Të ndiej në tingujt e këngëve dhe isot e gjata,
 Të ndiej në gurët dhe gdhendjet e hershme,
 Të ndiej në lulet e qëndismave të grave të ngrata.

Atdhe, të ndiej në avullin e bukës së magjeve,
 Të ndiej në shtigjet e dhive dhe rrugët e makinave,
 Të ndiej në shijen e hidhur të tymit të oxhaqeve,
 Të ndiej në tërbimin dhe dhimbjen e trimave.

Atdhe, të ndiej në hatullat e zemrës dhe shpirtit,
Të ndiej në zulmën pa cak të rinisë,
Të ndiej në qëndresën e plakjes sime si plakja e Krishtit,
Të ndiej në gjëmimin e madh të historisë.

Atdhe, ku të të ndiej nëse një ndjenjë qënia ime do të ketë,
Të them të të ndiej edhe në lëngun e hirit
Atje ku s'ka lëng e s'ka jetë?
Të them se të ndiej edhe në botën reale krejt të vërtetë,
Edhe në botën e hiçit...

1983 - 1995

Një dëshirë

Fshatar i shtrenjtë, ngaherë ke qenë për mua i mirë
Dhe unë kam mbetur me shpirt pranë teje
Dhe kam ruajtur për ty një dëshirë:
T'u bëftë guri dele...

1982

Çatia e vjetër

Ky dimër do ketë shira dhe erëra shumë,
Këtë e ndiej se kockat më dhëmbin;
Do ketë breshër, dëborë e furtunë
Që gurë e kërcunj të shembin.

Ndaj mendja më shkon në shtëpinë,
Strehën e nënës së ngratë;
S'ia ndreqa dot në verë çatinë,
S'më dilnin paratë.

Tani çatia e vjetër do rrjedhë
Dhe trualli do bëhet lara-lara nga pellgjet;
Nëna supit batanijen e grisur do hedhë
Dhe si guriçkë në qoshen e thatë do dergjet.

Megjithatë nga andej s'do t'i iket.
Le ta mërzhisin pikat në truallin e lagur;
Si një kandil gjer në vajin e fundit do digjet
Nën strehën që bashkë me të është plakur

Harabeli

Dhe shpezët udhëtarë fluturuan
Me shtërg e dallëndyshe - gjithë ç'qenë,
Veç harabeli vendit nuk po luan,
Ai nuk ia beson kurrkujt folenë;

Livadheve të korrur fluturon,
Me sqep në bar çepkat e vërshëllen
Dhe duket se me shokët kuvendon.
Dhe duket se diçka përreth s'e gjen;

Dhe sytë e vegjël hedh përmbi zabel,
Vështron se si mërgohet shpezëria,
Por s'di të thotë zogu-harabel:
“Të çmendur, ju
pse ikni nga shtëpia?”

1955

Peizazh me një re të bardhë

Punova tërë ditën shumë
Ja një re e bardhë mbi kodrinë.
Të mbulohem me të e të bie në gjumë
Këtu në bar, në lëndinë...

E prapë të hap sytë ngadalë,
E prapë në punë...
Një re si jorgan i bardhë,
Një ëndërr e bardhë mbi lumë...

1971

Mikpritja

Nuk mund të rri pa trokitur këtu,
 Jashtë bie shi, jashtë bie llohë,
 Ujërat e udhës më vijnë në gju,
 Nuk mund të rri pa trokitur këtu.

Ndofta zgjuar nuk është asnjëri,
 Portat me lloz, dritaret me reze,
 Jashtë bie llohë, jashtë bie shi,
 Qielli rëndon mbi çati.

Nuk mund të rri pa trokitur këtu.
 Hapet një portë, kërcet një dritare:
 - Bujrum, se zjarri ka dru!
 - Bujrum, se zjarri ka dru!

Hyj e them me vete ngadalë:
 S'na qenka mikpritja moderne?
 Në daç haj ta quajmë patriarkale
 Dhe natën ta gdhijmë në gjerdhe!

Flaka e verdhë, thëngjilli i kuq,
 Rrobat në zjarr më avullojnë.
 Nata largohet si zarbo gërmuq,
 Flaka e verdhë, thëngjilli i kuq..

Një gur a një trung

E dua pa mend vendin tim
Dhe s'gjej një gur a një trung
Ku të ulem pa brengë e trishtim
Ku të ulem si murg.

Kalova mes erërash për të,
U ktheva në hi dhe në shkumb,
Pa të nuk doja të isha asgjë
Dhe prapë s'gjej një gur a një trung.

Ku të ulem i qetë në agim a në muzg...

Çerdhet e zogjve në dimër

Ciniku dimër hip mbi pemë
 Dhe zogjve krejt ua zhvesh foletë.
 Rreth tyre gjethe e fletë s'gjejmë,
 Mbi to shamitë shtrydhin retë.

Dhe ngremë kokën të menduar
 Tek shohim çerdhet buzëplasur:
 "O zogj, sa djersë ka kulluar,
 Sa punë e madhe është dashur!

Një sqep i vogël, majëz pene,
 Dy krahë sa një bllok shënimesh
 Shtëpinë e ngrenë lart në pemë,
 Pastaj e lënë mes thëllimesh!"

Im bir i vogël sa një zoçkë
 Shikon si pikat degës derdhen
 Dhe thotë, duke zgjatur doçkën:
 "A s'u vjen keq që lënë çerdhen"?

Lejleku

Më vjen në mendje një shtëpi
Nën mal mbi lumin me lajthi.

Një plep i vjetër ish në breg,
Ku kishte çerdhen një lejlek.

Askush folenë s'e mban mend
Që kur në plep kish zënë vend.

Po dihet veç një gjë në fshat
Që plepi tok me të u zgjat.

Në sup e mori qysh i ri,
E solli gjer në pleqëri.

Sa gjenerata krra-krra-krra
U hodhën plepit krah më krah,

U plakën, lindën, ikën larg,
Po s'e harruan atë prag!

Paçka se shkuan në mërgim,
Sërishmi erdhën fluturim...

Dhe mars për mars dhe mot për mot
I bënë çerdhes një remont.

Remont, remont e zogj e zogj,
Sa herë fleta u përpoq!...

Më vjen në mendje një shtëpi
Me mollë, dardhë dhe avlli.

Dhe s'e harroj dot atë plep,
Ku kishte çerdhen një lejlek.

Stërnip i tij akoma vjen;
Stërnip, ngjatjeta po të them!

Do pleqërojmë ti dhe unë.
Si ne do lindin shumë e shumë...

1976

Nderi

Kam jetuar ngaherë me nder
Dhe dorën kurrkujt s'ia kam shtrirë,
Tërë jetën kam pasur veç një defter
Dhe në të kam shkruar fjalën e mirë.

E kam gjetur fjalën e mirë në qytet
E në fshat, e në asfalt, e në arë;
Dhe kam ngrënë bukë pa qibër e dert
Me ata që mbajnë lugën në gishtat e vvarë.

Ngaherë kam ecur me nënën Shqipëri
Dhe pas krahut të saj jam mbajtur;
Para saj kam qenë përjetë çilimi,
Çilimi dhe burrë i matur...

1973

Zgjimi i baladave

Unë eci në male e zgjoj balada,
 Se baladat flenë nëpër mure,
 Nëpër shpella dhe selvi të kaltra,
 Nëpër gjurmë e gurë e fletë e shkurre.

Unë gjej një jatagan të ndryshkur,
 Ku ka shkarë dheu pas një gremine,
 Unë nxjerr nën fletëzën e vyshkur
 Një fishek të vjetër karabine.

Unë marr nën plloçën e një shpelle
 Një nagant të ngrënë lagështire,
 Unë shtang nga kafka nën kapelë
 Në një guvë mbushur errësirë...

Unë shkoj në gërxhe e zgjoj balada,
 Dhe baladat malesh mbetën gjallë,
 Se i mbolli rrugëve të gjata
 Historia derdhur valë-valë...

Fushë - Kosovë

Ah, të çlirohej vetëm me vjersha Kosova,
Unë e çliroja i pari, mua lavdia më ndriste të parit.
Me shpatën e vargut si pjepra do prisja gjokse dhe koka
Dhe flamurin lart do ta ngrija në malet e Sharrit!

T'i qeshte Kosovës vetëm nga vjershat liria dhe fati,
Unë do bëja me vargjet kërدينë e hatanë:
Në Fushë-Kosovë s'do vritej vetëm sulltan Murati,
Do vriteshin katërbëdhjetë sulltanë,

T'i qeshte Kosovës vetëm nga vjershat liria dhe fati!...

Mars, 1996

Kthimi në Kosovë

Kthehem këtu në Kosovë fill prej mërgimit,
 Kthehem nga lumi i Rejnit, Senës, Sir-Dajres,
 Barin e gjej të tharë nga brymë e trishtimit,
 Gurët të plasur nga peshë e lotit të ndarjes.

Kthehem me shpresë se mund të rri në një kafe,
 Të çlodhem nga rruga dërmuar e vvarë,
 Miqtë t'i shoh dhe dorën t'u jap e t'u hidhem përqafe,
 Se koha ka rrjedhur e malli si dreq më ka marrë.

Mjerisht e gjej dhe kopshtin e tharë nga brymë e mërgimit,
 Rugën e plasur nga peshë e lotit të ndarjes
 Unë, i ardhur këtu në Kosovë pas udhëtimit
 Nga lumi i Rejnit, Senës, Sir-Dajres,

Andej i mallkuari fat më ka hedhur
 Larguar nga serbët që Kafën e miqve ma zunë,
 Dhe jonxhën e fisit pa korrur ma lanë e rrushin pa mbledhur,
 Kazanë e rakisë së vëllait ma hodhën në lumë.

Ah, ç'ishte kazan i çuditshëm, ah, ç'ishte!
 E zjente rakinë e rebeltë, të mirën e botës,
 Dhe miqtë e vëllezërve nga anë e anës i mblidhte,
 I shtronte atje me peshqirë në gjunjë rreth sofrës!...

Ç't'i bësh!... E hodhën kazanin në lumë përtej një greminë
Pas ikjes sime drejt grykës së Rejnit, Senës, Sir-Darjes,
Dhe sofra vëllait i mbeti pa lugë e pa thërrime
Dhe buzët e sofrës u plasën nga lotët e ndarjes.

Kthehem tani e pres në një kafe,
Serbi shpon xhamin e Kafes me sytë e çapluar
Përgjon se cilin kam për të zënë përfaqe
Këtu në Kafën e miqve të mi të bekuar.

Ik, or serb, e më ler të çlodhem këtu te kjo dërrasë.
Tani në filxhanin e kafes vërtitet e ulet një mizë
Më tepër e sjellshme se serbi i trashë,
Kjo mizë e përmallshme hesht në filxhan si kokrrizë...

Në Kafe, të varur në mur, e marr çiftelinë,
Të gdhendur nga mjeshtër të famshëm Prizreni,
Dhe serbi padashur këmbët lëviz e ndjek melodinë,
Pastaj them me vete: "Të munda, or serb, qen bir qeni,
Të munda kjo çifteli e gdhendur nga mjeshtër Prizreni"!...

Kthehem këtu në Kosovë fill prej mërgimit
I lodhur nga lumi i Rejnit, Senës, Sir-Darjes,
Misrin e gjej të tharë nga brymë e trishtimit,
Miqtë i gjej të lodhur nga peshë e mallit të ndarjes...

Nusja nga Kosova

Kam dashur t'i gjeja dhe nipit tim të vogël një nuse
 Andej nga Kosova në fshatrat e thella,
 Po kjo ka qënë një ëndërr pas zjarrit me flakë të kuqe
 Si valë e flamurit tek shpella.

Ka qënë vërtet një ëndërr në viset e mia me gurra,
 Ku rrjedhin ujrat, por unë etjen e verës zor se e shuaj.
 Kam dashur nusen e nipit të mos e marr me vetura,
 Po veç si qëmoti me kuaj.

Një muaj të tërë le të zgjaste udhëtimi me kalë,
 Me pluhur mbi vello të vinte nusja e nipit tek unë,
 Me dorën time t'ia shkundja duvakun palë mbi palë
 Atje tek oxhaku, ku kafja në xhezve bën shkumbë.

Dhe s'kishte gjë, le të binte pluhur i udhës së largët
 Në vatrën time të vjetër sa përralla,
 Po kjo nuk ndodhi mes botës së ligë e të varfër,
 Ku rron ky fisi ynë i ndarë në dysh plot andralla,

Ku s'merr dot një nuse për nip a për djalë,
 Se fisin e ndan kufiri me dy pashaporta;
 Këto pashaporta s'të lenë të marrësh nuse me kalë,
 As me vetura, as me trena dhe as me aviona ndofta...

Kam ëndërruar t'i gjeja një nuse tim nipi të dashur
Në fshatrat e thella andej nga Kosova,
Se s'desha të shkoja në tjetrën botë me buzë të plasur,
Ta shuaja etjen e mallit për aq sa rroja.

Mars, 1996

Kujtesa e Atdheut

Me shumë se një gjysmë e rëndë shekulli
Më shkoi në rrugët duke udhëtuar,
Sikur t'i kisha kockat krejt prej hekuri
Vërtet do më ishin tretur e harruar
Në gjysmën aq të rëndë të një shekulli.

Por ja që rroj dhe trupi im le gjurmë
Në trupin e Atdheut tim të lashtë.
Më mbeti formë e shpinës kapot-murrmë
Në shpellën fjetur qoftë veç një natë,
Por ja që rroj dhe trupi im le gjurmë.

Ka mbetur dhe ulliri im i mbjellë
Me trung murrash përdredhur gunga-gunga
Lëkurë-hidhur futur rrënjët thellë
Në tokën e sflitur rrudha-rrudha
Ka mbetur dhe ulliri im i mbjellë.

Dhe gjurmë e këmbës sime aq të madhe
Më mbeti baltës tharë bri një rruge,
Që pikëlluar dridhet në livadhe
E pjekur si një kore e misërt buke
Dhe gjurmë e këmbës sime aq të madhe.

Më mbeti gjurmë e mallit përvëlur
Mes brengave të mia që s'u sosën:
Po shkoj në botën tjetër i trishtuar
Në gjoks të nënës s'pashë dot Kosovën,
Ndaj mbeti gjurmë e mallit përvëlur.

Më mbeti gjurmë e mallit të përgjakur
Në Kaçanik, nën mjegullat e Sharrit,
Në rrudhat e Prizrenit të pamplakur,
Ku dergjen pergamenet e shqiptarit
Më mbeti gjurmë e mallit të përgjakur.

Më mbeti rrudhë e shenjave të thella
Ndër akujt e Tomorrit dhe Korabit,
Në bark të Dukagjinit plot me shpella,
Në shpatullat e Shpatit dhe Cukalit
Më mbeti rrudhë e shenjave të thella.

Ç't'i bësh!... Jetoj dhe trupi im le gjurmë
Dhe s'njeh sinor në gjithë Shqipërinë,
Kosovë qoftë, a Korçë, a Konispol, a Lumë,
A Myzeqe, a Krujë a Trebeshinë;
Ç't'i bësh!... Jetoj, ndaj trupi im le gjurmë.

Ka mbetur radhë e shenjave të mia
Mbi një qershi dhe mbi një gungë lisi
Atje ku trupin shpesh përdredh hardhia,

Kur lëngun mbledh, me lëng të dehet fisi,
Ka mbetur radhë e shenjave të mia...

Ka mbetur dhe kjo njollë e kuqe e verës
Që derdha tryezës sipër sofrabezit
Dhe s'doli dot sa herë u la prej mbesës
Që s'dinte ç'ishte rrushi i Kallmetit,
Prandaj ka mbetur njollë e kuqe e verës.

Më mbeti dhe një pikë e tharë gjaku
Në rrudhat e një guri pas avllisë,
Kur tinëz më qëlloi një ushtar së largu,
Ushtar i huaj ditën e lirisë,
Më mbeti dhe një pikë e tharë gjaku.

S'do mend që gjurmët s'janë të përjetshme,
I fshin njeriu, dëbora, ngrica, moti
Siç fshihen dhe plot gjëra të paprekshme
Ku seriozisht, ku ndofta kot së koti,
Se ndodh që gjurmët s'janë të përjetshme.

Megjithatë Atdheu për mua thotë
Në heshtje si shenjtori plak me mjekër:
"Ky bir, që nuk u lodh, bekuar qoftë,
Si ky t'i linte gjurmët dhe një tjetër!"
Kështu Atdheu për mua heshtur thotë.

Qeleshja

Ku shkoi qeleshja e bardhë që fekste Evropës,
Që mburrej shqiptari fatkeq me të huajt?
Besoj se u var prej kohësh në brirët e lopës,
Apo me atë mund të sjellin nga çezma ujë për kuajt?

Ku vajti qeleshja që rrinte si gonxhe mbi çiftelinë
Dhe sillte nderimin dhe paqen ndër oda?
Tani me qeleshen përcjellin mërzinë,
Në guvën e saj po fshihet hashashi dhe droga.

A ndofta në kënd të vitrinës me xham të muzeut
Qëndron si relike përmbys nga pluhuri fshirë,
Qeleshja që mblidhte flokët shqiptare me ngjyrën e dheut
Dhe fekste mes trotuaresh qyteti, a shtigjesh tej në rrëpirë.

Sot zor se feks kjo qeleshe këtej dhe andej në Evropë,
Madje as në malet e Sharrit, Rugovës dhe Dajtit;
Atë mund ta gjeni diku në një gropë
Me shishet e hedhura të San Benedetos dhe DASH-it.

Ah, sa moderne ka qënë qeleshja për herën e parë në kokë!...

Balada e tre të rënëve

Me dhentë ktheheshin nga mali tre kosovarë,
 U zunë pritë serbët në gjunjët e Sharrit
 Tek era fletët e vyshkura hiqte grykave zvarrë,
 Tek vërshëllenin fijet e holla të barit.

I vranë e qirinj s'u lanë të ndezur në darkë.
 Në vendin ku ranë tek blegërinin dhentë
 I frynë serbët qirinjtë me gojët si kacakët në farkë,
 I shuan, mos dukeshin të rënë të shenjtë.

Po dhentë gjuhët e tyre me erën e barit
 I nxirrnin si flakë qiriri me krye drejt qiejve
 Dhe qanin me blegërima në gjunjët e Sharrit
 Tek hëna të rënëve u qepte qefinët me fijet e reve,

Ndërsa hutini vajtonte në degën me gunga të qarrit...

Psalm i ri për tokën

*Në kujtim të mikut tim,
shkrimtarit të madh Jakov Xoxa*

1.

Për ty i përzjeva me duar dheun dhe retë,
Të mbinte një fije bari,
Të rritej një bri dhie e një kallëz;
U ula në gjunjë,
Me krahë të ngritur nga qiejtë,
U luta përhumbur në lot,
Si dervishi në përrallëz:
Bekuar qofsh, o tokë, për sot e për mot
Dhe kurmi yt i pastë të gjitha blerimet përjetë,
Amen!

2.

Për ty vajtova.
Kur fija e barit u tha nga vapa,
Kur kallëza e grurit u shkund nga një breshër,
Kur dhisë i mbetën brinjët si shkarpa,
Kur kaun ma çau e ma hëngri ujku,
Dhe pulën ma mori një dhelpër,
Dhe gruas sime iu thanë sisët si shterpë.
Dhe flisja lajthitur me vete
Si një dervish që numëron gjurmë dhe hapa:

“Nesër, nesër,
 Blerime do kesh, veç pritma rrugën, o tokë.
 Mos kthehem prapa,
 Me trupin tënd më bëj barrikada
 Dhe shamë: mos u kthe prapa”!
 Amen!

3.
 Për ty sërishmi i përzjeva me duar,
 Dheun dhe retë,
 Të mbinte fija e barit,
 Të rritej kallëza dhe briri i dhisë.
 T’i mbushej gjiri gruas sime me qumësht,
 T’i jepte tim biri sisë,
 T’i qethja dhentë e t’i bëja tim eti
 Me leshin e tyre shajak për xhaketë:
 Pa mbolla dhe pakëz duhan të sertë
 Ta pija në çaste mërzie
 Nëse të kanosej, o tokë,
 Një ditë e rrebeshtë,
 Amen!

4.
Tokë e dashur.
 Diçka ngaherë ke kërkuar nga unë,
 Që kur kam hedhur të parat hapa.
 Kur bija mbi ty e vrisja duar e gjunjë,

Ti thoshe:
 S'ka gjë, bir,
 Vritu e mos u kthe prapa!
 E kam ndier këtë nga avulli yt i ngrohtë,
 Nga era jote,
 Që përgjërohet e dehet bujku me gunë,
 Ai bujk i menduar,
 Që i dhimbset çdo brazdë e gropë,
 Amen!

5.

Ç'bëra unë për ty?
 Lërova,
 Mbolla e korra,
 Dhe shumë u mundova,
 Të të krihja me krëhër fisnikërie:
 Me duart e mia si krëhër rrënjët e liga t'i nxora
 E thitha nga ti avuj dashurie.
 Edhe kur më mërzitnin plugu e parmenda,
 S'të shava,
 Se ati im, pastë ndjesë,
 Kurrë s'të shante
 E kurrë s'të thoshte fjalë të rënda,
 Po ulej në gjunjë,
 Të puthte i mbytur në djersë.
 S'të shava,
 Se nëna ime veç ty të besonte:

I falej kokrrës së grurit,
 Kokrrës së vogël me vijë në mes,
 Dhe para saj duva e lutje këndonte,
 Dhe para saj merrte avdes.
 Po unë,
 I ulur në arë në mbrëmjet e gjata,
 Tim eti i thosha,
 Që heshte me opinga me dhe.
 Që qante mbi plisat e thatë:
 - Toka, baba, diçka kërkon nga ne...
 Im atë kokën e thinjur e tundte,
 Dhe fliste ngadalë:
 - Kërkon !
 Dhe buajt shikonin tim atë me sytë e xhamtë:
 - Kërkon !
 Dhe lumi i binte shkëmbit të rrudhur me valë:
 - Kërkon !
 Dhe zogu i mbrëmjes qante në plepin e lartë:
 - Kërkon !
 Amen !

6.

Tokë e dashur,
 Të lashë pak vjet me dëshirën tënde djerrë,
 Se larg më thirri grykë e historisë
 Me zhurmë e gjëmime,
 Dhe atëherë m'i pe në brez nagantin dhe maliherë.

Dhe zogjtë urdhërove
 Të më përcillnin plot cicërimë;
 Urdhërove barin e egër e fletët e drurëve,
 Urdhërove lumenjtë e burimet,
 Që mban nëpër deje,
 Të dilnin dhe birin tënd ta përcillnin udhëve
 Dhe t'i thoshin: vëllaçko, hap sytë,
 Se unë jam toka, diçka kam dashur prej teje !
 Në çast,
 Me maliher në dorë, i bukur, i shpejtë,
 Besova në zërin tënd të trishtë e të zgjatur.
 Në zërin që e ndjeva në lumë, në bar e në fletë
 Dhe anës udhës u ula në shkëmbin e plasur:
 “E di, tokë e dashur,
 Diçka ke kërkuar nga unë”!
 Amen!

7.

Shtriheshe ti para meje.
 E ardhur si buka e grurit në verë,
 Kur nëna e nxirrte nga magja,
 Me avull dhe erë,
 Në çastin kur mbretëron qetësia dhe paqa.
 Rrija e mendimet si zogi mëngjeseve bridhnin
 E djersët i fshija me mëngë
 Në shkëmbin e plasur,
 E djersët prapë në tokën e vakët rridhnin,

E thosha me vete:
 “Kërkon nga unë
 Aq shumë,
 O tokë e dashur”!
 Dhe ti i kuptoje mendimet e mia,
 Ndryshe s’kishe përse të më nisje aq larg,
 Dhe ti e dije se unë isha,
 Një grusht me shkëndija.
 Një grusht me shkëndija i zjarrit tënd të madh...
 Amen!

8.
 Ecja me nagant në brez në barin e njomë,
 E ty të dëgjoja
 I kredhur krejt në mendime:
 Të kemi për të mbajtur
 Në duart e fisnikërisë sonë,
 Si bukën e ngrohtë.
 O toka ime !
 E plumbit nazist ti lisa i nxore përpara.
 E plumbin nazist e prite me gurë
 Dhe mua më mbrojte.
 Që prapë të vija në ara.
 Që djerrë mos mbeteshe
 E bar të lig të mos zije kurrë.
 Atyre që ranë ti s’kishe ç’t’u bëje,
 O tokë,

Megjithëse iu vure malet e tua si prita batare,
Armiku kish përgatitur
Një milion plumba veç për një kokë,
Një milion plumba
Veç për një zemër shqiptare!
A nuk të kujtohet
Si njëri nga një milion plumbat e nxehtë
E ndoqi atë
Që vinte pas meje në shteg të një mali
Atë që ngiste në brazdat e tua qetë,
Dhe zemrën ia gjeti,
Dhe frymën ia ndali?
Kur sytë po mbyllte,
Lëvizi ngadalë buzët
E në agoninë e mëngjesit tha:
“Ne jemi bujq
E si bujk dëgjo veç një muzë,
Muzën e tokës së njomë, vëlla!”
Me dorën tënde,
O tokë,
Pishat ule mbi trupin e tij
Dhe gjirin e hape dhe nxore një lulëshqerë
Pranë fytyrës së zbehtë të djalit të ri,
Pranë syve të mbyllur e ballit të gjerrë.
Amen!

9.

E çfarë s'kam bërë për ty,
 O tokë e dashur,
 Në këmbët e malit shkrepat i shtyva me supa:
 Shtyhuni pak,
 Or vëllezër, - u thashë -
 Dhe hapni udhën të kalojë buka!
 Mora me grushte ujë në lumë
 Dhe vadita hardhinë të mbajë bistakun,
 Nën fletët e saj kutruve solla e gunë
 Dhe natën e shtrova jatakun,
 E mbajta dhe qenin tim pranë
 Dhe çiftën e mbushur nën kokë,
 Se s'desha të merreshe nëpër këmbë prapë,
 Se s'desha të mbeteshe djerrë e shterpë,
 O tokë!
 Vetëm ai,
 Që ka thithur avuj ugari
 E di gjer në fund fjalën djerrë!
 Djerrë do të thotë trishtim i tmerrshëm,
 Trishtim fshatari,
 Trishtim që zvarriset ferrë më ferrë...
 Që ti të mos mbetesh shterpë kurrë,
 Unë kallot i kam sa një kokërr arë në gishta,
 Unë ngarkohem në shpinë me gurë,
 Unë lëroj dhe zallishta...
 Që ti të mos mbetesh djerrë në jetë,

Unë bëj dashuri dhe gruaja ime pjell fëmijë;
 Se djerrë do të thotë:
 Mëngjes e mbrëmje mos ketë.
 Mos dalë tym e mos ndritë shkëndijë,
 Se djerrë do të thotë uri dhe hakmarrje,
 Grabitje dhe grindje në rrugë e në kopshte,
 Dhunë e çnderime dhe ndarje.
 Qivure e vajtime të kobshme.
 Amen!

10.

Tokë e dashur.
 Kam takuar, tek dorën mbushja me grurë,
 Atë që e shihja në çdo kokërr farë,
 Atë që e shihja
 Kur ulja kryet të pija ujë në gurrë.
 Atë që e shihja
 Në çdo pikë vese kur kositja barë.
 U drodha.
 Gjoksi i saj çante këmishën
 Dhe me aromë mbushte ugarin e mbjellë.
 Dhe mbeta me dorën e mbushur me grurë
 E mëndtë m'u prishën:
 Ish koha,
 Kur hidhej fara në arën e lëruar thellë.
 Dhe e desha atë si fshatari arën me farë,
 Dhe çmendesha pas saj si fshatari pas shirave,

Të rënë në kohën e vapës në arë,
 Kur zien çdo gjë prej të mirave.
 U rraha për të në mbrëmjet e errëta,
 Me njerëz të ligj në shtigje e rrugë të pjerrëta.
 Dhe kisha frikë
 Se ndofta dikush më i mirë se unë,
 I shfaqej në gjumë...
 Se unë për gruan e tokën,
 Lë kokën.
 E kam kërkuar
 Ngaherë dashurinë tokësore.
 Më të bukura se madonat e muzeve
 Kanë qenë për mua
 Gratë e vajzat arbërore,
 Që tok me mua u kanë dhënë ujë
 Kuajve e qeve,
 Që tok me mua kanë ecur në pllaja e shpate
 Me vezme në brez e maliher në krah,
 Që tok me mua kanë prashitur me shatë
 Dhe grurë kanë hedhur në vrah.
 Kam qenë në galeri botërore arti,
 Mona Liza si tonat s'kam parë !
 Ndaj në këngë kam kënduar për gratë,
 Kam kënduar në lëmë,
 Kam kënduar në arë,
 Kam kënduar mbi gurin e thatë.
 Amen !

11.

Tokë e dashur,

Dua të di,

Të kuptoj,

Të gjej në ty veten.

Sa herë futem thellësive të tua,

Aq më e vështirë më dukesh.

Dikur nga trupi yt njihja

Vetëm një copë të vogël sa një lëpjetë.

Ëndrra ime ishte pënda e qeve

Dhe një kasolle bujqish,

Ku mund të vareshin muresh kurora me qepë,

Dhe vargjet e gjatë me specat të skuqin,

Të kishte për kalin pak elb e pak tepë

Dhe molla në oborr t'i mbante degëve lulet,

Dhe lumi mos delte të mbyste patatet,

Dhe bar të mos zinin fasulet

Dhe bryma herët mos digjte domatet...

E bridhte kjo ëndërr livadh më livadh,

E bridhte kjo ëndërr në fletët e misrit e grurit

Kopshteve të kaltra mbështjellë me gardh

Atje ku binte nga shpati cefla e gurit

Atje ku vërsnikja ime mbushte kanaçet,

Që binin erë dëllinjë e pishë,

Atje ku uji spërkaste në bar manushaqet

Dhe çirrej në gjethe një grifshë...

Po unë e ndjeva se vetëm një grimëz të njihja,

Kur herët në prag komunistët m'u shfaqën.
 Çdo gjë m'u trazua,
 Çdo gjë nuk e prisja:
 M'u mpleksën mëria me paqen...
 Dhe ika larg me ëndrrën komuniste.
 M'u hap krahërori dhe ëndrrën gëlltiti.
 Nga gjoksi im ajo dilte e thërriste
 Dhe tjetër botë më joshte shpirti.
 Nuk them se s'bëra asgjë,
 Po shumë gjëra më dolën së prapthi
 Dhe ëndrra më ftohej si gur e si gdhë,
 Se toka më lutej të shkoja me të.
 Amen !

12.

Dhe dole ti, tokë,
 Enigmë para meje:
 Lumturia ime e fatkeqësia ime;
 Lumenjtë e tu nuk ishin lumenj,
 Po gjaku im nëpër deje,
 Burimet e tua ishin lotët e mi e s'ishin burime.
 E ndjeva:
 Vireshin majë për majë hanxhari dhe bajoneta:
 Për ty.
 E ndjeva:
 E linte burri gruan në vatrën e lashtë:
 Për ty.

E ndjeva:
Digjej streha e mbeteshin kërthinjtë jashtë:
Për ty.
E kujt do të ishe?
Cili do kishte të drejtë,
Të të lante me djersë?
Ah, uturinë vite në rrudhat e tua,
Sërish e sërish unë futem ndër këto rrudha.
Feneri i shpresës kurrë s'm'u shua!
E ashpër ish udha,
E largët ish udha...
E prapë dua të di të zbuloj thellësitë.
Nëse në fillim mund të shoh një korije,
Një pllajë,
Çapitem më tutje e ndiej bukuritë,
Përherë të reja.
Nga maja në majë
Amen !

13.

Tokë e dashur,
E sheh edhe ti që s'jam aq i qetë.
Nga dita në ditë zihem për ty,
Përpiqem e vuaj,
Zihem me veten time të shkretë,
Zihem me shokun,
Kur brumin tënd nuk di ta gatuajë,

Zihem si dreqi në parlament me gallofët,
 Që unë i quaj deputetë,
 Zihem që ti të mbetesh përherë e ngrohtë,
 Përherë e blertë;
 Zihem se unë kam mbirë,
 Si smagu i grurit në brazdat e tua,
 Dhe s'dua,
 Që mendimi i lig të të hajë si erozion,
 Se erozioni për ty
 Është skleroza për mua.
 Që blerimin e vyshk e brinjët zbulon...
 Amen !

14.

Për ty i përzjeva me duar dheun dhe retë,
 Të mbinte një fije bari,
 të rritej një bri dhie e një kallëz;
 U luta në gjunjë me krahë nga qiejtë
 Si dervishi në përrallëz...
 Dhe shpejt më ra shorti i bujkut
 Dhe shorti i poetit:
 Lëroj arë me plug e lëroj kartë me pendë,
 I hap udhë hardhisë e udhë poezisë tënde;
 E s'e ndava plugun,
 Pëndën dhe gotën,
 Po brodha me ta nga caku në cak,
 Dhe gati jam të zihem me botën,

Për ty,
Të ujis kërcellin e grurit
Me djersë, raki dhe me gjak.
...Ndaj kur sytë të mbyll
Diku në shteg a në brazdë,
Do doja të më mbështillje
Me qilimat e kaltër të tu
E të merrje me fyell një kaba të lashtë,
E t'u thoshe udhëtarëve:
“Fle biri im këtu!
Fle këngëtari i ugarit,
I brazdave, rakisë dhe zogjve.
Amen!” ...

1967 -1994



Magjepsjet e perëndimit

E tall pleqërinë

O moj plaka lozonjare,
Që ndjek fatn'e njerëzisë,
Dhe masë e peshë s'ke fare,
Po me shkop të marrëzisë.

Naim Frashëri

*Unë e shoh se pleqëria terse
Më vërtitet heshtur të më kapë,
Zjarr i hap kudo me saçma vjershe,
Po s'merr vesh nga vjershat kjo e prapë!*

*Veshur me çitjane rri e thotë:
"Në ke nge qëllo dhe me romane,
Para meje s'del njeri në botë,
Se i fut të gjithë në çitjane!"*

*Thotë ç'thotë s'trembem nga kjo shtrigë,
Çiften do ta mbush sërish me vargje,
Le të shtiret gjoja se s'ka frikë,
Jam betuar, s'do ta lë në paqe...*

*Dhe patjetër shpejt ka për ta parë,
Po s'e lashë shtangur e habitur,
Sa të thotë: "Ç'bën ky plak i marrë,
Mua po më tall ky i lajthitur?"*

1983

Pleqëria

Pleqëria vjen e pakuptuar,
 Vjen ngadalë pa zile, pa këmborë;
 Gjurmëve të tua duke shkuar
 Flokët t'i pudros me pak dëborë...

Në fillim s'e ndien qafiren plakë,
 Se këmbora s'bie, kur bredh mbi tokë,
 Se s'troket këpuca në sokakë,
 Vetëm se dëbora zbardh në flokë...

Po pastaj të vjen të zë në gjumë,
 Duke hyrë fshehur nëpër derë,
 Dhe të thotë tinëz e pa zhurmë:
 Mik i dashur, si s'më paske ndjerë?

Dhe at'herë shpejt për të kujtohesh;
 Gjunjët zënë e therin nën jorganë,
 Herët në mëngjes fillon e zgjohesh
 Dhe kërkon dhe xhezven dhe filxhanë...

Ja, kështu e nëmura, si erë
 Rrugës lehtë shkon me shkop në dorë;
 Por tek unë s'ka si vjen pa ndjerë,
 Do t'i var në qafë një këmborë,

Që nga larg këmbora t'i dëgjohej
Nëpër gryka, kodra e tarraca
Dhe ta ndiej kur qaset dhe afrohet,
T'i zë prita, shpejt të marr ca masa;

T'i bërtas nga larg me tërsëllimë
Dhe ta tremb si bushtrën pa mëshirë:
Shporru, qëne, mos më prish rininë,
S'e shoh dot surratin tënd të mpirë!

1977

Në fund të vjeshtës

Me bastun bredh era qorre,
Zbret në lumë e shkon në varre,
Pastaj hidhet ndër oborre
Dhe troket në çdo dritare.

Çmendet vjeshta si një bushtër,
Fletë e fruta hedh përnatë,
Diçka treti mollë e shkurtër.
Diçka humbi plep i gjatë.

Diçka humbëm ne të gjithë:
Çka s'lind nesër çka s'vjen prore:
Nëpër rrugët dhe avllitë
Me bastun bredh era qorre...

Zgjimi nga gjumi

Po qaja... Kish ardhur fëmijëria,
Jastëku i zhubrosur ishte i lagur,
Në mur-një fletë e bardhë me vijë,
Në truall-këpucët, si varka nga valët flakur.

Pastaj, në pasqyrën kristal një fytyrë,
E vyshkur, me rrudha shumë,
Dy lotë prej plaku me flokët me lyrë,
Dhe ky isha unë...

Fantazi

Gjysmën e viteve do ta fut në torbën e vjetër
Dhe do ta lë në dhomën time të gjumit
I ri, i shkarkuar nga gjysma tjetër,
Do nisem për udhë pas lumit.

Njerëzit do më pyesin se si e ktheva rrinë
Dhe do t'u them, duke vështruar në shelg një korbë:
“Vërtet jam i ri pa rrudha e thinjë,
E lashë gjysmën e viteve në torbë”!

Shtëpia ime e vjetër

Kjo shtëpi e vjetër është një libër,
Muret e saj të shkruara janë kronika
Nga dalin hijet krejt si në Bibël,
Hijet që rrojtën dhe vdiqën, a ranë nga plumbi e thika.

Shkronjat në mure ju s'mund t'i dalloni,
Veçse me thua pak t'i gërvishtni
Zgjohen zërat dhe hijet flatrojnë si zogj nga ballkoni
Dhe kthehen sërishmi.

Ky libër me trarë bart mall dhëmbshurie
Dhe kurrë s'lejoj t'i preket qoftë e një bigël.
Se muret lëndohen e qan çdo shkronjë e çdo hije,
Ndaj e kam vërtet si një Bibël...

1993

Bucela e çuditshme

Për këto që ju them jam menduar aq shumë!
Tani që këmbët ende i kam të fuqishme,
Do nisem me bucelën në shpinë lumë më lumë
Dhe kjo do jetë bucelë e çuditshme...
Do ndalem pastaj mes ujit të thellë,
Të marr lumë më lumë veç nga një lugë
Dhe gjithë lumenjtë t'i kem në bucelë,
Me gjithë lumenjtë mbi shpinë të nisem për rrugë...
Ta ruaj bucelën në shtëpinë time,
Që kur të plakem një ditë,
Të rri e të ndiej në dhomë me mall ligjërime
Nga gjithë lumenjtë e mi të flarinjtë;
Me vrap në timpanin e veshit tim të buçasin
Turbinat e Drinit, Vjosës, Devollit, Bistricës e Matit
E vitet rinorë në dhomë të zenë të flasin
Dhe veten time ta shoh në shtigjet e shpatit...

1983

Frymëmarrja e lumit

Natën i shtrirë merr frymë lumi,
Brigjet e ndiejnë frymëmarrjen e tij,
E ndien dhe ti i pagjumi,
E ndien dhe vajza jote e rënë në dashuri.

Natën merr frymë lumi si gjëja e gjallë,
Gjëja e gjallë që brigjeve e heshtur kullot...
Mes kësaj frymëmarrje të rrallë
Pse vallë ty të pagjunit të derdhet një lot?

Në rrudhat e mia

Në rrudhat e mia idetë e gjurmët e sendeve janë të gjitha:
 Blerimi i gjelbër i grurit dhe pjekja e tij e florinjte,
 Hijet e vajzave të dala nga lumi me shelgje e driza
 Me flokët e lagura hapur si penjët e leshtë mbi gjinjte.

Në rrudhat e mia s'largohen, por mbeten përherë
 Ngashërimet e hithrës së shpresës së gjatë
 Dhe coprat e imta të zemrës së plasur në erë
 Ashtu si pëlçet një granatë.

Gërmime arkeologu të bëni në rrudha
 Do gjeni lëvozhga legjendash nga gjyshërit të ngrëna
 Në sofra të vjetra legjende tek qante lahuta
 Nën erë varrezash spërkatur nga hëna.

Në rrudhat e mia poçet plot hidhërim kanë mbetur,
 Doemos dhe kripa e tharë e lotëve të luftës dhe paqes...
 Pastaj në fundin e rrudhave, nën ndryshkun që duket i heshtur,
 Ka copra letrash ku qajnë e vikasin fjalët mes vargjesh.

Atje të gjitha janë e asgjë nuk ka vdekur.

Era e natës së dimrit

Dikush rënkon në varreza,
Dikush përgjon në dritare,
Dikush me rrobe të zeza
Vrapon në livadhe.

Njeriu i panjohur të shfaqet
Me krisma në kyçet e gjunjëve,
Me perçe të zezë mbi faqet
Nxiton i çuditshëm rreth mureve.

Ç'kërkon ky njeri nëpër natë
Pas qyngjeve rrotull pallatit?
Mos doli me perçen e gjatë
Nga dimri mes trurit të Uajllidit?...

Plaku i bukur

Mua më pëlqeu një plak aq shumë
Sa desha në çast të bëhesha plak!
Ballin e kish si balli i shkëmbit në lumë,
Mendonte e fliste nga pak.

Dinte e dinte plot historira,
Po s'fliste kurrë pa shkak,
Po ishte fisnik si librat e mira,
Ndaj desha në çast të bëhesha plak!

Dhe s'u përmbajta, i thashë papritur;
Se desha të bëhesha plak;
Ai m'u përgjegj me vetullat ngritur:
“Prit edhe pak”!

Kjo ndodhi kur isha fëmijë,
Kur prisja gjyshin në prag...
Asnjëherë ajo ditë s'do vijë
Ta takoj atë plak;

Veç di se një tjetër ditë afrohet
Parmak më parmak,
Që fjala e plakut krejt të kuptohet:
“Prit edhe pak”!

Flutura të zeza

Bëhem fetar kur shkoj në varreza;
Vërtet nga vetja më vjen pak çudi!
Rreth meje flutura të zeza
Me krahë të zinj në zi.

S'kam parë kaq flutura të zeza
Në asnjë lëndinë e në asnjë vënd
Sa këtu në varreza
Kur vij të shoh varrin tënd.

Ato mbi gurët e varreve rrinë
E ngrihen të zeza sërish
Pa dashur të sjellin në mend perëndinë
Edhe sikur të jesh ateist.

Nostalgjia

Po ai sënduk i drunjtë me letër të ngjitur,
Po ajo vazo e vockël me lule zambaku,
Po ai mulli kafeje me mbulesë të grisur,
Po ato tespije - kujtim i vjetër nga plaku;

Jeton me këto pak gjëra e shkreta,
E prek sëndukun e drunjtë e të lashtë,
I ledhaton tespijet cipësedefta,
E fshin vazën e vockël brënda e jashtë

Dhe nusja e djalit e sheh dhe prish cepin e buzës
Me kokën e bukur mënjanë;
Vështrimin plaka e ndjen me duart kryq sipër bluzës,
Dhe thotë me vete: “Po ç’kanë me mua, ç’kanë”?

Perëndimi i diellit në det

Dielli ulet në det kuqalash
Si në govatë fëmija krejt lakuriq;
Duart në ujin e kripur përplas,
Nga kripa sytë i fshin e buzët i prish.

Pastaj dikush e mbulon me jorgan
Dhe deti në djep e përkund.
Një zë i largët... Qesh apo qan?
Zë në hapësirën pa fund.

Përvojë për së mbari

Tri hyrje ka pallati ynë i lartë,
 Në hyrjet u rralluan pleqtë e shkretë,
 Disa nuk dalin dot nga shkallët jashtë,
 Disa u shuan si qirinj të zbehtë.

Në hyrjen fqinje s'mbeti plak në derë,
 Këtë kam mbetur unë dhe Jashari,
 Takohemi veç rrallë e tek në verë,
 Në dimër s'dalim se na grin acari,

Dhe presim kush i pari të largohet
 Dhe cili në arkivol të verë krahët;
 Jashari është ushtar që s'dorëzohet,
 Ndërsa dhe unë sheshit s'i hedh armët...

Kështu, vëllezër, jam pak më i vështiri,
 S'largohem po s'u nis andej Jashari,
 Ta shoh si ndrit në varr të tij qiriri,
 Të kem dhe një përvojë për së mbari.

Në ikje

Si syri i buallit hapet e mbyllet semafori në rrugë
dhe pres në këmbë lejen e tij.
Më shfaqet në mur silueta jote si perpelugë
Dhe kokën kthej ta arrij.

Shpejton? Këtej do kalojmë me lejen e këtij sybualli,
Por prit, se unë në turmë të humb.
I nxehtë në verë është trualli,
Ne këmbët i kemi në shkrumb.

Megjithatë ne do të ikim se këtu është nxehtë
Do të ikim, kur bualli i rrugës të na bëjë me sy.
Asgjë s'do të marrim me vete
Veç ëndrrës që shpejt një shtëpi prej rëre të ngremë të dy.

Ne do ta donim në det shtëpinë krejt të kristaltë
Sikur dhe në rërë t'ia bënim aty për aty një themel
Pastaj do mendonim të dy nën teshtimën e valës një natë:
Edhe kristali nga rëra e rërave del...



Humb se erdha që të humb

Flakë e verdhë

*Aheve nxitoj me bluzë veshur;
Ahet flakë e verdhë i ka ndezur;
Flakë e verdhë e vatrës që ka vjeshta,
Flaka që pjek misra edhe vreshta.*

*Ahet qeshin: "Mblidhi udhës fletët,
Janë letra vjeshte për poetët!"
Dhe më japin zarfe si postierë,
Shkruar me kalem vjeshtor të verdhë.*

*Vjeshta një përgjigje pret patjetër;
Pret t'i them ca fjalë në një letër;
Dhe poeti s'bëhet aq i prapë
Letrave përgjigje mos t'u japë,*

*Letrave që nis me postë vjeshta
Udhëve në pyje, ara, vreshta,
Natyrisht poeti ka plot punë,
Po një letër s'ha dhe kohë shumë!...*

Para dhe pas shkrepëtimës

Një qetësi e tmerrshme ra mbi tokë
Dhe s'pipëtinë zogj e bar e gjeth,
Veç retë kuvendonin kokë më kokë,
Këto stratege shirash e rrufesh.

Pastaj e hodhi blozën errësira,
Çdo gjë e ndali frymën dhe u tkurr,
Veç ndonjë gur shkëputej në rrëpira
Dhe ankthi i rëndë ngrihej si një mur.

Të dukej se në heshtje diçka ziente,
Të dukej se të fshehta ishin grindjet
Dhe pritej një tronditje të shpërthente
Dhe me rrëmbim të hynte gjer në indet.

Por shkrepëtiu dhe malet kryelartë,
Si perandorë u ngritën prapë në fron;
Kurorën e rrufeve, krejt të artë,
Me mburrje e treguan në horizont.

Dhe bari derdhi gjithë gjelbërimin
Dhe zogjtë derdhën këngë e ligjërim,
I verdhi ankth me heshtjen dhe trishtimin
Rrëpirave u shkrinë me nxitim.

Dhe burri la dyshimet dhe mërzitë
Dhe gruan përqafoi në prag me mall,
Pas shpine mbetën zënkat dhe mërjitë
Dhe dashuri e hershme u ringjall...

Çdo gjë e turbullt, e paqartë u qartësua,
Çdo grindje e mërzitshme mori fund,
Se tërsëllima me rrebeshe u lëshua
Dhe botë e vogëlsirave u shkund.

Përrenjtë

Eh, këta përrenjtë natën vonë,
 Kur s'fryn erë e kur s'lëvizin fletët,
 Herë gurgullojnë larg e herë ushtojnë,
 Herë shkrepave me bërryl u bjenë,
 Dhe s'e dimë ç'thonë tatëpjetë,
 Dhe s'e dimë ç'gjuhë e zëra shpjenë!

Kur në fshat më zënë ters netët
 Dhe rri në odë heshtur e pa gjumë,
 Ndiej pas çatmës tek kolliten pleqtë,
 Ndiej pas çatmës erën e duhanit,
 Them: përrenjtë mbartin nëpër shkumë
 Mendimet e pleqve poshtë zallit.

O, sa zëra pleqsh me vete mbartën
 Gjatë gurgullimës së përjetshme,
 Zëra në një zë të mbledhur bashkë
 Brez pas brezi shekujve me radhë,
 Dhe në gurgullimën e pavdekshme
 Pleqtë ndiejnë gjyshërit mjekërbardhë.

Ndiejnë kuvendimet e të vjetërve,
 Që dikur i kishin pasur pranë,

Të vëllezërve dhe shokëve dhe etërve,
Të të dashurve që mbyllën sytë
Kush nën plumba, kush dhe nën jorganë,
Kush nën re të murrme e kush nën yjtë.

Eh, këta përrenj që natën shkasin
Me një zë të lashtë sa një erë,
A e ndien, vëlla, se ç'fjalë flasin,
A e ndien si pleqtë i turbullojnë,
Se do vijë çasti kur një herë
Zërat si përrenjtë me jehonë

Të vrapojnë drejt kujtesës sonë...

1983

Dimri

Dhe erdhi ai i pamposhturi i bardhë,
 Tundi një herë krifat dhe zbardhi gjithçka,
 Në pyje e në shpella i vuri qirinjtë në radhë,
 Qirinjtë e akujt si këllëfë shpatash të mëdha...

E dielli i pakët shikon në anë të horizontit,
 E miliarda drita të vogla dëbora nxjerr:
 Është flamuri i lavdisë së tij, i bukuri e i stolti,
 Që dimri në paradën madhore e merr.

I pamposhturi i bardhë tund me inat krifat
 E na bën të kujtohem për zjarrin që e kemi harruar,
 E për palltot e mëdha e për gunat siva¹⁾
 E për gjithçka që harresa e ka mbuluar.

Dhe tund krifat e bardha mbi tavolinën time
 Dhe më kujton një varg që kushedi pse përgjysmë e pata lënë,
 Dhe miliarda thërrime, të ndritura thërrime
 Shpërndan në tavolinë, në odë, në rrugë, në lëmë...

1) sivë - gri

Fund dimri

Dhe forcat atij i shterën, i shterën,
Si një poeti që vjen me bujë e në udhë shter talentin;
Dhe krifat i tund, po krifat dëborë nuk nxjerrin,
Dhe zemërohet, po zemërimin udhët ia tretin.

Një tjetër më i fortë se ai zë tund krifat e kaltra,
Tund krifat e kaltra e ia gris flamurin madhor,
Flamurin e dëborës me të cilin dimri mburrej netëve të gjata.
Një tjetër! Është pranvera, që erën pret me kraharor...

Dhe fshin me krifat e saj dëborën,
Dëborën e dobësuar, dëborën zhele-zhele,
Dhe ngre në male e fusha dorën,
Dhe miliona kërcej shpojnë dheun me turjelë...

Dhe dimri krifërënë largohet i mërzitur,
Si ai poeti që humb talentin e s'i shkruajnë më artikuj lavdërimi,
Në rrugë del një poet me forcë të përtëritur,
Del një poet! Pranvera shkruan miliona libra gjelbërimi...

Një çast i pagjumë

Çdo gjë ngarkohet-shkarkohet në jetë,
 Ngarkohet-shkarkohet toka e madhe,
 Mbushet qielli nga retë e shkarkohet nga retë,
 Mbushen pemët me fletë e shkarkohen në vjeshtë.

Ngarkohen me borë malet e lartë
 E bora shkrihet në verë,
 Ngarkohet ajri me tym e me vapë
 E vapa shkarkohet në dimër prapë.

Ngarkohen lumenjtë me ujë nga shirat,
 Lumenjtë zbrazen në motin e thatë,
 Ngarkohen arat me grurë e vijnë të shirat
 Dhe zbrazen e mbeten të lira.

E prapë ngarkohen të gjitha, të gjitha,
 Të gjitha ç'janë mbi tokë;
 Shkarkohen me gaz, me dhimbje e britma,
 Nga rrapi i madh e deri te hithra.

Ngarkohet njeriu me dhimbjen e rrallë,
 Nga dhimbja e rrallë shkarkohet,
 Por ndryshe çdo gjëje, mundohet, mundohet,
 Por ndryshe çdo gjëje shkarkohet ngadalë
 Dhe mbeten rrudhat e thella në ballë.

E heshtura

Dëbora kur bie s'dëgjohej me vesh,
Dëbora kur bie prej qiejve hesht,

Dëbora kur bie vështrohet me sy,
Të bardhën e heshtur e shohim të dy.

E vetmja që bie nga qielli hesht,
Të tjerat kur bien të shpojnë në vesh,

Prandaj është e bardhë, prandaj është e re,
Se zhurmë me pluhur nuk ngre...

Në mëngjes para lumit dhe pyllit

Me vete flas në njërin breg të lumit
Dhe pylli më dëgjon nga bregu tjetër
I sapozgjuar në mëngjes prej gjumit
Në shtratin me jorgan të madh të gjelbër.

Dhe zogjtë m'i dërgon si lajmëtarë
Me gjuhën e gërnetës, violinës...
Zbret lumi malit si dashnor i marrë
T'i puthë i etur buzët e luginës.

Dhe unë hesht si heshtja e thesarit:
O tokëzë, që ballin nuk ma ngrype,
Ma hap, të lutem, librin tënd të barit,
Të vetmin libër që lexoj pa syze!

1983

Pas shkrepëtimës

Korriku i ka pirë lumenjtë
Dhe lëngu i damarëve të pyllit është i pakët.
Xhezvja e kafes mund të valojë në shkëmbenjtë,
Që ngrihen mbi përrua të plakur.
Në çast një heshyje e trishtuar
Pushton kurorën e pishës e rrudhat e lumit.
Era frymën e pret nën qiellin e trazuar,
Vrapimin e ndalin retë ngjyrë plumbi.
“Diçka do ndodhë”, - pylli mendon.
Pastaj rrufeja krahët thyen diku larg,
Ku puthet dheu me qiellin në horizont,
Duke u përpjekur si katarakt...
Dhe mbushen rrudhat e tokës
Me lëngun që reja, e bija e saj, hodhi
Dhe pylli i urtë tund të gjelbrën kokë:
“Mirë që ndodhi kështu, mirë që ndodhi!”

Dëbora e pranverës

Dëbora në pranverë s'mban gjatë,
Se lëngjet e gjelbër ziejnë në pemë,
Ziejnë me ditë e me natë
Dhe s'heshtin e s'flenë.

Dëbora s'qëndron në pranverë,
Se ngrihen ushtritë e barit me ushta,
Se vijnë zogjtë me këngë e zhurmë e poterë
Dhe e përzënë nga fusha.

1983

Me furçë në dorë dhe akuarel

1.

Çitjanet mjegulla
I ngriti si shtriga
Dhe hidhet në shelgje
Dhe bredh ndër boriga...
Erdh vjeshta,
Erdh vjeshta e verdhë,
Lumenjtë e malit nga grykat u derdhë,
Dhe fletët e trishta i hodhi zabeli
Si fjalë idili,
Si fjalë gazeli.
Mërziten thëllëzat e njoma për djem,
Poeti figura të mira nuk gjen
Për vjeshtën - piktore,
Që rri në zabel
Me furçë në dorë dhe me akuarel.

2.

Kujt fletët e verdha ia shtojnë mërzinë?
Më flak,
Erë e vjeshtës, melankolinë!
Më hidh,
Erë e vjeshtës në pyjet pa fund,

Ku pisha e gjelbër kurorën lëkund,
Ku bredhi e lisi thërresin,
Zhurmojnë,
Sorkadhja dhe ujku ndër driza përgjojnë.

3.

Më hidh,
Erë e vjeshtës, në kopshtet me mollë
Të shoh si mbush shportat ajo shamihollë,
Të shoh si agimi mbi mollët përgjon,
Kur lëngu i ëmbël i frutit kullon...
Më hidh, erë e vjeshtës, diku në rivierë,
Që fryma e detit në faqe të më bjerë;
Të shkoj nëpër bahçe,
Të zbres që nga mali,
Të shoh si skuq ballin diku portokalli.

Nëntor 1959

Në fund të vjeshtës

Shiu me gjyma tokën e lau skaj më skaj,
Djersën ia hoqi nga gjoksi e sqetullat;
Rrjedh uji nga trupi i lagur i saj,
Rrjedh nga flokët e vetullat.
Dushi i madh gjëmon e zien anembanë.
Ç'bëhet kështu?
Pas punës toka e lodhur pastrohet,
Toka vjen erë uji si një grua pas banje;
Me çarçafë të bardhë në dorë dimri afrohet
Dhe qesh: "Ta mbuloj, mos më ftohet!"

1982

Bredh era qorre

Me bastun bredh era qorre,
Zbret në lumë e shkon në varre,
Pastaj hidhet ndër oborre
Dhe troket në çdo dritare.

Çmendet vjeshta si një bushtë,
Fletë e fruta hedh përnatë.
Diçka treti mollë e shkurtër,
Diçka humbi plep i gjatë.

Diçka humbëm ne të gjithë:
Çka s'lind nesër çka s'vjen prore;
Nëpër rrugët dhe avllitë
Me bastun bredh era qorre...

Udhëtim në mbretërinë e gjelbër

Baladë

Jam mbështjellë prej blerimit,
Valë e vakët më përkund,
Humb në mes të gjelbërimit,
Humb se erdha që të humb.

Po t'ju pyesin se ku mbeti,
Thoni: shkoi në kaltërsi
Dhe kërkoi strehim i shkreti
Në të gjelbrën mbretëri.

Pasaportën ia firmosën
Zogjtë mbledhur sqep më sqep
Dhe me lule ç'ia vulosën
Në çdo faqe dhe çdo cep.

Dhe kalon me pasaportë
Pa u trembur nga njeri,
Hyn e del portë më portë
Në të gjelbrën mbretëri.

Pa i vjen qyteti në ëndërr,
I vjen rruga me asfalt
Tek kalon në bar e mëndër
Në luginë e monopat.

Dhe kërkon t'i japin vizë
Zogjtë e kaltër fluturim,
Që t'i kthehet prapë shtëpisë
Nga i gjelbri udhëtim.

Po t'ju pyesin: kur do vijë,
Ju t'u thoni: shumë shpejt,
Se ka punë e s'mund të rrijë
Ditë e natë nëpër gjithë...

Dhe kalon me pasaportë
Nëpër pisha dhe lajthi,
Del i bukur në çdo portë
Nga e gjelbra mbretëri.

1984

Kapriçio

Këndon një zog

*Këndon një zog në gjeth të shtogut,
Po një njeri e ndjek ta vrasë,
Se rrugës gjyshi i lig i zogut
E paska fyer me një glasë.*

*Magjepset bota nga kjo këngë,
I thotë zogut: "Paç uratën!"
Veç një njeri s'harron një brengë
Dhe mban në shpirt mëri të gjatë.*

*Ai nën shtog qëndron i strukur
Dhe ha mërzitur thonjtë e trashë:
"Vërtet këndon bilbili bukur
Po gjyshi i tij ka bërë glasë!"*

1986

Çdo gjë gumëzhin

Dhe peshku në det e zë diellin,
Në gojë e gëlltit si kajsi,
Madje edhe retë me qiellin
I shtyn me lopatkat e tij.

Dhe bari në fushë e ha lopën
Kur lopa sëmuret e vdes,
Me mure të gjelbër bën gropën
Dhe tundet i tëri dhe qesh.

Dhe peshku, dhe fletët, dhe bari
Një ditë fundosen në shkrumb:
Me gjuhën e flaktë vjen zjarri
Dhe duket sikur ka një fund...

Çdo gjë gumëzhin e përpiqet,
Mbulohet e del përsëri;
E djeshmja e bleruar zë digjet
Në buzët e zjarrit të ri.

Të gjitha këto i shoh kthjellët
Dhe qartë sa s'bëhet i shoh,
Jam plak që më joshën rebelët,
Çdo gjë dhe më ftoh dhe më ngroh...

Vjen nata

*Nata shkon shaluar
Mbi kurriz të maleve...*

Fatos Arapi

Vjen nata mbi kurrizin e një zhabe
Dhe mbi brirët e një ylli;
Vjen nata mbi krahët e një zhgabe
Të arratisur nga pylli;

Vjen nata mbi cipën e një kokrrë rrushi
Dhe mbi parzmoren e një insekti;
Vjen nata mbi hirin e një prushi
Që mbrëmë nga vdekja e një peme mbeti.

Gjyshërit qiellorë

Ra shi e vendi gjëmoi anembanë,
Pastaj në qiell u grisën retë,
Të dukej sikur gjyshërit tanë
Vraponin me kuaj e ngisnin qetë.

Të shfaqur mes reve papritur
Kthyer në qenie qiellore
Me mjekra e flokë të ngritur,
Me shpata, hostenë e plore...

1990

Mikroborgjezi

Ç'të vrasim mendjen?

Rimë në kuzhinë;

Bie erë gjellë, pa ngrënë s'mbesim;

Na pihet ujë,

pimë;

Na rriten thonjtë,

i presim!

Shkopinjtë

Tërë natën bënte shkopinj Aliu
Dhe betohej ta rrihte Masarin;
Në mëngjes i thyente shkopinjtë i ziu
Dhe ndizte menduar zjarrin...

1986

Kur të mërzhitet hëna

Ti krejt i humbur vjen pasdarke
Dhe duarkryq hesht në ballkon,
Larg teje hëna halabake
Si grua nudo udhëton.

Dhe thua: “kurvë s’gjen në botë
Të sillet lakuriq si kjo,
Të sillet nudo në të ftohtë
Dhe vapës nudo domosdo”!

Ndërkaq ajo lëviz një rreze
Andej nga reja si ballkon,
Ta zgjat fytyrën majoneze
Dhe trupin nudo e mbulon.

Korrik, 1995

Peizash resh

Retë si lopët tej në livadh,
Të mjela po ikin qiejve,
Qumështi i tyre zbardh,
Flluska-flluska përrenjve.

Retë si lopët po ikin në varg,
Po viçat e tyre ku janë?
U fshehën në pllajat e qiejve larg,
Dhe ndofta s'i pamë...

Në luftë

Unë s'jam nga ata që ikin nga lufta,
Kur marrin në trup një gërvishje,
As nga ata që heshtin të futur në tuta,
Kur i pështyjnë me tallje e skërmitje.

Unë jam gjithmonë mes luftës mizore
Dhe them: sikur dhe luftë mos ketë,
Për dhimbjen e madhe njerëzore
Do ndizja luftën me retë.

1994

Dita

Në fillim e imët, si degë panje e lagur,
Vjen dita e brishtë, e mekët, e zbehtë,
Vështron në dritare, kalon e drojtur pragun,
E dobët, e mitur, e lehtë.

Dhe ti mendon: a mund të përkëmbet,
A mund të rritet një gjë kaq e gjorë?
Ndërsa ti mendon, mugëtira rreth teje shembet
Dhe dita e merr pushtetin në dorë.

1987

Shi monoton

Një shi monoton
Me pellgje të mekur
Harruar e lënë...
Këtu nën ballkon
Një dallëndyshe e vdekur
Që mbrëmë.

Udhëtar i heshtur,
Ku shkon
Nën qiellin e rrjepur
Me shi monoton?

Shtator, 1995

Në gjumë

Zbret nata nga qielli me pendë si galë,
Dhe unë shtrihem e fle në mishin e trupit tim,
Shpirti im më rrjedh në çarçaf me ngadalë,
Më rrjedh me rrëmbim.

Zbret nata dhe rrjedh shpirti i vakët,
Dhe mishin ma merr në çarçaf,
E shpie në dete të largët,
Çarçafi si vela fryhet e zbardh.

Të qarat

Sa herë kaloj nga kjo rrugë
Dëgjoj të qara e më dhemb në kraharor,
Të qara me dënesë e kujë,
Përzier me gurgullimën e çezmës në oborr.

Po kush ka vdekur që qajnë aq shumë
Dhe ç'mund të bëj për ta nuk e di!
A mbase do jetë më mirë të hyj edhe unë
Të qaj mes tyre atje në shtëpi?

Pa kuptim

Në det dhe në shpirt bie nata,
Dhe trupi lundron nën jorgan,
Arapit me këmbë të gjata,
Ngre kokën lart në tavan.

E mban tavanin e çarë,
Mos bjerë mbi shtratin tim...
Ah, ëndërr e natës së marrë
Fanitur krejt pa kuptim!...

1992

Patat e egra

Mbi malet me dëborë
Me mjegull e tufan
Po fluturojnë patat
Me vargun naimjan.

Patoku shkon përpara
I matur si strateg,
Mes reve gjen një grykë,
Mes majash gjen një shteg.

Dhe tufa si gërshtë
E ndjek dhe i vjen pas
Me bindje dhe me shpresë
Drejt detit me tallaz.

E mbushen retë e shpatet
Me britmat: ga-ga-ga!
E rruga zgjatet-zgjatet,
E rruga fund nuk ka!

Nën krahët e palodhur
Kjo tokë e madhe vlon,
Çeliku del nga furrat,
Në digat rrjedh beton.

Zhurmon materniteti,
Bërtet njeriu që vjen;
Në magje zihet brumi,
Një karkalec kërcen...

O viset prindërore,
O malet në karvan,
Me ç'hir lundrojnë patat
Me vargun nainjan!

Pas tyre vjen pranvera
Dhe sythi del në lis,
Kërçelli shpon ugarin
Dhe kokën nxjerr mbi plis.

Dhe malli i poetit
Troket në kraharor,
Nga malet vijnë patat
Me vargun popullor.

1976

Tinëz të tjerëve

Pres të vijë një nuse...

*Pres të vijë një nuse me taka të larta,
Me fustan të gjatë deri në tokë,
Me dy-tri unaza të arta,
Me kurorë të argjendtë në kokë;*

*Pres të vijë pa krushq e pa krushka,
Pa dasmorë e pa dhëndër;
Pa kalorës në kuaj e pa mushka,
Pres të vijë e bardhë si ëndërr;*

*Pres të vijë e të thotë duke hyrë në derë,
Duke ngritur pakëz fustanin e gjatë:
“Erdha, dasmën e lashë me dhëndrin e mjerë,
Me nënën e shkretë e tim atë;*

*Erdha ta përcjellim bashkë mbrëmjen e trishtë
Pranë tryezës me vjersha e jo në shtratin e natës së parë...
Të pëlqejnë unazat gishtërinjve të brishtë,
Të pëlqejnë takat e larta e fustani i bardhë?”*

*Pres të vijë një nuse me kurorë në kokë,
Të vijë mes rrugëve të mendjes sime të lodhur,
T'i bjerë bishti i fustanit në tokë,
T'i hedhë unazat mbi librin tim të zhubrosur...*

Pres të vijë një nuse nga një udhë e pasosur...

Kujdes me fjalën!...

Kujdes me fjalën, zonjës me çantë,
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!
Pushteti i fjalës është i veçantë,
Gatuan male dhe kakërdhi.

Me fjalën rrjedhin përrenj me mjaltë,
Pikojnë çezma me helm të zi.
Kujdes me fjalën, zonjës me çantë,
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!

Nga fjala humbën Judë e Pilatë,
Strategë e mbretër me mbretëri.
Kujdes me fjalën, zonjës me çantë,
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!

Kur fjala nxirret nga buzët jashtë,
Si dallëndyshja s'vjen në shtëpi.
Kujdes me fjalën, zonjës me çantë,
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!

Unë fjalën vetë e shtroj në kartë
Dhe brenda syve se ç'është e di...
Kujdes me fjalën, zonjës me çantë,
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!

Rekuiem

Doli arkivoli i Fjalës së vdekur
Nga dera e tempullit të poezisë.
U nis në Varrezat e fjalëve i heshtur
Kortezhi i veshur me rrobat e zisë.

E mjera Fjalë!... Jetën të shkurtër e pati!
Ah, Fjala njeriut të shkretë i shëmbëllen,
Lindet plaket e vdes siç shkruhet nga fati
AMEN!...

Hap derën edhe hyj

Ndrisin portat e atij pallati
 Dhe në xhamet vizatohen retë.
 Ç'dreq këtej më hodhi mua fati
 Të krekosem rëndë me poetë!

Unë rri në prag me librin tim.
 Dera hapet, mbyllet e troket...
 Por të hyj atje nuk kam guxim,
 Jam fshatar i Jugut, s'jam poet.

Vargjet nëpër fusha i kam shkruar,
 Rrëzë hije rrapesh apo shelgjesh,
 Shokëve të mi ua kam lexuar,
 Nën këmborë e blegërima delesh.

Këngët nëpër ara i kam ngritur,
 Rrëzë kodrash mbushur me dëllinja;
 Kur nuk kisha letër, i mërzitur,
 Përmbi luspa plepi shkarravisnja.

Vjersha ime erë ugari bije,
 Vargu im bije erë luleshqerrë.
 O guximi fshatarak, ku je,
 Pse s'më shtyn të futem menjëherë?

Unë që kam pasur aq guxim,
Unë që jam rrahur nëpër ara
Me armikun dhe rivalin tim,
Pse tani ngurroj të dal përpara?

...Me librushkin sqetullit shtrënguar
Këmbët tërë baltë ugari shtyj
Afër pragut shumë i shqetësuar...
Zë trokas... Hap derën edhe hyj!

Ja pallati i madh me xhame shumë.
Hyjnë, dalin një nga një poetët.
Nga luginat erdha edhe unë
Të tregoj për arat dhe për vreshtat.

1956

Poeti dhe shpirtrat

Poeti zgjon shpirtrat e fjetur,
Dhe shpirtrat ngrihen në këmbë.
Pastaj turbulluar e nxehur,
Poetin e shqyejnë me dhëmbë...

1993

Salut!

Petro Markos

Salut atyre që s'u plakën
Dhe s'u shteron krijimi kurrë,
Që malet pash më pash i matën
Dhe lanë djersë e gjak në gurë.

Me shpirt të madh ngaherë mbetën,
S'ua ndryshku mendjen dot skleroza
Dhe s'psherëtinë e s'nëmën veten
Me këmbët futur në pantofla...

Salut atyre që s'u plakën,
Po ndoqën hap më hap rininë
Dhe smirë talenteve s'u patën,
Se s'njohën kurrë pleqërinë!

1966

Naim Frashëri

Vargjet e tua me thërrimet e dheut janë përzierë
 Dhe na duket sikur me qenien tonë janë shkrirë,
 Se i kemi thithur mes qumështit, frutave, erës
 Dhe në burime me ujin i kemi pirë.

Çdo rrokje e varg e poemë është rritur
 Tok me lisat e gjatë e me barin në gurë
 Dhe në kurorat e pishave është ngjitur
 Dhe, si në pisha, s'humb blerimi kurrë.

Ti, si bujk i mirë, lërove arën e fjalëve,
 Arën e fjalëve të stërgjyshërve mbetur djerrë,
 Mbuluar nga barëra të liga maleve;
 E lërove që djerrë mos mbetej asnjëherë...

Ish punë e vështirë plugimi i asaj are.
 Fjalë të tjera frymën ia merrnin fjalës stërgjyshore,
 Po ti gjoksin ia vure përpara
 Dhe rrënjët gremit të hidhur ia nxore.

Dhe tek lëroje këtë arë në vapë e në shqotë,
 Gabove kur the se perëndia na qenka kudo: në lulet e lisat,
 Pse s'the që vargjet e tua do të ishin kudo: në tokën e ngrohtë
 Në lulet, në barin, në plisat...

Vargjet e tua me thërrimet e dheut janë përzierë
Dhe na duket sikur me qenien tonë janë shkrirë.
Rrugën marrim në male e në buzë i mbajmë ngaherë:
“O malet e Shqipërisë!...”

Frashër, 1969

Çast poetik në zyrë

Ku je poezi, e dashura ime e parë?
 Eja më hiq nga raporte e shkresa!
 E harrova erën e barit të tharë,
 E harrova fletën mbuluar nga vesa,
 E harrova kërcimin e kecit me brirë,
 E harrova përtypjen e gojës së kalit,
 E harrova lulëkuqen mes grurit mbirë,
 E harrova ketrin në pishat e malit,
 E harrova dashin në hellin e gjatë mes prushit,
 E harrova kosin e trashë të stanit,
 E harrova ajkën e verdhë të qumështit,
 E harrova qenin e madh të çobanit,
 E harrova mundjen e demave pas lumit,
 E harrova këngën e vajzës së brishtë,
 E harrova pluhurin e ngritur mes kumit,
 E harrova lejlekun sqepmadh në zallishtë...
 Eja më merr, se puna ime iku e vajti!
 Eja, se dua t'i sjell në mend sërishmi të gjitha!
 Unë të flas, i dashuri yt, malukati,
 Që humbi në shkurret e shkresave si zogu në driza,
 Unë të flas, përndryshe të nisa një shkresë,
 Një shkresë që bashkë me erën zë rend:
 "Të premtën pasdite në orën pesë
 Të ndodhesh në zyrë urgjent...".

I rebeluar

Veten time s'e kam dashur kurrë,
Të veçuar skutave mënjanë,
Si një kukuvajkë përnibi gurë,
Si një kabanore pa kabanë.

Ndaj në kabanore kam kumbuar,
Nxitës i hareve dhe hatave,
Dhe me zhurmën time kam shurdhuar
Veshët delikatë të disave.

S'ke ç'i bën, të tilla punët janë:
Një shurdhohet dhe një tjetër zgjohet!
Jam një kabanore me kabanë,
Ndryshe jeta ime nuk jetohet...

Nëntor, 1994

Kasollja e poezisë

Kasolle e mbuluar me kashtë prej thekri,
 Me truall dheu, me frona dërrase,
 Tymtar i tymosur, çengel i zi hekuri,
 Ku varet kusia me groshë e patate;

Në qoshe një poçe, një kupë e një shtamë,
 Në mur një kamare me xhezve të vjetër
 Me tre filxhanë:
 Dy për miq e për vete një tjetër;

Çati e kasolles mardhur nga dimri i gjatë,
 Shkrirë tej e tej nga pranvera,
 Zhubrosur nga vera e thatë
 Fërkuar nga era;

Pësh-pëshje shpirtrash natën në trarët,
 Frymë brezash palosur nga vdekja palë mbi palë,
 Thirrje të gjallësh nga larg në dritaret,
 Çukitje rabeckash, zukatje insektesh në vrimë e mazgallë.

E gjitha për mua harbon poezinë
 Këtu në kasolle, ku shkrihem në prehje,
 Tek shoh nëpër mjegull njerinë e lirinë
 Dhe zgjas me hamendje duart përhumbur në dehje...

Pak minuta dëshpërimi

Në kurriz jam shtrirë e shoh në hënë,
Anës hënës yjet një nga një.
Duket se të gjitha i kam thënë
Dhe të them të tjera s'kam asgjë.

Duket se u lodh dhe mendja ime
Si Metalurgjiku në Elbasan
Mbetur shkretë e mplakur pa prodhime
Me oxhak të vjetër si shandan.

Në kurriz jam shtrirë e shoh në hënë,
Anës hënës yjet një nga një
Dhe një lot në faqe më ka rënë,
Duke zbritur buzëve pa zë...

1995

Vatrat

Po treten zjarret në trupin tim,
Në vatrat e gjunjëve, veshëve, syve, hundës,
Ndaj shpesh kam të ftohtë e thellim,
Si kukuvajka në dimrin e tundrës.

Veç rrallë e tek më ngroh papritur një zjarr,
Nga vatra shënjtore e poezisë.
Dhe them me vete si murg vetmitar:
Qoftë e bekuar kjo vatër që ende nxjerr një shkëndizë!

1994

E ftohtë, e hiçtë

Zjarri i alkoolit blu i valë,
Trutë e mi po i djeg përditë,
Guva e kokës sime ngadalë,
Mbetet e zbrazur, e ftohtë, e hiçtë.

Asnjë shkëndijë kjo guvë s'do nxjerrë,
Drutë e saj i bën hi alkooli...
Ah, guvë e kokës sime të mjerë,
Dikur këtu ulkonjë e poezisë polli!...

1993

Bukuria

Kalojmë pranë bukurisë shpesh,
Kalojmë heshtur thjesht si udhëtarë
Dhe s'vëmë re si nis e buzëqesh,
Si pjeshka kur zë pitjet në një arë.

Dhe vjen një çast kur shtangim para saj:
Ajo qëndron si pjeshkë e arrirë,
Ajo qëndron... dhe themi ne pastaj:
S'të vumë re, mes nesh ti paske mbirë!

Kërkimi

Që nga Naimi gjer në ditët tona
S'u lodhën poetët së kërkuari malet;
Kërkuan nga Vjosa e Valbona,
Kërkuan, si gjeologët mineralet.

Thesaret që zbuluan i shpërndanë:
“Janë tuajat, njerëz. Maleve i gjetëm!”
S'u grindën e për vete s'i ndanë,
Se kanë zemër të madhe poetët.

E kështu do jetë: të tjerë, që do vijnë një ditë,
Do gjejnë në male thesare më të mira,
Se malet kanë perla për të gjithë,
Sado të jenë kërkimet të vështira...

E do kalojnë vite me diell e me shi në jetë,
Do pikojnë strehët e do rrahin valët në lumë,
E vetë njerëzit do gjykojnë shtruar e qetë
Se kush kërkoi e kush nxori perla më shumë...

Kallinjtë

Lumi gjuhën zgjat i lodhur dhe lëpin në heshtje brigjet,
Hënë e madhe sa një rrotë re më re po rrokulliset.

Erë e grurit më ka dehur, si sarhosh ec nëpër grurë
Dhe një varg që kam në buzë s'do ta hedh në letër kurrë.

Do ta flak përmbi kallinjtë, le të piqet dalngadalë,
Le ta shijnë në lëmenjtë me kombajnë apo me kalë.

Dhe në mbettë nëpër kokrrat, le të futet në hambarë,
Nëse s'mbetet, erë e lumit tok me bykun le ta marrë.

Nëpër grurë e anës lumit kam menduar një varg tjetër,
Kur të piqet si kallinjtë, do ta marr ta hedh në letër.

Dhe në letër, sipër vargut gruri kokrrat le t'i derdhë,
Me flori le t'i spërkatë lart nga qielli hënë e verdhë.

Leonardo da Vinçi

Kardinalët kërkuan fytyrat e Madonës e të Krishtit
Në pikturat e mureve, në letër, në pëlhurë,
Ku kish vrapuar peneli i Da Vinçit,
Kërkuan po s'i gjetën kurrë!

Da Vinçi s'mund të lodhte dorën në kufoma,
O kardinalë të marrë!
Ata që ju dukën juve si Krishtër e Madona
Ishin hamej, fshatarka e fshatarë...

Firdusi

*...Vetëm njëri heshtur pinte kafë,
Dhe pastaj u ugrit e fjalët mati:
- Ju bekoftë zoti, pse kaq llafë?...*

D. Kedrin

*Dhe tha Anzarin: "O, ka shumë vjet,
Që vuan e heq Firdusi-poet.
U kthye në Tusë dhe rri në shtëpi,
ushqehet nga kopshti i vogël i tij."*

II. Hajne

Pinin bejtexhinjtë në çajhane,
Vera u pikonte nga mustaqet;
Nëpër gojë ç'e merrnin dynjanë;
Bridhte fjala nga qoshet e caqet.

Flisnin pleqtë, vinin bast të rinjtë,
Mençuri e gjithë Horasanit:

- Për allah,

filan nga bejtexhinjtë

Ka medalje të artë prej sulltanit!

- Për allah,

pashai dërgoi e mori,

Bejtet në saraje t'ia këndojë,

E lëvdoi veziri nga oborri:

"Aferim!

Për ty kemi nevojë!”

Ziente çajhaneja plot me njerëz,
Mburrnin njëri-tjetrin,
mburrnin bejtet,
Dilte nga dritaret era e verës,
Era që me mjegull vishte dertet.

Vetëm njëri heshte në një qoshe,
Me peshqir të vjetër kokën lidhur,
Nëpër dhëmbë gjysmë vargu thoshte,
Pinte veresie çaj të hidhur.
- Çështë ai? - tha një nga bejtexhinjtë.
- Një matuf! Abul-Kasim i Tusës!
Vetëtinë unazat në gishtërinjtë;
Rrodhi vera cepave të buzës.

Si ta dinin vallë në çajhane,
Ku pari e vendit kuvendonte,
Se ky plak i kërrusur me nallane
Fund për “Shah-Namenë” po mendonte?!
Bejtexhinjtë qeshnin,
bënin zhurmë,
Hanin shishqebap me gaz e shije,
Plakun vargu e mundonte shumë,
Plaku pinte çajin veresie.

Dhjetë shekuj që atëherë vanë!
Humbën bejtexhinjtë e çajhaneja;
Kockat nëpër rrëzë u shpërndanë,
Udhëton në botë "Shah-Nameja".

1964

Dua t'ju bind

Dua t'ju bind se ende kam mbetur i gjallë
Në fushën e luftës së madhe të poezisë;
E di, kapotën kam grisur e jam mbushur me plagë,
E jam ngritur sërishmi mes dhimbjes së njerëzisë,
E sërishmi batalionet e vargjeve kam thirrur;
Batalionet e mi të mbetur përgjysmë në luftëra
I kam mëkëmbur, përtërirë e stërvitur
Me taktika të reja e mësimë të urta.
Ndërkaq kam fituar mjaft kohë e mjaft dhelpëri
Dhe kam pritur çastin solemn mes dëshirës së valë,
Që batalionet t'i hedh në beteja si dikur në rini
Dhe t'ju bind se vërtet kam mbetur i gjallë.

1983

Dridhem nga bishti i penës

E shoh se po plakem,
Dora në tryezë më dridhet mbi letër
Dhe vargjet po vaken
Si uji në tenxheren e vjetër.

Unë që vargje shkruaja edhe në trungun e pemës.
Unë që gurin me grusht e coptoja si lakër,
Të dridhem nga bishti i penës
Si plaku me mashën në vatër?

1991

Mbrëmë

Unë mbrëmë s'ia dola dot natës,
Më mposhti dhe rashë të flija i mekur
Dhe vrava një poezi me majën e shpatës
Së gjumit të vdekur!

Ajo poezi besoj mund të lindte
Dhe ndofta do të ishte më e mira,
Sikur e nëmura natë pak të më linte,
Mos më përpinte aq shpejt errësira...

1993

Poeti plak

Dhe shkruaj i heshtur vjersha pak e nga pak
 Fshehur prej gruas e tinëz të tjerëve,
 Se fshehur flasin: “Iku nga mendtë ky plak”!

I ulur diku në një qoshe fletorkën e mbaj
 Mes gjunjëve kockë e lëkurë e tinëz të tjerëve,
 Tek pi si Firdusi të hidhurin çaj.

Dhe kur më zhurmon së largu një çap,
 Atje ku tulitem tinëz të tjerëve,
 E fsheh fletorkën dhe veshët i hap.

Ç’t’i bësh! S’më rrihet pa shkrepur një varg
 Larguar prej gruas e tinëz të tjerëve,
 Kur të lajthiturit çirren: “Mbyll gojën, ti plak”!

Ah, dua t’i them ato që s’i thashë dikur,
 Ndaj kohën e shtyj mes vargjeve tinëz, të tjerëve
 Diku në një qoshe veçuar si gur.

Rri shkruaj veçuar jo se i trembem njeriu,
 Po s’dua t’u hapet goja për mua të tjerëve
 Dhe s’dua të grijnë: “Lajthiti i ziu”!

E di se jetoj me të çmendur në gaz e në vaj,
Ndaj shkruaj fshehur prej gruas e tinëz të tjerëve
Dhe pi si Firdusi të hidhurin çaj...

Janar, 1995

Poeti dhe vdekja

Veç me vdekjen s'jam takuar kurrë,
Ndaj e pres nderuar në shtëpi,
Për respekt - një qengj manar në furrë,
Për humor - një shishe me raki.

Do ta ftoj në sofër tok të pijmë:
Vdekja mbretëreshë e unë mbret!
Dehur bashkë natën do ta gdhijmë,
Dehur do të dalim në qytet.

Xurxull vdekja do këndojë: “u prisha,
Moralisht u prisha!... Ah, ç'mëkat!
Do çuditet president Berisha,
Paska dehur vdekjen ky lugat”!...

1994

Në fund të jetës

Në fund të jetës gruan pyet poeti,
Mos ndofta kishte shkruar kot së koti.
Ajo lëshon një psherëtimë: “I shkreti!”
Pastaj nga faqet zbresin pika loti...

Kënga para vdekjes

Unë po vdes dhe toka mbledh shi.
Dikur ëndërroja të isha i madh.
Ah, gjepura! Sikur ta nisja rrugën tani,
Do shëmbja çdo mur e çdo gardh.
I mekur mes jush me veten po flas,
Vdekja përtypet dhe ha ananas...

Ta nisja rrugën tani kur po vdes,
Tani kur mbi veten vështroj një qiri
Tek falet, tek zbehet e feks,
Mes jush do kishit vërtet një gjeni.
I mekur marr frymë, qiriri vjen pas,
Vdekja mblaçitet dhe ha ananas!...

1993

Exegi monumentum

Ju thoni si të doni, po në prill a në maj
Bariu do gdhendë fytyrën time në kërrabë
Dhe baresha në shtambën e saj
A në medaljen që var për festë në qafë.

Dhe ndofta poçari me bluzë e me duar pis
Me baltë të pjekur do ngrerë statujën time të thjeshtë
Dhe duke e vënë atje mbi një gur a një plis
Do thotë: “Ky burrë këtu le të jetë”!...

Ju thoni si të doni, do ndodhë kjo sigurisht,
Kjo mundet të ndodhë në fshatin tim nën Moravë,
Po mbase diku dhe në Kuç, në Bënçë a Vranisht,
Kryesorja është se fytyra ime do gdhendet në kërrabë...

1995



Rënkimi i pulëbardhës

Korija

- Baladë -

*Koka në jastëkun e përgjumur;
Mendja në korijen e përhumbur.*

*Lisat e korijes janë prerë,
Shkon andej së koti mendja e mjerë.*

*Në korije vetëm katër lisa
Ngrihen sipër mjekrave me driza,*

*Ku barinjte varin katër torba,
Ku me sqep krra-krrasin katër korba.*

*Katër korba krah për krah krra-krrasin
Dhe me sqep jastëkun tim çukasin.*

*Mos më joshin larg në katër lisat,
Ku lëvizin katër mjekrat drizat?*

*Mos krra-krrasin: “erdhi pleqëria,
Të mbaroi dhe ty, o mik, korija”!?*

*Koka në jastëkun e përgjumur;
Mendja në korijen e përhumbur;*

*Ku mbi katër lisat - katër torba,
Njëra-tjetrën ngasin katër korba:*

*- "Presim të na vijë e ta gostisim,
Torbë e tij e ka të zgjedhur lirin"!...*

1996

Pylli i rralluar

Ah, pylli i rralluar më fut ngaherë trishtim:
Këtu e atje tek-tuk ca drurë të vjetër,
Një bar si thikë e gjelbër në truall mbin,
Një bar si thekër i egër.

Dhe them me vete: ç'u bënë drurët e lashtë,
Kish hije pylli me shtatin e tyre të rëndë,
Siç kanë hije pleqtë e urtë me flokët si kashtë
Në rrugë, në shesh, në kuvendë...

Ah, pylli i rralluar ç'më hedh në mendime,
Pylli i rralluar atje përmbi arë!
U rralluan pleqtë e hershëm të shtëpisë sime,
Ikën gjyshja, gjyshi, babai, vjehri, xhaxhai e
kushërinjtë e tyre të parë!

Ikne! Ka gjëra që s'rrinë pa ikur!
I do me zemër e shpirt, po s'qëndrojnë!
Në këmbë të pyllit jam duke pritur
Dhe fjetet e barit shikoj si vrapojnë...

Nisja pa fat

Do shkoj në Parajsë me një autobus
Pa fat si gjithmonë,
Koha do të jetë e errët si pus,
Në kthesën e rrugës do shpohet një gomë.

Do pres mes pyllit me dushk;
Kjo sigurisht do më vonojë aq shumë
Sa portën e Parajsës s'do ma hapë askush:
Shën Pjetri do ketë rënë në gjumë...

Dhjetor, 1995

Me ndershmëri

Dhe kur njeriu nuk ndien as mall, as brengë, as dhimbje,
Nuk ndien as gaz, as hidhërim, as shpresë,
Një gjë ju them me ndershmëri dhe bindje:
Lëreni të vdesë...

1986

Mëzi i vogël

Hëna si e verdha e vezës
 Çau guaskën e malit dhe doli,
 I shkanë këmbët e lodhura pelës
 Dhe ra në hendek dhe gjaku i rrodhi.

Karroca e përmbysur s'bënte më zhurmë
 Dhe dridhej pela ende e mbrerë,
 Mëzi i vogël shikonte gjakun me shkumë,
 Gjakun që dilte nga goja e nënës së mjerë.

I zoti ia hoqi pelës palldëmë e litarë
 Dhe mëzin e mori për jele me vete,
 Mëzi kthente kokën nga nëna e vrarë,
 Mëzi thundrat përplaste dhe dridhej në ethe.

Pastaj në shtëpi ai heshti me kokë nga hëna,
 Vetëm kur porta u hap e rënduar,
 U nis përsëri me trok nëpër natë nga nëna
 Dhe ishte vrapimi i parë në jetë krejt i vetmuar.

U fut në hendek dhe pelën në ballë lëpiu
 Dhe ndjeu ftohtësinë e tmerrshme në gjuhë,
 Ngriti kokën lart e në qiell hingëlliu,
 Hingëlliu fillikat nën hënë i përhumur.

Kjo ndodhi një natë kur të verdhët e hënës pikonte,
Mëzi këtë e mbajti në mendje aq gjatë
Dhe kur hënën në cepin e qiellit vështronte
Hingëllinte përnatë...

1983

Tani më duhet të mësoj

Erdh koha të mësoj diçka tjetër.
Mësova të pi sisë e të ngrihem në këmbë,
Mësova të bëhem i ri dhe i vjetër,
Mësova të plakem, të heq e të vë dhëmbë;

Tani më duhet të mësoj edhe shkopin mirë
Për t'u mbështetur kur të dal në mëngjes,
Pastaj më pret një mësim pak më i vështirë,
Të mësoj dhe të vdes...

1991

Vdekja

Për qeniet e gjalla është krejt e zakonshme vdekja.
 Askush s'ka dyshim dhe të gjithë e dinë,
 Po ç'është e keqja,
 Vdekja fle në një shtrat me njerinë.

Vdekja s'vjen te njeriu, me njerinë është bashkë,
 Në një jastëk me njerinë çdo natë e ka kokën,
 Zgjohet me të, hanë tok në një pjatë e tok dalin jashtë,
 Pastaj një ditë, të madhin njeri, e shtrin dhe mbi trup ia hedh tokën.

Për qeniet e gjalla është krejt e zakonshme vdekja,
 E zakonshme si ajri që thithim, si buka që hamë,
 Po ç'është e keqja,
 Ne vdesim, ndërsa vazhdon të blerojë po ajo mollë e po ajo hanë,

Vazhdon të buçasë grykave lumi, të gjëmojë brigjeve deti,
 Të ndërrojnë ngjyrat fushat, malet, qiejtë dhe retë,
 Dhe ti, fatziu dhe i shkreti,
 Harrohesh nën tokë, fqinj me trupa skeletë.

Atëherë të hip një zili që për së gjallit:
 Të vdesësh ti dhe frymë të marrë një pyll me shekuj të tërë,
 T'ia thotë bilbili në mbrëmje diku poshtë zallit
 Dhe ti mos jesh kur të lërë hardhucka gjurmë si kryqe në rërë?...

Ah, vdekja! Ç't'i bësh! E heshtur siç hesht errësira!

Sikur mos heshtnim, ta dinim se ç'bëhej edhe pas vdekjes sonë

Nga varri me britma do ngriheshin kockat tona nga toka të grira,

Do ngriheshin veç nga zilia që ende të tjerët jetojnë!

Këtë zili kush bëhet trim për ta mposhtur, ka mposhtur dhe vdekjen,
Po kjo është e rrallë...

Plakush, më mirë këtë kuvendim mos ta ndjekim,

Të pimë një gotë e t'i falemi gotës që jemi të gjallë...

U zvogëlua dhe u tret

U zvogëlua nëna dhe u tret e gjitha,
U bë si pulëbardhë e lehtë
Dhe një mëngjes pa zbardhur ende drita
Rënkoi e fluturoi mbi retë.

Andej u fshih si ylli Afërdita
Dhe ne pastaj s'ë pamë, pastë ndjesë!
Veç ndodh që valë e ëndrrave të trishta
E sjell në breg të shtratit tim si shpezë.

Rreth teje të heshtur

Lërove e lërove e pastaj erdhi një ditë e vdiqe.
Kokrrat e dheut të arave që i solle me këpucë
Mbetën nën gurët e oborrit dhe në tirqe
Dhe takat e humbura të rripave të tu u ndryshkën diku në gëmushë.

Po gruri dhe vreshtat që mbolle blerojnë
E zogjtë që të përcollën në ara hidhen pjergull më pjergull.
Janë mbledhur fshatarët rreth teje e të heshtur lotojnë
E gratë shamitë e zeza ulin nën vetull.
Për çka atje lart kuvendon thëllëza?
Për çka lopët e demat burçojnë?
Botohet nekrologjia jote në librin e grurit në rrëza
Dhe zogjtë me majën e sqepit firmosin e larg fluturojnë...

1972

Piramidat

Brigjeve të Nilit, e djersirë,
Puna brodhi e ngriti piramidë,
Mbajti gurët nëpër shkretëtirë
Dhe me gurë i bëri vdekjes sfidë.
S'mbajmë mend ne emra faraonësh,
Emrat vdiqën mbyllur nëpër gurë,
Emrat vdiqën nën rërën e kohës,
Piramidat s'vdiqën kurrë,
S'vdiqën se i bënë vdekjes sfidë...

1992

12

Shpirti i gjyshërve

Rapsodi

Selim Hasanit, këngëtarit të Labërisë

*Ku shkund gurët qafë e shpatit,
Mardhur bore, djegur vafe,
Mbushe, xha Selim i Bratit,
Dy hejbe me këngë labe.*

*Erë plumb e erë predhë,
Erë prush e erë brengë,
Erë dushk e luleshqerrë
Binin-binin ato këngë.*

*Se hejbetë në sëndukë
Për t'u mykur nuk i vure,
Po i more çukë më çukë,
Selim Brati me poture.*

*Dhe mbi malet e përpyetë,
Mardhur bore, djegur vafe,
Prapë i zbraze ti hejbetë
Mbushur plot me këngë labe.*

*I përcolle, larg i nise,
Nëpër gjurmë gjelbërimi:
"Shkoni, bija, merrni viset,
Ju bekoftë xha Selimi!"*

Kënga

*Duda ish prej Elbasani...
Duda ish e shkoi e vate,
Varri iu mbush manushaqe.*

Popullore

Po cila do ishe ti me këtë emër,
Që erdhe mes viteve në këngë?
Me siguri dikush me mall në zemër
Këndoi për ty e derdhi gaz e brengë.

Ka qenë ndofta një qejfli i marrë,
A ndofta udhëtar karvani;
Te rrapi i Bezistanit të kish parë
Dudi prej Elbasani!

A ndofta të kish ndjekur gjer te porta,
A nga avllitë e larta ishte ngjitur
Dhe pas ullirit netëve të ftohta
Ka pritur e ka pritur...

Ne fatin tënd të shkretë nuk e dimë,
Nuk dimë se në ç'rrugë shkoi karvani,
Dhe ç'ish ai që prishi dashurinë,
Dudi prej Elbasani!

Veç kënga nuk të la, po pas me vetë
Të mori e të shpie në udhë e pragje,
Dhe ti përjetë e dashuruar mbete
Dhe varrin e ke plot me manushaqe...

1966

Gërmadha e mullirit

Këtu gërmadhat i ka mulliri,
Ku bluanin grurë për bukë plakat;
Atyre në varre u ka mbetur veç hiri
Dhe në kujtesat tona përrallat.

Dhe nusët që bënin kulaç me grurin e bluar
U plakën dhe vdiqën me kohë;
Mullirin të gjithë e kanë harruar
Si një kërcu të vetmuar nën llohë.

Veç këngën e vjetër për millonanë
“Aman, millona, pse s’e blojte grurin...”.
Në ndonjë kumtesë tek - tuk në Tiranë
Folkloristët e mburrin...

Ftujkëza

Ftujkëz lart në bokërrimë,
Zbrit këtej e tok të rrimë
Nën një rrap, nën një dafinë.

- Jo, se burri del në lëmë
Dhe zë shahet: "Ku ke qënë,
Cickën kush ta paska ngrënë"?...

Përtej te gorrice

Përtej te gorrice
Tri kandile ndezur,
Çupën ke nën sisë,
Djalin ke nën sqetull.

Përtej te gorrice
Tri kandile ndezur,
Më bëre binjakë,
Ndaj më qënke tretur.

Përtej te gorrice
Tri kandile ndezur...

Shqerkë e vogël

Shqerkë e vogël me gërshetë,
Të gënjeu, a deshe vetë?

Më gënjeu faqerrogozi,
Ra mbi cickat e m'i sosi.

Të diel me natë

Të diel me natë
Të ngrihesh të vish;
Të vish nga të vish
Fushës të mos vish,
Fusha ka ushtarë,
Futesh - u fut zjarrë.

Të diel me natë
Të ngrihesh të vish;
Të vish nga të vish
Malit të mos vish,
Mali ka kusarë,
Hyn - i nxjerr të marrë...

Ma mbaje shaminë

Ma mbaje shaminë
Dy gisht përmbi vetull;
Sa më qënke ligur,
Sa më qënke tretur!

Ma bëje lakrorë
Përsipër të djegur;
Kush t'i prishka mendtë,
Gështenjë e papjekur!...

Kishe dalë e rrije

Kishe dalë e rrije
Në sofat të portës,
Më prishe nga mendtë,
Çupë e Lamçe Podës.

Kishe dalë e rrije
Afër trëndafilit,
Të digjej jeleku
Nga zjarret e gjirit.

Bëre tatëpjetë

Bëre tatëpjetë
Nga lumi i Lubonjës
Zënë me çapkënin
Për gishtërinjtë e dorës.

Të humbën unazat
Te lumi i Lubonjës,
Manushaqe e prillit
Në mes të dëborës.

O çoban me fyell e gunë

O çoban me fyell e gunë,
Silli dhentë nga them unë
Andej nga ka lule shumë;

Silli t'i futim në shtrungë,
Silli ti dhe t'i mjel unë,
Të fryhen vedrat me shkumë.

O çoban, të desha shumë,
Dhentë në satër t'i vunë,
Humbur ti dhe humbur unë...

O kjo anë e lumit

O kjo anë e lumit,
Ka bilbila shumë,
Dale, çapkën, dale
Sa të rritem unë.

Fusha më bën baltë,
Mali bën furtunë,
Dale, bandill, dale
Jam e vogël shumë.

Nëpërkë e shullërit,
E djegur për ujë,
Dale, pëllumb, dale
Sa të rritem unë.

U çmenda, po lidhmëni

U çmenda, po lidhmëni,
Te miksha shpimëni;
Ajo di e bën magji,
Me mollët që ka në gji.

Tek dy mollët zgjidhmëni,
Sipër mikës shtrimëni,
Të më kthejë me magji
Nga të çmendur në njeri.

Nga të vij, i mjeri

Nga të vij, i mjeri,
Jam varr i vithisur!
- Eja më të sipërm,
Nga deriçkë e prishur.

Qeni është i lidhur,
Motra rri me vjehrrën,
Eja më të sipërm,
Mos e shty aq derën.

Ftjukëz e bardha me zile

Ftjukëz e bardha me zile,
Rrugës së malit kur vije
Të dy cickat m'i djerisje
Me shami të bardhë i fshije.

Ftjukëz e bardha në vreshta,
Më gënjeve me gënjeshtër,
Thoshe: dal të vijë vjeshta!
Pastaj heshte, pastaj heshta.

Ç'ka që qan bejkë belaja?

Ç'ka që qan bejkë belaja?
I ka humbur fukaraja
Nëpër pyje, nëpër pllaja.

Fukaraja s'kërkon gjë:
Të fle një natë me të,
Kokën pres e s'i bëj gjë!

T'i shkopsit kopsat e gjirit,
T'i shoh gurë e xhevahirit,
Të tretem thëngjill mes hirit.

Moj thëllëza, në ju ndafsha

Moj thëllëza, në ju ndafsha
Si lisi në mal u thafsha,

Më çafshin, më bëfshin dërrasa,
Më bëfshin me to govata,

Më shpënçin krua më krua
Të lahen çupat mbi mua...

Mike me flori në grykë

Mike me flori në grykë,
Vetëm je, a vetë e dytë?

- Vetë e dytë me kunatë.
Shtrona një dyshek të lartë
Ja të kuq, ja të bajraktë!

- Eja se shtrova dyshekun,
Zgjat dorën, zbërthe jelekun!...

Jelek me kopsa të argjenda,
Upu - pu, se ç'ka përbrenda!

Gjëmë e zezë e kalë i bardhë

Gjëmë e zezë e kalë i bardhë
Hingëllin arë më arë,
Kërkon Abedin Medanë
Të zotin e tij të vrarë.

Male e fusha anembanë
Derdhin lot e zi po mbajnë,
Qajnë Bido kapedanë,
Gjëmë e zezë e kalë i bardhë.

Ç'u mbush fshati dërrasë e trarë
Për t'u bërë djemve varrë,
Gjëmë e zezë e kalë i bardhë
Hingëllin arë më arë...

Qani male, qani fusha

Qani, male, qani, fusha,
Bir, Qani, të pret Garusha,

Bir, Qani, të pret jot ëmë,
Flokëprishur, e pangrënë,

Të pret kali në katua,
Thotë: kush më hipën mua...

Bilbilenjtë trembëdhjetë

Bilbilenjtë trembëdhjetë

Vanë në litarë vetë.

Vanë Bilbilenjtë, vanë...

Veziri hapi fermanë:

- Ngreu, Bilbil, të hedh litarë!

- Dale, bej, të dredh cigarë,

Se nuk jam çanak me dhallë,

Po jam Bilbili me pallë!

Lanet paç Xhelal Voshtina,

Vare trembëdhjetë trima,

Trembëdhjetë Bilbilenjtë

Vanë në litarë vetë.

Vanë Bilbilenjtë, vanë,

Veziri hapi fermanë...

Vjen një lumë i turbullt

1.

Vjen një lumë i turbullt,
Valët mal me kunguj,
Sjell një trim të mbytur
Me kërcunj përfytur.
Zbret e ëma anës
Dhe i lutet valës,
Valës e stërkalës:
- Nxirrma, lumë, djalin,
Djalin degë-malin,
Nëna nuk ka tjetër,
Mbetur degë e vjetër...

2.

Po gugasin turtujt,
Vjen një lumë i turbullt,
Sjell një trim të mbytur
Me kërcunj përfytur;
Del e motra anës,
I përgjunjet valës:
- As ma nxirr vëllanë,
Qan shtëpia tranë,

Qan oxhaku prushin,
Qan hardhia rrushin,
Motra qan vëllanë,
Qyqja qan në thanë...

3.

Vjen një lumë i turbullt,
Turbullt nëpër muzgujt,
Sjell një trim të mbytur
Me kërcunj përfytur;
Shkon e shoqja anës
Dhe i qahet valës:
Nxirrma, se çdo natë
Një tërkuzë e gjatë,
Nxirrma se jam vetëm
Në mos nxirr një tjetër,
Unë flas me murin,
Qan dysheku burrin...

Kthehet vasha në shtëpi

Kthehet vasha në shtëpi
Nëpër baltë e nëpër shi,
Pret në lis një korb i zi.

- Ah, o korb, që sytë i ndrit
Dhe me sqep në lis çukit,
Nuk jam jotja, mos më prit...

Rrëmbeu plaku plakën

Rrëmbeu plaku plakën
Mbrëmë tërë natën;

Ç'u gdhinë nën urët
Të dy nën lëkurët.

Ç'e gjetën një thes me arra,
Ç'e vunë të dy përpara;

Plaku çaj e plaka çaj,
Plaku qaj e plaka qaj...

Plaku çante një nga njëzë,
Plaka hante si thëllëzë.

U hodh plaku sipër plakës;
- Ik, or plak, se s'bën aspakëz!...

Atje ku do vemë

Atje ku do vemë,
Kur të kemi vdekur,
Një sërë me pleq
Kemi për të gjetur
Me cigare shuar,
Me çibukë tretur.

Atje ku do vemë
Kemi për të pjekur
Një sërë me plaka
Me gjergjefë hedhur,
Me ojëra flakur,
Me qëndisma shkelur...



Lutja e kambanës

Profeti i nëmur

*Mallkoni dhe shani dhe çirri turinjtë,
Jam shpirti i një guri, ku falen qirinjtë;*

*Mbllaçitni proverbat dhe turrni gënjeshtat,
Më kthehen në ikona dhe strofat dhe vjershat;*

*Lëshoni blasfema, përcillmëni dhimbje,
Nënqesh se në male më pret dhe një lindje;*

*Qëlloni me fjalë e goditni me hekur,
Unë jam i pavdekshëm përgjersa s'kam vdekur...*

1991 - 1992

Asgjë nuk më bënë

Më ftuan në darkën e fundit, më fyen e pa gota më lanë:
Që para teje të isha i mundur, një shelg i prerë a një plep.
E pe? Asgjë nuk më bënë, u frynë e zhurmuar, ikën e vanë!
Ah, për gotat?... Të tjera gota unë kisha në xhep...

Unë prapë s'jam mundur, s'jam vrarë a prerë dhe prapë të dua;
Mua më mund, më vret a jetën ma prish
Vetëm ai - i barabarti me mua,
Të tjerët as veshin s'ma kruajnë, ta dish!...

Korrik, 1994

Në luftë

Unë s'jam nga ata që ikin nga lufta,
Kur marrin në trup një gërvishje,
As nga ata që heshtin të futur në tuta,
Kur i pështynë me tallje e skërmitje.

Unë jam gjithmonë mes luftës mizore
Dhe them: sikur dhe luftë mos ketë,
Për dhimbjen e madhe njerëzore
Do ndizja luftën me retë.

1994

Udhëtari

O mik,
Mos u kthe i zgërlaqur nën strehët,
Udhëtar i ikur prej vetes!
Unë u gabova që u ktheva aq herët,
Tani kam prangat e heshtjes...

Shtator, 1995

Për trimërinë dhe frikën

Për trimëri të madhe nuk jam shquar,
Po edhe frikacak s'kam qënë kurrë;
Ka ndodhur të jem trembur e hutuar
Dhe me keqardhje, s'jam treguar burrë.

Kur endeshin qefinë për të vdekur
Dhe merrej nëpër këmbë nderi i miqve,
Një copë e trupit tim mund të ishte djegur,
Që t'u verbonte sytë e kuq të ligjive;

Kur e vërteta mpleksej me gënjeshtërën
Dhe fshihej nëpër mjegull pikëllimi
Mund ta zbuloja duke grisur heshtjen
Dhe duke ngritur valë zëmërimi.

Megjithatë një frikacak s'kam qënë;
Mbi veten time njerëzit i kam dashur
Dhe s'kam përmbysur sofrën ku kam ngrënë
Me mall, me lot në sy e buzëplasur.

Lamtumira e flamujve

Ju flamujt e mi, lamtumirë,
Ju flamuj gjakosur e grisur,
T'ju mbaja ka qënë e vështirë,
T'ju hidhja s'kam qënë i lajthitur.

Ndaj vdisni në gjurmët e gërryera,
Përzihni mes hirit dhe rërës
Dhe shtrihni me shtiza të thyera
Në shkallët e verdha të hënës,

Atje në Saharën e ëndrrës...

1995

Vetmia

O vend i bekuar, o gur i mallkuar,
Ku mbolla të ritë dhe korr pleqërinë,
Edhe kur jam diku i vetmuar,
Nuk jam fajtor aspak për vetminë.

Po hyj i fundosur në jetën e mjegullt,
Me malet e rëndë mbi shpinë...
Nuk ishin fajtorë të tjerët në shekujt,
Nuk jam as unë fajtor për vetminë.

1994

Lutja e kabanës

Jam nisur të mbetem një kabanë,
Aspak s'tingëlloj e s'gjëmoj po s'më ranë.

Më bini, ju lutem, përherë e ngaherë
Në doni prej meje gjënim e poterë...

1994

Kundërshtarëve të mi

Ju aq baltë po hidhni mbi mua,
Sa në baltën që kam përmbi trup,
Mund të mbijë një dardhë a një ftua,
Një koriye e madhe me dushk.

Në koriye dhe dru mund të mbani,
Mund të shkoni për gjah me langonj,
Mund të ngjiti në pemë të hani,
Po të doni dhe dardha, dhe ftonj.

Balta ngrihet mbi mua e pasur,
Sa mbi baltën koriya bleron...
Trupin tim ma bleruat padashur
Dhe ma bëtë vërtet plantacion.

Shtator, 1994

Nisja dhe kthimi

Kur nisem për udhë
Më ndrit çdo gjë e kam shpresë,
Kur kthehem, kam gjumë,
Diçka fillon nga vetja ime të vdesë...

1994

Kur të jesh mërziur shumë

Kur të jesh mërziur shumë

Këtu s'do jem, do jem larguar:
Në tokë i tretur si të tjerët,
Në kafenenë e preferuar
Nuk do më shohin kamerierët.

Dhe nëpër udhët ku kam ecur
S'do ndihet kolla ime e thatë,
Mbi varrin tim do rrijë i heshtur
Një qipariz si murg i ngratë.

Ti do trishtohesh atëherë,
Se s'do më kesh në dhomë gjallë,
Dhe kur në xham të fryjë erë,
Do qash me erën dalëngadalë.

Po kur të jesh mërziur shumë
Në raft të librave kërkomë,
Atje do jem i fshehur unë,
Në ndonjë fjalë e ndonjë shkronjë.

Mjafton që librin pak ta heqësh
Dhe unë do zbres, do vij pas teje;
Ti si dikur me mall do qeshësh,
Si një blerim pas një rrëkeje.

1983

PËRTËRITJE E LIRIKËS SHQIPTARE

Bregu i artë i estetizimit / rrëpirat e zhgënjimit dramatik

Poezia kombëtare nuk është veçse një zhvillim, risim dhe përtëritje e vazhdueshme e thelbit të vlerave të mëparshme. Ajo përtërihet në mënyra dhe rrugë të ndryshme, por gjithmonë nëpërmjet veprave shumë të pasura ose të mëdha, të cilat krijohen nga përputhja mjaft e vështirë e një vargu rrethanash letrare dhe jashtëletrare, doemos e një koncepti të ri poetik dhe e një shijeje të re me dhuntitë krijuese të shumanshme të autorit. Sidoqoftë, do të jenë vepra që ngenë në një shkallë të re, më të lartë një sërë tiparesh, përbërësish dhe prirjesh kryesore, pa të cilat nuk mund të kuptohet poezia kombëtare; vepra që përmbledhin në vetvete *ndryshimin, zhvillimin, kapërcimin* e traditës dhe *vijueshmërinë* e natyrshme të saj; *risimin* sa edhe *përtëritjen*. E tillë është poezia e Dritëro Agollit: *risuese* dhe *përtëritëse*. Dritëro Agolli, një nga poetët më të fuqishëm dhe më të shumanshëm jo vetëm në ditët tona, por në krejt historinë e poezisë kombëtare, ka shkruar një vepër mjaft të pasur dhe të larmishme, e cila ka luajtur rol kryesor, sikurse ajo e Ismail Kadaresë, Ali Podrimjes, Fatos Arapit, Martin Camajit, Azem Shkrelit, në risimin dhe përtëritjen e poezisë shqiptare në këtë gjysëmshkulli.

Me një mendim të madh, që përfshin tërë botën bashkëkohore shqiptare në lëvizje, me figurshmëri përherë konkretizuese, e thurrur, kryesisht, me imazhe pamore, prandaj mund të quhet poezi - pikturë, por edhe me imazhe dëgjimore, që mund të quhet njëherësh edhe poezi - muzikë; e paarritshme në bukurtingëllim; e pangjashme në bashkëkohësi me estetizimin e përditshmërisë; e paimitueshme në

ligjërimin poetik në formën e bisedës së lirë, ku unë-i poetik dhe receptuesi janë në një rrafsh, ajo është thellësisht origjinale.

Vazhduese e drejtpërdrejtë e disa tipareve kryesore të poezisë kombëtare, herë-herë deri në ngjashmëri, përtëritëse tërësore e saj, ajo është një cilësi e re e prirjes sonë klasike, prandaj autori i saj, duke qenë një patriark i poezisë së sotme, është, tashmë, edhe një klasik bashkëkohor.

Duke ngritur në kult atdheun dhe etnitetin shqiptar, njeriun me identitet të theksuar dhe jo atë të universalizuar, të abstraguar, ajo mban gjallë prirjen më të rëndësishme të poezisë kombëtare, të shfaqur më fuqishëm në veprën e Naim Frashërit dhe Gjergj Fishtës. Integrimi i gjithmundshëm i përbërësve folklorikë, lëvrimi i të gjitha llojeve poetike, herë-herë riaktivizimi i disave prej tyre, p.sh., i poemës rrëfimore, baladës e tingëllimës, përdorimi i të gjitha llojeve të vargjeve, strofave, rimave të metrikës shqipe në të përbëjnë një përtëritje të madhe të lirikës shqiptare. Edhe satira e tij, e paktë në poezinë shqiptare, sidomos për shqiptarin që i bjerr cilësitë e veta, që tjetërsohet edhe në drejt, nuk mund të mos mendohet, veçse vazhdë e satirës së Çajupit dhe të Fishtës, por, natyrisht, me ato shformime që kanë shkaktuar mbi të rrethanat e reja shoqërore. Madje, në të rifunksionalizohen edhe përbërës strukturorë të traditës që, në poezinë bashkëkohore, thuajse, janë zhdukur. Në braktisjen e përgjithshme të llojeve epike, lirika e tij ndërfit në vetvete, rifunksionalizon rrëfimin, mjetin kryesor të thurjes epike. Rrëfimi, sado që tepër i hollë, mbetet filli i organizimit strukturor të saj, natyrisht, jo aq si mjet i krijimit të kohës, sesa si mënyrë e shpalosjes në kohë të gjendjes, mendimit, situatës. Dy silueta konkrete të figurës njerëzore që kundërshtojnë ose pohojnë njëra - tjetrën Unë dhe Ti, Unë dhe Ai, po ashtu, përvijohen. Kësisoj, në të është ndryrë jo pak nga konkretësia, vijueshmëria dhe qartësia e epikës.

Po si mund të krijohet vlera të mëdha Dritëro Agolli, që ka qenë poet i realizmit socialist, madje dhe kryetar i LShA-së në diktaturë?

Si mund të pasurojë, për më tepër, të përtërijë lirikën shqiptare një vepër që është e realizmit socialist? Këto janë kundërpyetjet më të mundshme gjatë interpretimit të saj, të cilat i kanë në majë të gjuhës shumë lexues, pse jo edhe të ashtuquajturit kritikë, fatkeqësisht, ende të paçideologjizuar. Mirëpo, fjala është për vlerat e mirëfillta artistike, për përtëritjen e përbërësve poetikë dhe jo për mbishtresat politike që, asnjëherë nuk janë letërsi e vërtetë, edhe pse një herë kanë ndikuar për ta mbiçmuar poezinë e tij dhe një herë tjetër për ta nënvleftësuar atë.

Pavarësisht nga krijimet e shquara të realizmit socialist (disa poema), lirika e tij është shumë e gjerë dhe, gati, pa mbishtresën politike. Përveç kësaj, pesë vëllime, pra, gjysma e poezisë së tij, që është dhe niveli më i lartë i saj, është shkruar në rrethanat e mendimit të lirë (1991-1998). Zhgënjimi prej komunizmit, apokalipsi në botë dhe në ndërgjegje, realiteti i ri politik shqiptar tepër i turbullt, pasiguria e përgjithshme dhe vetjake dhanë një çarje të madhe, ndryshuan mënyrën e trajtimit poetik, duke e zhvendosur nga bregu i artë i himnizimit dhe idealizimit, pra, i estetizimit të krejt botës shqiptare, në rrëpirat e zhgënjimit, mosbesimit dramatik dhe tragjik. Por mbeti ura lidhëse mbi këtë çarje të madhe: nuk humbi ndjenja e zbulimit të të bukurës, qoftë edhe në jetën e tronditur e të çoroditur, nuk u tret thelbi realist, por u zhvillua shumë më tepër, nuk u tjetërsua idealisti dhe as vetë poeti.

Galileu para turrës së druve shqiptoi nën zë: "E, megjithatë rrotullohet!", ku përmbloodhi jo vetëm thelbin e zbulimit të madh shkencor, por edhe mbylljen madhore të jetës së tij. Dritëro Agolli, para turrës së rrënimeve, zhgënjimeve, vuajtjeve thotë: "Megjithatë, nuk është e keqe jeta", pikërisht, "jeta zuskë". Njeriu është Krisht, edhe pse shpesh shndërrohet në Judë. Në fazën e re (1991) ka një hapje të madhe të perceptimit poetik, një larmi të madhe ndjeshmëri - motivesh. Rruzulli i jetës, tani, vërtitet parë e mbrapsht, duke u mbajtur në dy polet e saj: jeta dhe vdekja. Shija estetike e

pastër, e paideologjizuar i zhvlerësoi e i dogji jo pak krijime, herë-herë të rëndësishme. Mirëpo, në kontekstin e ri shoqëror dhe letrar, poezia e tij, nga hiri i krijimeve të djegura u fuqizua si feniksi, natyrisht, pasi kaloi purgatorin e purifikimit estetik. Dhe purgatorin e purifikimit e kaloi shumë shpejt, ndryshe nuk do të kishte si t'i dyfishohej ritmika e krijimit.

Poeti, i pamallkueshmi

Poezinë e risojnë dhe e përtërijnë ata autorë që, ndër të tjera, shembëlajnë "me portretin e etërve" poetë, të cilët kanë hyrë në panteonin e saj. Dritëro Agolli është mishërim i tipit më të çmuar të poetit shqiptar: njëherësh poet dhe misionar shoqëror e kombëtar, "i ngatërruar" në politikë për mirë a për keq, i panginjur në përthithjen e poezisë botërore dhe asaj popullore shqiptare, intelektual i nivelit më të lartë, por dhe tribun popullor, njëlloj komunikues me publikun nëpërmjet artit dhe ligjërimit gojor, sikundër kanë qenë De Rada, Naim Frashëri, Gjergj Fishta etj, kurse, në rrafshin evropian, ngjan jo pak në tipare dhe në biografi me Viktor Hygoin dhe Lui Aragonin, dy autorë të mëdhenj që shkrinin në një poetin dhe misionarin politik, pikërisht, në Francë - model i qytetërimit dhe i emancipimit. Madje me Lui Aragonin e afron shumë edhe besimi tek komunizmi, himnizimi i tij, përqaftimi i realizmit socialist, siç e afron edhe zhgënjimi i madh që, tek të dy ka qenë shkak i ndryshimit cilësor dhe i fuqizimit të poezisë¹⁾. Prandaj edhe përtëritja e lirikës shqiptare me veprën e tij të sjell ndër mend përtëritjen e poezisë franceze me veprën e Hygoit dhe të Aragonit.

Mirëpo, poeti bashkëkohës shqiptar më popullor, në këto vite të kalimit shoqëror, si dhe të kapërcimit të traumave shpirtërore e psikike, për qëndrimet politike, dje dhe sot, është anatemuar rëndshëm prej disave, madje ta kishin në dorë do ta shpallnin të

Shënimet përkatëse janë në fq. 384

mallkuar, njëlloj si fundamentalistët islamikë Salman Ruzhdinë! Megjithëse veprimtaria politike është e drejtë e gjithkujt, tek ne vazhdon të paguhet shtrenjtë. Dritëro Agolli e ka marrë përsipër me kurajë ta paguajë këtë taksë të paligjshme, duke shlyer, njëherësh, me pasurinë e tij të jashtëzakonshme intelektuale dhe shpirtërore, edhe për të djeshmen. Por atë asnjë mallkim nuk e ka zënë, sepse nuk janë mallkime të vërteta, p.sh., të zotave të qiellit - të drejtësisë hyjnore - dhe as të njerëzve të ndershëm të tokës, por janë sulme të kundërshtarëve xhuxhë. Mallkimi i vërtetë për të do të ishte venitja, tharja e poezisë, kurse poezia i lulëzon më tepër se kurrë, shenjë domethënëse se nuk është as mëkatar.

Poeti, asnjëherë në arealin e vet, s'mund të jetë i mallkuar, sado të hidhen mbi të blasfemi gjithfarësh. Poeti është *i pamallkueshëm*, sepse është lindur për të dashur njerëzit apo është bërë poet nga dashuria për njerëzit, nga vetësakrificimi shpirtëror dhe intelektual, nga dhimbja, vuajtja e përkushtimi për ta si një shenjt, nga venitja për t'u dhënë më të vështirën, më të rrallën, më të përkryerën - kënaqësinë estetike. Poeti, gjithmonë i dashuruar me njerëzit dhe i tretur për ta, nuk mund dhe s'ka pse mallkohet, përkundrazi, meriton nderimin më të madh.

"Në fakt, zemra njerëzore, ka shkruar Viktor Hygoi, nuk ndryshon aspak, me gjithë revolucionet shoqërore politike: ajo mbetet gjithmonë zemër njerëzore, bazë e artit ²⁾"

Në "zemrën" e Dritëro Agollit nuk është luhatur aspak dashuria për njeriun, pavarësisht nga ndryshimet, nga "revolucionet shoqërore politike" tek ai mbeti e madhe dashuria për njeriun. Humanizmi ka qenë përherë filozofia e vërtetë e veprës së tij. Bindja e shtrembër e disave, megjulla e krijuar nga sulmet qëllimkëqija jashtëtrare të disa të tjerëve se gjoja kishte mbërritur në Olimpën e poezisë lehtësisht, nga shkallët e pasme, se gjoja ishte imponuar zyrtarisht, duke fluturuar nga Olimpi i karrierës politike, po davaritet pak nga pak. Rruga e tij e vërtetë ka qenë tjetër. Para se të ishte në atë që mund të quhet "kulmi i lavdisë politike" (kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve

dhe Artistëve, deputet etj.), Dritëro Agolli ishte ngjitur hap pas hapi, faqe lexuesit dhe kolegëve shkrimtarë, nga shkallët e parme në Olimpën e poezisë, sepse poet ishte. Atë e ftuan në hierarkinë politike se ishte ngjitur në kulmet e poezisë. Edhe në rrethanat politike "të papërshtatshme", "të palavdishme" në karrierë, edhe kur s'ka qenë kryetar, poezia jo vetëm nuk u ul prej majave, po, përkundrazi, pushtoi kuota më të larta në atë Olimp.

Perpetum mobile

Udha-udhëtimi përbëjnë një metaforë metonimike të pandashme, tepër karakteristike, shprehëse e lëvizjes së madhe e të llojllojshme që mbart në vetvete poezia e Dritëro Agollit. Lëvizja është shkak frymëzimi, mënyrë e qënies dhe e përsosjes së njeriut, përftesë metaforike e metonimike e shestimit të vetë lirikës. Gjithçka në të përftyrohet imagjinativisht dhe "sendëzohet" figurativisht në lëvizje dhe ndryshim: natyra, shoqëria, mjedisi, jeta, njeriu, mendimi dhe ndjenjat e tij, e bukura, poeti dhe poezia, toka e qielli me dukuritë e tyre. Ndryshimi shkaktohet pa ndërprerje, qoftë prej rrethanave dhe vetvetes së gjithçkaje, qoftë prej vetëdijes dhe veprimtarisë njerëzore si në një *perpetum mobile*, që, me termin e pëlqyer të Dritëro Agollit do të quhej *dialektikë*, d.m.th. *ndryshueshmëri e përhershme*.

Një *perpetum mobile*, një ndryshueshmëri e përhershme, por jo në pafundësi, siç nënkupton sintagma latine. Ajo nis prej vetvetes për tek vetvetja, *brenda një kohe të caktuar*, nga lindja tek vdekja, që përputhet me kohën reale të unë-it poetik dhe, *në një hapësirë të gjerë*, në tokën që ai lëvron dhe në qiellin që aspiron. Një lëvizje e ndryshueshmëri, ku, prej çdo pike të mbërritur, kthehet në fillim dhe prej andej përsëri në skajin e mëparshëm deri në fund. Prandaj, nisja - kthimi, afërsia - largësia, malli - çmallja, dashuria - humbja e dashurisë- përbuzja, shpresa - zhgënjimi, gëzimi - vuajtja - dhimbja, fëmijëria - rinia - pjekuria - pleqëria, jeta - vdekja, përditshmëria - përjetësia, toka - qielli janë metaforat metonimike që shtrojnë udhën

e kalimit nga njëri skaj në tjetrin të kësaj lëvizjeje, ndryshueshmërie të pandërprerë. Është qenia njerëzore, e kufizuar në kohë, që e përcakton të tillë edhe perpetum mobile-n e pafundme, sepse në poezi është vetëm pjesa e saj e përshkuar dhe e përjetuar prej unë-it poetik, pra, e përmbledhur brenda një jete njerëzore.

Jeta vetjake e secilit, kështu, dhe e unë-it poetik është udhëtim i pandërprerë, ndërsa vraga që le mbrapa, në kohë dhe në hapësirë, është udha e qenies së tij në lëvizje, në ndryshim, plot zikzake, ngjitje - zbritje në malin e thepisur të vështirësive, natyrisht, me një fillim - fëmijëria dhe adoleshenca dhe, me një fund - vdekja, vendqëndrimi i mbramë, pa kthim. Është udha e shtegtarit misionar në truallin e jetës shqiptare, por është edhe udha universale e njeriut në truallin tokësor dhe në truallin e jetës tokësore. Edhe jeta si abstraksion është një udhëtim bashkarisht e individualisht, një ecje a vrapim i përditshëm i morisë njerëzore drejt finales së vet.

Metafora e udhës - udhëtimit pasurohet me "degëzimet" e saj të përiferëta: nisja, pritja, malli, ndalimi, ngecja, shtëpia, kthimi etj. Metafora e shpeshtë e *nisjes* ka antonimin e vet metaforik po aq të shpeshtë - *kthimin*. Pa motivin e kthimit, leitmotivi i udhës - udhëtimit do të ishte i shkurtër dhe i ndërprerë. Nisja nuk është "lamtumirë!", por "mirë ju gjetsha!", "mirardhsh!". Ajo gjithmonë shënjon ose nënkupton kthimin. Edhe kthimi është në pikëvështrim të ndryshme. Kthim real apo imagjinar në vendlindje, kthim imagjinar tek fëmijëria - adoleshenca, kthim tek dashuria, tek shtëpia prindërore, tek çerdhja familjare, kthim tek puna, kthim nëpërmjet nostalgjisë tek dashuria e dikurshme po e humbur prej moskuptimit, meskinitetit, detyrës, pakujdesisë, një pasuri e tërë mendimesh dhe gjendjesh emocionale.

Kthimi është edhe metaforë e pasivitetit, e vdekjes shpirtërore dhe mendore ("Nisja dhe kthimi"), pasi është tërheqje mbrapa, humbje e ndryshimit, progresit, mungesë veprimtarie:

Kur nisem për udhë
Më ndrit çdo gjë e kam shpresë,
Kur kthehem, kam gjumë.
Diçka fillon nga vetja ime të vdesë...

Vdekja, gjithashtu, është një lloj udhëtimi, po, që quhet *largim*, udhëtim pa kthim, nisje për andej, në botën tjetër, *ëndërrore*, në një kohë të pafundme dhe në një hapësirë të pakufishme, e cila, ndryshe nga jeta tokësore, nuk ka asgjë lëndore ose njerëzore, sikurse është fryma, vet shpirti njerëzor. Sapo largohet njeriu, shfaqet *qiriri i kujtimit* për të, që digjet gjersa të jetë gjallë kujtimi, sidomos vepra e tij. Për të virtytshmit, vdekja është rënkim që i çliron nga trupi. herë - herë, i mundimshëm, që i shkëput nga toka, është fluturim nëpër qiej, në botën eterike të prehjes absolute. E ndjera nënë, bie fjala, në një nga lirikat më të mira ("Vdekja e nënës") zvogëlohet dhe tretet derisa shndërrohet në pulëbardhë, fluturon përtej reve dhe prehet diku, mes yjeve, pranë Afërditës. Përfytyrimi poetik, në këtë mënyrë, njësohet me përfytyrimin biblik, fetar për jetën e përtejme. Edhe prej hapësirave të pafundme të saj, ku humbet lënda njerëzore, fluturojnë kujtimet, e mbështjella me retë e dendura të dhimbjes e nostalgjisë.

Përjetësia përftohet nëpërmjet "ringjalljes" apo nëpërmjet pavdekësisë, të simbolizuar në "trajtën e ngrirë" të veprës krijuese, të bëmave historike, të kujtesës e dhimbjes të të gjallëve për të ndjerët. Prandaj, kur e shoqja të jetë mërzhitur shumë dhe të ketë mall për bashkëshortin poet, të larguar si të tjerët ("Kur të jesh mërzhitur shumë"- një perlë tjetër agolljane) do ta gjejë atë në shkronjat e librave, pasi udhëve s'do të ndihet kolla e tij e thatë:

Po kur të jesh mërzhitur shumë
Në raft të librave kërkomë,
Atje do jem i fshehur unë,
Në ndonjë raft a ndonjë shkronjë.

Kështu, janë në ndjenjat e të gjallëve bëmat trimërore të Maro Podgozhanit, bëmat gazmore të Mekes etj.

Në *udhëtim*, bashkë me njeriun ecën edhe *koha*, krahazi me stinët e moshës së unë-it poetik këmbehen stinët e motit; me ditët, javët, muajt, vitet rrjedh lumi i kohës. Unë-i i tij poetik është udhëtar, shtegtar i përhershëm që do të thotë edhe misionar i përhershëm në jetën, kohën dhe hapësirën e vet. Ai është Zarathustra¹⁾ që nuk kërkon madhështinë, por thjesht të shprehë, të arrijë, të realizojë vetveten, të ndjejë kënaqësinë e të jetuarit duke punuar, të ketë kënaqësinë e virtytit e të bëmave historike. Zarathustra agolljan nuk përshkon udhën universale nga kafsha tek mbinjeriu, po përshkon udhën vetjake nga lindja tek vdekja, shtegtari i tij është një lloj odiseje që nuk e ka humbur atdheun, e, megjithatë shtegton përjetësisht, për të kryer misionin shoqëror, për të zgjuar të përgjumurit, për t'u përleshur me të keqen kudo që është - një lloj Don Kishoti, për të dhënë shembullin e mirësisë e të virtytit, për të paralajmëruar e profetizuar, për të ndikuar në përsosjen e njeriut.

Me metaforat metonimike *udha - udhëtimi - udhëtari* janë shestuar herë drejtpërsëdrejti, herë tërthorazi të gjithë titujt e vëllimeve poetike, dhe, po ashtu, secili vëllim, në tërësi, është shestuar mbi përftesën e tyre metaforizuese që shpreh thelbin e poezisë agolljane, dominanten e saj. Ja, titujt e gjashtë vëllimeve:

¹⁾ Zarathustra është udhëtar i përjetshëm. "Unë jam një udhëtar" - i fliste zemra Zarathustrës; "Vetëm tani do të ecësh në rrugën e madhështisë"; (Friedrich Nietzsche, Libri i dytë, PHOENIX, Tiranë, 1997, faqe 7); "Zarathustra ishte mik i të gjithë atyre që i duan udhëtimet e gjata edhe rreziqet" (po aty, faqe 8); "Udha e ekzistencës rrihet përjetësisht" (po aty, faqe 6).

"Mesdita e madhe (kujto vëllimet e Dritëro Agollit "Mesditë", "Fletorka e mesnatës") është atëherë kur njeriu gjendet në mes të rrugës së tij nga kafsha tek Mbinjeriu dhe feston rrugën për në mbrëmje si shpresën e tij më të madhe; sepse është rruga drejt një mëngjesi të ri" (Friedrich Nietzsche "Kështu foli Zarathustra", Libri i parë, PHOENIX, Tiranë, 1996, faqe75).

- Në rrugë dola
- Hapat e mia në asfalt
- Shtigje malesh dhe trotuare
- Udhëtoj i menduar
- Pelegrini i vonuar
- Vjen njeriu i çuditshëm

Kumtimi i titullit është mendimi kryesor i çdo vëllimi. Edhe brendia e tyre shtillet rreth leitmotivit të udhës - udhëtimit, sikurse edhe poetika e çdo vëllimi, në një masë, i është nënshtruar konvencionit të titullit. Gjithashtu, titulli përcjell rrugën e formimit dhe të veprimtarisë, gjendjet shpirtërore, lëkundjet dhe ndryshimin e unë-it poetik, si dhe zhvillimin e shkallë-shkallshëm të vetë krijimtarisë së autorit.

Edhe titujt e katër vëllimeve të tjerë:

- Mesditë
- Fjala gdhend gurin
- Lypësi i kohës
- Fletorka e mesnatës

e kumtojnë lëvizjen, por me metafora më abstraguese, jo të drejtpërdrejta.

Vëllimet "Pelegrini i vonuar", "Lypësi i kohës" dhe "Vjen njeriu i çuditshëm" për Dritëro Agollin janë tre libra, në të tri shkallë apo në tri kohë që "japin lëkundjet dhe lëvizjet e një transformimi, apo më mirë ta themi në gjuhën shqipe, - lëkundjet dhe lëvizjet e një përmbysjeje të madhe shoqërore, e një botëkuptimi dhe psikologjie, e një kontakti me rrjetin elektrik nga del një shkrepëtimë, e cila përcëllon trupin dhe fytyrën e poetit"³).

Në "*Pelegrini i vonuar*" metafora e udhëtimit krijon një imazh më universal përmes fjalës latine *pelegrin*. Shtegtari i përjetshëm, i nisur për në vendin e shenjtë, është *i vonuar*, sepse kishte humbur polin ose ia kishin ngatërruar të tjerë rrugën e së vërtetës. *I vonuar*, krahas

kuptimit të vonesës në kohë, shenjon edhe të humburin, të dështuarin, të pafrytin në misionin e vet, në idealin e vet, tashmë, edhe i zhgënjyer.

Njeriu mishëron vetveten në punë, në bëma historike a në virtyte, në vepra krijuese intelektuale etj., të gjitha në përmasat e kohës, e cila është jo vetëm qenia e tij, por edhe pasuria më e madhe për të. Ai që e kalon kohën e vet pa veprimtari, pa ndihmesë, e humbet këtë pasuri dhe kthehet në lypës. Pa kohë në "*Lypësi i kohës*" do të thotë pa gjurmë, pa vepër, pa vetvete, i pafarë dhe i pafryt, pa individualitet. Lypës i kohës, "më i mjerë se të mjerët", përfundon ai që nuk ka lëvizur shoqërisht, që nuk ka jetuar dhe përjetuar, që nuk ka rikrijuar vetveten, por është ushqyer e ka rrojtur "sipas instiktit dhe normës". Për këtë jeton me kohën e të tjerëve, me kohën e atyre që kanë krijuar. Lypësi i kohës është lypësi i vetvetes, sepse nuk arriti të mishërojë vetveten.

Pelegri i vonuar është shprehje, gati, apostrofike e dhimbjes, sikurse *lypësi i kohës* është shprehje apostrofike e përbuzjes ndaj tij. *Pelegri i vonuar* është metafora e udhës së humbur, e drejtimit të ngatërruar, e kotësisë, pavalershmërisë së misionit; *lypësi i kohës* është metaforë e kohës së humbur, e keqpërdorimit, e hedhjes së saj në greminë. Prandaj, kohëhumbur dhe drejtimngatërruar, unë-i poetik i tij është thellësisht tragjik.

"*Vjen njeriu i çuditshëm*". Një ndërtim i veçantë, ku folja *vjen*, në të tashmen, mbart nëntekstin e habitores. Imazhit të udhës-udhëtimit, të njeriut në lëvizje, që është në titujt e mëparshëm, i shtohet sintagma "njeriu i çuditshëm". Ai, i rëndësishmi që *vjen* nuk është i zakonshëm, por *i çuditshëm*, pa asnjë paragjykim, krejt i çliruar, por edhe i përçudnuar.

Një poezi e tillë ka patur shkaqe të thella gjenetike për të mos u përmyllur tek realizmi socialist, por të mbetej e hapur dhe e patjetërsuar në tërësi, pavarësisht se bashkëjetoi gjatë dhe, herë-herë, u shartua keqaz me të.

Vatra brendie, nyje strukturore

Hapësira e gjerë e lirikës së Dritëro Agollit, nëpërmjet forcës së leitmotiveve, është e *qendëruar* në *vatra të mëdha brendie*, ndër të cilat *spikatin*: toka, atdheu, vendlindja, fëmijëri - adoleshenca, udha - udhëtimi, rinia, shtëpia, vatra, malli, pleqëria, jeta, puna, vdekja, vetflijimi, dhimbja, përvuatja, shpresa, zhgënjimi, pavdekësia, natyra - bukuri e përsosur, poezia, poeti etj. Këto vatra kanë edhe funksionin e *nyjeve strukturore*, ndërkaluese nga njëra tek tjetra. E tërë lirika është zhvilluar dhe strukturuar mbi rrjetin e lidhjeve midis tyre. Po ashtu, ajo receptohet, kryesisht, nëpërmjet këtyre vatrave të përqëndruara, që, si të tilla, janë edhe *fokuse receptivë*.

Çdo vatër ka, zakonisht, një brendi të caktuar dhe të qëndrueshme, por, në një masë, edhe të ndryshueshme, sepse leitmotivet dhe motivet kalojnë tek njeri tjetri, bartin njeri tjetrin, duke krijuar një zinxhir vijimësie të gjatë sikurse edhe një ndërthurje të pandërprerë. P.sh., leitmotivin e atdheut, në një pikëvështrim, e përmban edhe leitmotivi i tokës, vendlindjes dhe, anasjelltas, siç bart, në një pikëvështrim, motivi i shtëpisë, pragut, vatrës atë të vendlindjes, të fëmijërisë. Leitmotivi i punës shtjellohet edhe përmes leitmotivit të udhës, librit, arës, tokës së lëruar, ugarit, ndërsa në leitmotivin e vendlindjes, shtëpisë prindërore, strehëzës, oxhakut, fëmijërisë është edhe jetesa shqiptare tradicionale, popullore etj. Kështu, ka gjithandej një rimarrje dhe ndërthurje të brendive, pra, dhe një lidhje të shumëfishtë të vatrave, duke krijuar *simbioza brendish* dhe, kuptohet, *simbioza figurash*.

Leitmotivi i tokës, metonimitë dhe metaforat e tij, ose, thjesht fjala *tokë*, me funksionalizimet poetike të shumta përbën një nga simbiozat agolljane më të fuqishme, më karakteristike.

1. Toka - pikënisja e gjithçkaje

Dritëro Agolli, me të drejtë, është cilësuar *poet i tokës*. Këtë e ka pohuar shpesh edhe në vargjet e tij. Toka, metaforikisht, mandej

vendlindja dhe atdheu është aerodromi i fantazisë së tij, e cila, ngado që të fluturojë, herë më afër dhe herë më larg nëpër qiej të leitmotiveve të tjerë, herë më ulët dhe herë më lart në vertikalen e abstraksioneve do të kthehet po atje për t'u riushqyer. Poeti, duket qartazi, nuk dëshiron ta lëshojë fantazinë as shumë lart as shumë larg, sepse druhet mos i zvogëlohen dukuritë, mos i humbasin përmasat dhe ngjyrat e tyre reale. Prandaj, në vend të kalit fluturues Pegas, që i hipin të gjithë poetët, ai shalon mushkën xanaxare të vendlindjes, që shkon kudo pa iu vrrarë thundrat. Për të nuk ka rëndësi në ulet në aerodromin e madh kombëtar apo në aerodromthin e vendlindjes, të ndonjë qyteze a qyteti, fushe a bjeshke, pasi të gjithë janë pjesë e truallit amtar.

Toka është nisja dhe kthimi, referimi hapësinor dhe busulla e përhershme emocionale, është jetë, vetvete, dashuri dhe poezi, mjet universal vlerësimi dhe konvertimi. Për këtë nuk shkëputet asnjëherë nga forca e rëndesës së saj. Dalja nga fusha e saj tërheqëse do t'i çrregullonte krejt kozmosin poetik. Mendësive të tilla u shkon mjaft thënja e Zarathustrës: "Qëndroni përherë besnikë të tokës!".

2. Fjala tokë - simbiozë e madhe figurash

Metaforat, personifikimet, simbolet etj. përbëjnë simbiozën e saj. Toka është *metaforë e enigmave të llojlojshme*. Nga vendqëndrimi i adoleshencës dhe i rinisë, kur etja për të mësuar shuhet në detin e njohurive më të ndryshme, ajo më tepër është enigmë gjeografike dhe historiko-kombëtare që zbulohet pak nga pak. Udhë e shkollës, p.sh., ftillon një sërë prej tyre. Më vonë, në vendqëndrimin e pjekurisë, sidomos të pleqërisë, toka është metaforë e enigmave botërore, gjeografike dhe historike, shoqërore, politike e filozofike, të cilat sqarohen shkallë-shkallë, por asnjëherë deri në fund. Enigma e pafundme shoqërohet shpesh me një ëndërr e shpresë të pafundme të zbulimit të ri, tek i cili, ndofta, është e vërteta, lumturia. Ëndrra e

pafundme e mbështjell atë me ngjyime romantike, diku më të forta e, gjetiu, më të zbehta.

Është *metaforë e këngës, artit, poezisë*. Në poemën "Psalm i ri për tokën" njësohet toka me zotin, kënga, arti, poezia autoktone me lutjet fetare të "Dhjatës së vjetër". Kështu, kënga për tokën është edhe psalm ose lutje para Zotit, është edhe himn i mbijetesës shqiptare, një lloj himni kombëtar. Toka e *personifikuar është nënë*. Në të është zënë jeta, puna dhe njeriu; është zënë shpirti shqiptar, është formuar vetëdija kombëtare, janë krijuar traditat shqiptare. Si e tillë, është zonjë e nderuar, nënë e rreptë që ndjek kudo, me uratë dhe përkujdesje njeriun - birin e vet të denjë, kurse plangprishësin, bukëshkalin e përndjek me qortim e mallkime.

Toka e personifikuar është *grua dhe e dashur*, por, më shpesh, është shëmbëlltë e *atdhetarit punëdashës*, human, veprues. Personifikimi, figurimi kryesor i saj, u hap rrugën epiteteve të pafundme, si në një poezi romantike.

Toka është *simbol i pasurive të pashtershme dhe të patjetërsueshme*, lëndore dhe intelektuale shpirtërore, i traditave kombëtare, i qëndrueshmërisë dhe përtëritjes së tyre; *simbol i jetesës së thjeshtë popullore, i mallit* për vendlindjen dhe fëmijërinë, për të kaluarën, ku është shkruar jeta vetiake dhe kolektive - historia e brezave; *simbol i bukurive njerëzore dhe natyrore* pa të cilat jeta nuk do të kishte emocionalitet; simbol i *ëndrrës*, natyrisht, të madhe, të lirisë, përparimit, mirëqenies, harmonisë shoqërore etj.

3. Metaforizim përmes dashurisë hiperbolike për tokën

Në leitmotivin e tokës mbështetet edhe pikëvështrimi kryesor i kësaj poezie, përmes të cilit përjetohen, vlerësohen dhe këndohen, sidomos marrëdhënie të tilla të rëndësishme: tokë - njeri, tokë - atdhe - vendlindje, tokë - punë, tokë - mendësi, tokë - krijimtari intelektuale, shpirtërore etj. Në këtë optikë, *toka dhe njeriu* janë një binom jetësor e filozofik i pazgjidhshëm, madje paraprihen nga ajo që quhet tokë.

Të dy, i thotë i dashuruari vajzës “jemi bërë nga lulet, nga dheu”, ndërsa poeti është një plis i baltës së murrme të vendlindjes, “një grimëz e tokës së madhe”. Prej balte nuk është vetëm trupi, por është edhe shpirti, bota e brendshme njerëzore jolëndore, duke metaforizuar, në këtë mënyrë, lidhjen e ngushtë midis përkatësisë amtare, vendlindjes, traditës dhe vet njeriut. Është mbivlerësimi, absolutizimi i rëndësisë së tokës që e nxjerr njeriun të përbërë prej dheu, lulësh etj. Me këtë *optikë dashurie hiperbolike* krijohet një qëndrim poetik i veçantë që, jo vetëm “arsyeton” deri dhe përbërjen e njëjtë lëndore midis njeriut dhe tokës, por edhe afron e përngjason shpesh gjymtyrët njerëzore me gjymtyrët e natyrës.

Po aq njësohet edhe toka me njeriun. Vektori metaforizues tokë - njeri absolutizon rolin e njeriut. I lidhur ngushtësisht me tokën, ai merr fuqi të mbinatyrshme, është një Ante shtatzakonshëm, po që, me magjinë e tij - punën, gjallëron botën. Bujku, p.sh., e ngroh tokën me frymën e vet dhe i “jep shpirt nga shpirti i tij i çuditshëm”. Edhe kur vdes, kthehet në lëndë tokësore, ndërsa, në rastet më kuptimplotë, kur bie dëshmor, shndërrohet në lis, grurë etj. Për këtë arsye është e natyrshme që, edhe krijimtaria artistike, si pjesë e kozmosit njerëzor, të rikthehet në lëndë të truallit amtar. Arti i madh i Naim Frashërit, vepra e tij është shkrirë kudo: në tokë, në ajër, në drurë, në fruta, në ujin e burimeve: “Vargjet e tua me thërrimet e dheut janë përzierë,/ dhe na duket se me qënien tonë janë shkrirë,/ se i kemi thithur mes qumështit, frutave, erës,/ dhe në burime me ujë i kemi pirë” (“Naim Frashëri”). Në këtë rrafsh, ku toka dhe njeriu, sikurse njeriu dhe toka janë të barabartë, madje me fuqi kozmike të njëjlojta, kalohet natyrshëm në *personifikimin - njerizimin e tokës*, që është në themel të shestimeve poetike, gjithmonë sa më gjallëruese. Jo vetëm personifikimi - njerizimi i tokës, por krejt procesi i figurimit të kësaj linje, pra, krejt metaforizimi i saj, që, nënkupton edhe metonimizimin, simbolizimin etj. kalon përmes dashurisë hiperbolike për tokën.

Shkalla më e lartë, apoteoza e saj është *mitizimi i tokës*, kryesisht, nëpërmjet vetëdijes karakteristike shqiptare, posaçërisht nëpërmjet mendësive fshatarake tradicionale që janë krijuar nga rrezikimi i përhershëm për ta humbur atë. Si çdo gjë që siguron jetesën, por shpesh mungon apo kërcënohet për t'u tjetërsuar, ajo është shenjtëruar dhe mitizuar. Tomorri agolljan nuk ka shumë "hyjni": njeriu dhe puna, toka dhe atdheu. Ndryshe nga njeriu dhe puna që vetëm poetizohen dhe idealizohen, toka dhe atdheu, edhe mitizohen. Mitizimi, si mënyrë krijimi, është një nga anët më moderne të poezisë së tij.

Toka e mitizuar merr shëmbëllimin e një qenieje të mbinatyrshme (gjatë poetizimit është e personifikuar), mitologjike legjendare, me përmasa dhe fuqi të jashtëzakonshme, me sy magjik që shikon gjithçka dhe me vesh magjik që dëgjon gjithçka, megjithëse kurdoherë si e komanduar prej njeriut. Përmbi jetën e zakonshme, ajo është frymëzuese, fuqishtuese, mbrojtëse e tij, sikurse zanat. Për hir të birit të saj, për ta ruajtur atë nga rreziqet vë në lëvizje gjymtyrët gjigande të maleve, fushave, pyjeve, lumenjve. Që nga lart përjeton luftërat dhe gëzon festat e fitoreve, shendohet për lirinë dhe vajton pushtimin, shugullon si moti nga ngjarjet tronditëse kombëtare.

Kështu, të pasura e të larmishme, si simbioza e madhe e tokës, janë edhe simbiozat e tjera karakteristike: atdheu, fëmijëri - adoleshenca, udha-udhëtimi, jeta, përjetësia, malli, natyra etj., të cilat janë, njëherësh, edhe nyje strukturore, edhe fokuse receptivë të rëndësishëm.

Receptimi me imazhe

1. Konkretësia - qartësi dhe emocionalitet

Poezia e Dritëro Agolliit ngjall ndjenja të thella njerëzore nga më të larmishmet por, kurdoherë me anë të një figurshmërie konkretizuese, pasi konkretësia është qartësi, është lehtësi receptimi, ndërsa vetëdija e qartësisë dhe e thjeshtësisë është ideal estetik. Është një konkretësi jo e zakonshme, përmbi relievin e lirikës, që afron me atë të epikës. Konkretësia e saj e madhe, "epike" përftohet fillimisht prej llojit të figurave mbizotëruese, të cilat projektohen në përngjasimin me objektet më të afërta, më të përdorshme në jetën e përditshme, sidomos me dukuritë dhe objektet pamore. Me këtë përftesë, figurshmëria "lëndëzohet", përcaktohet në tërësi, por edhe individualizohet, kurse hollësitë e shumta që vërshojnë nga jeta dhe natyra përreth, cilësi tjetër e spikatur e saj, e pikëzojnë, e përforcojnë, e detajojnë atë. Përveç kësaj, figurat me shprehësi të drejtpërdrejtë, të shkallës së parë, vazhdojnë ta kenë konkretësinë edhe pasi ato zhvillohen në figura më abstraguese ose shumë abstraguese, pra, edhe në shkallët e larta dhe më të larta. Krahasimet, p.sh., të ngritur në sistem për të rritur fuqinë abstraguese, shpesh herë e ruajnë konkretësinë e tyre karakteristike sikurse e ruajnë edhe krahasimet e zhvilluara në metaforë, personifikim etj.

I veçantë, por edhe i dendur është një lloj krahasimi që përngjason dy objekte, dy dukuri konkrete. Në këtë rast, dukuria a objekti i krahasuar, që është po konkret, jo vetëm gjallërohet mjaft, por edhe poetizohet, ngarkohet emocionalisht:

Le të duket pena ime si *fyell çobani*

Dhe kopsa e jelekut *si syri i një bejke të bardhë.*

Pena e poetit dhe *kopsa e jelekut* në gjuhën e përditshme janë objekte të rëndomta, me funksion të përgjithshëm: pena shkruan, kopsa mbërthen, pra sende prozaike, aemocionale. Kur hyjnë në fushën e magnetizmit emocional poetik, tjetërsohen, përcaktohen

më hollësisht në cilësitë dhe funksionet e tyre, tanimë, poetike. Kështu *pena* jo vetëm shkruan, po ato që shkruan janë si kënga, si melodia, si ligjërimi muzikor i fyellit të çobanit, që lindet gjithmonë nga largësia me njerëzit, malli për ta, dhimbja për veten e vetmuar, nevoja e komunikimit. Ndërsa *kopsa e jelekut*, ndofta e zezë dhe e rrumbullaktë, duke u kthyer në sy bejke, merr jetë, shkëlqen si pasqyrë në trupin e bardhë të deles, që është një qenie e butë, paqësore, e dhimbshme për njeriun. Siç shihet, me tjetërsimin e cilësive dhe të funksioneve, objektet gjallërohen më tej dhe, po ashtu emocionalizohen, poetizohen. Të dy krahasimet janë përfutur nga dëshira, pasioni i unë-it poetik për të qënë sa më afër jetës reale - jetës fshatarake e të thjeshtë, sa më afër prejardhjes së tij - fëmijërisë, prandaj edhe mjetet e punës intelektuale, edhe veshja qytetare shdërrohen në objekte të jetës fshatare baritore. Dhe poezia "Qëngji", prej nga është marrë dyvargëshi, këngëton nostalgjinë për fëmijërinë, për jetën e thjeshtë dhe të çiltër. Kjo nuk është një poezi fshatarake, siç mund të duket, përkundrazi, shpreh përjetimet, dëshirën e intelektualit bashkëkohor, por të krahasuara, të afuara, të konkretizuara me objekte të jetës fshatarake. E krahasuar, e afuar, e konkretizuar figurativisht me dukuri dhe objekte të jetës fshatare është pjesa më e madhe e poezisë së Dritëro Agollit, edhe pse shpreh përjetimet e thella intelektuale bashkëkohore. E tillë është përftesa e saj, mënyra e figurimit, prandaj vetëm në një lexim amatorësh mund të duket, kryesisht, me "motive fshati"!

Për këtë arsye, në të mbizotërojnë *krahasimet* që sjellin shëmbëllimin e objekteve dhe dukurive të prekshme, sa më të perceptueshme vizualisht, si dhe *metaforat*, që nuk janë veçse "dyfishim", "trefishim" etj. i po këtyre lloj krahasimeve. Metonimitë e pafundme, sinekdokat e shumta të saj, vetvetiu, si lloj figure janë konkretizuese, sepse janë "lëndore". Edhe piramidat e *simboleve*, zakonisht, qëndrojnë mbi përngjasime të metaforizuara me dukuri konkrete e objekte lëndore. Tropet, si dhe figurat e tjera, sado

abstraguese qofshin, ose nisin ose, gjatë procesit të zhvillimit, bashkëshoqërohen, mbështeten, plotësohen me figura të tjera konkretizuese. Ndërsa, *personifikimi*, figurë tjetër mbizotëruese dhe mjaft shprehëse, kuptohet se është përherë dhe tërësisht i kapshëm nga cilësitë njerëzore përmes të cilave gjallërohet. Në fakt, nuk ka vetëm personifikime, por ka përfytyrime, pamje a tablo të tëra të personifikuara, nuk ka vetëm sisteme personifikimesh të mbyllura në një krijim, por ka një vijimësi të gjatë, që formon tërësinë e madhe të personifikimeve, të cilët bartin mjaft mendësi popullore, sepse nën pushtetin e tyre janë përfutur, sikurse bartin edhe mjaft përfytyrime poetike popullore, sepse prej tyre janë ushqyer. Shkalla e parë, pra, më e zakonshme, është animizimi dhe personifikimi i tokës, natyrës, stinëve të vitit. Natyra krejt është e personifikuar, meqë në të është mishëruar puna e njeriut, por edhe, ngaqë ajo është pjesë e ndjeshmërisë dhe e dashurisë së tij. Duke qenë figurë kaq gjallëruese, personifikimi është edhe mënyrë e rëndësishme e poetizimit apo estetizimit të këtyre dukurive nëpër një proces rritës që shkon nga e rëndomta tek e bukura, nga e bukura tek e madhërishmja, nga utilitarja tek mitizimi, mitikja.

Personifikimi është në gjymtyrët dhe në shestimin tërësor të lirikave kushtuar stinëve. Vjeshta, p.sh., më e kënduara, merr shëmbëlltyrën e begatores, të një gruaje fshatare të palodhur dhe të madhërishme ose përngjan me femrën joshëse që e tërheq unë-in poetik pllajave dhe vreshtave ("Mendime në vjeshtë"); gjetiu ("Rapsodi vjeshte") është grua lakmitare, e ngarkuar me prodhimet e veta, që shndërrohet edhe në nënë a gjyshe fisnike që i fton kalimtarët të shijojnë frutat e saj; stina e begatisë është amvisë, dado ("Peisazh në fund të vjeshtës") që lan tokën me gjymat qiellorë të shiut, por ("Nën mollë") edhe vrapon si fshatarja e ngutur në mbrëmje që të arrijë sa më parë në shtëpi.

Të personifikuar gjerësisht janë edhe dimri, pranvera, vera. *Pranvera* shëmbëllen me gruan që del nga vorbullat e suferinës,

vajzën e ekzaltuar që puth tokë e qiell, zanën që ngjall ushtrinë e barit me ushta. *Dimri* është kreshnik që nënshtron gjithçka nën pushtetin e tij të akullt, është strateg që tund ngadhënjeshëm flamurin e lavdisë të të ftohtit, është poet i zhurmshëm, por, që shterr kur vjen pranvera etj. Animizimi dhe personifikimi si përftesë poetike përfshin edhe dukuritë atmosferike, bimët e pemët, produktet bujqësore duke e kthyer mjedisin natyror në botë të njerizuar.

2. Lirika pikturë

Lirika agolliane, me shprehjen e saj vazhdimisht konkretizuese, përbëhet dhe përcaktohet nga *figura imazh*, nëse do ta marrim plotësisht të vërtetë thënien e Marmontel-it se imazhi është "velloja lëndore e një ideje".⁴⁾

Ndryshe nga figurat e tjera që shënojnë një hapje, një largësi, imazhi ndjell një afërsi të madhe mimetike, afron një paraqitje besnike, të ngjashme me gjedhen e zanafillës së vet.⁵⁾ Prandaj, e ndërtuar jo me metonimi, sinekdoka, metafora etj. të zakonshme, por me imazhe të tilla, metonimike apo metaforike, ajo është një lirikë tepër konkrete dhe mjaft e receptueshme.

Poezia "*Pelegri*" është gjedhe e përkryer e forcës së madhe figuruese të imazhit, e ndikimit të fuqishëm e mbresëlënës të tij. *Idealisti* i zhgënjyer dhe i dështuar, por që ende kërkon shtegun e së vërtetës, konkretizohet me një sistem të pasur imazhesh. *Idealisti* gjallërohet shumë, së pari, përmes shëmbëllimit me *pelegrinin*, d.m.th. me udhëtarin që është nisur për në vendin e shenjtë. Vetë *pelegri* është simbol universal i besimtarit pa mëdyshje, që, pavarësisht nga rrethanat, vështirësitë, largësia kohore dhe hapësinore etj. mendon se do të mbërrijë patjetër, qoftë edhe duke vdekur. Ky është imazhi kryesor i poezisë. Imazhet e tjerë, sidomos sistemet e tyre të veçantë që lidhen ngushtësisht me njëri-tjetrin dhe, më tepër me imazhin kryesor - *pelegrini*, e pasurojnë, e zhvillojnë atë. Mendimet, ndjenjat, pasionet, trazimet, vuajtjet e *pelegrinit*, të

gjithë përbërësit abstraktë, intelektualë dhe shpirtërorë të tij marrin një veshje, një vello a një "brendi lëndore".

Meqë *idealisti* është *pelegrin*, ideali i tij është *një tokë e premtuar*, është një *vend*, një pikë e largët në hapësirën e pafund, por *shpresa* e tij ka qenë *e brishtë, e qelqtë*, e cila, nga tronditjet e mëdha është *thyer*:

Unë jam prej kohësh pelegrin,
udhëtar në vendin e shpresës së thyer,

Premtimi, porosia, e lënë prej stërgjyshërve, është lëndë me peshë të rëndë, prandaj e *bart në kurriz* dhe, po ashtu, *premtimi, porosia* është *hi*, hiri i trupit dhe i dëshirave, aspiratave të paraardhësve gjyshër, e vetja dëshmi e qenies tyre të dikurshme:

Unë jam prej kohësh pelegrin,
Shtegtar i karvanit të humbur
Dhe bart në kurriz një premtim
Të dhënë në *hirin e gjyshërve* të mundur.

Shkaqet e dështimit kanë marrë trajtën e dukurive të papërbalueshme të motit. *Orientimi i humbur, drejtimi i gabuar janë shtigjet e gërryera* nga moti, ku karvani i idealistëve është *tretur* në rrethanat shoqërore shkatërrimtare: mes *vapës*, mes *shiut e të ftohtit*. Vështirësitë e mëdha të ribashkimit e të gjetjes së drejtimit të përpiktë kanë marrë trajtën e relievit gjeografik mezi të kapërcyeshëm. *Pelegrini i kërkon bashkidealistët në rërë, në shkretëtirë*, dhe, në *shpat*, në thepin e historisë:

Jam ndarë pa dashur nga karvani im
Mes shtigjeve nga vapa e shirat gërryer.
Kërkoj karvanin tim në rërë e në shpat,
Karvanin që e ka ndërruar drejtimin me kohë,
Ndaj në udhë jam krejt i humbur, jam fillikat
Me shami të grisur lidhur në kokë.

Portreti i pelegrinit përbëhet nga shenjat, gjurmët fizike, nga damkat që kanë lënë vuajtjet shpirtërore dhe cflitjet trupore. Portreti

është një shifrim i shpirtit të tij. *Dhimbja e pafund e humbjes i shteri lotin*, i prishi *syrin* që qan papushim: nga zjarrmia e etheve, e *trazimeve të shpirtit* që kërkon të vërtetën dhe nuk e gjen. "*buza ime u dogj u bë zhur*". *Shamia* - qefin, e lidhur në kokë, madje e grisur si flamur i betejave të humbura është *simbol i idealit tragjik, i besimit dhe i fatit tragjik*.

Kurse faktet konkrete të udhëtimit tepër të vështirë të pelegrinit zmadhohen dhe stërzmadhohen, gjallërohen me anë të hollësive për të qenë sa më të kapshëm. Bashkidealistët nuk formojnë grup a armatë, por, pikërisht, një *karvan*, një rresht të gjatë qeniesh të pandërgjegjshme:

Kërkoj *karvanin* tim në rërë e në shpat.

Fjala *karvan*, e pranëvënë me fjalën *rërë*, në mënyrë asociative afron imazhin e karvanit të deveve në rërën e shkretëtirës, aq më tepër që vendet e shenjta, qoftë për myslimanët, qoftë për të krishterët, janë në kontinentin e shkretëtirës më të madhe që përshkohet nga karvani i deveve të bindura, të palodhshme, tepër të qëndrueshme dhe me pak kërkesa për të mbijetuar. Në shkretëtirën e historisë, pas apokalipsit të komunizmit, mijëra idealistë e humbën drejtimin, u kthyen në turmë a në karvan, sikurse mijëra të tjerë u shpërbënë, u tretën. Ky sistem i pasur imazhesh, në fund të fundit, fokuson vetëm një, imazhin kryesor, atë të idealistit stoicist-*pelegrinit*.

Në këtë mënyrë, po kaq konkretizuese, është krijuar *imazhi i atdheut vendlindje, i traditës vendlindje, i jetesës popullore auktoktone vendlindje*. Nocioni abstrakt i atdheut, i përbashkët, pra, i njëllotjtë për të gjithë poetët shqiptarë, individualizohet me të dhënat etnografike e historike, të relievit gjeografik, me fakte të jetesës, të punës në vendlindjen e poetit, që janë të veçanta. Vendlindja e intimizon atdheun përmes bëmave dhe kujtimeve vetjake të fëmijërisë, shkollimit, dashurive të humbura ose të rigjetura, mallit të përhershëm për të etj., që janë pasuri intelektuale dhe shpirtërore e poetit. Një atdhe i tillë është në qenien e secilit, jetik, intim, i dashur,

i shtrenjtë, i pazëvendësueshëm dhe i shenjtë si vendlindja.

Poeti filozof në "Fjala gdhend gurin" është *gurgdhendës*, prandaj fjala e tij nuk mbetet në eter, as nuk mbetet vetëm në letrën e butë të librit, ajo skalitet me penën - daltë në gurin e kohës, në një nga materialet më të qëndrueshme përballë gërryerjeve të rrjedhës së kohës. Në "Fshehtësitë e qiririt" është krijuar imazhi *qiri* (mbështetur në poezinë e Naimit) i *idealistit të vetësakrifikueshëm*, që ndriçon duke u tretur (punuar) dhe duke qarë (vuajtur); imazhi *lypës* i intelektualit të zbratur, pa veprimtari e pa krijimtari, që kërkon, lyp mjerueshëm vetveten, jetën e vet, të bjerrë pa asnjë dobi; *jeta - guvë*, banesa shpellë e njerëzve, njëlloj si në kohët parake, ashtu dhe në kohët moderne, ku bashkëjeton gjithmonë djalli dhe engjëlli, Juda dhe Krishti; *jeta, bota njerëzore-zuskë*, grua e pamoralshme, e ligë, bushtër që tërheq zagarët qejflin; *ankthi i pritjes - iriq; pikëllimi - mi; trishtimi - hije që të than e të venit; mjerimi - mur që të shtyp dhe të dërrmon; shoqëria e shpërbërë - gërmadhë, shpirti i çmoralizuar po ashtu gërmadhë; ëndrra e djegur - Saharë; fillimi i çdo dite - derë e hapur; fillimi i çdo nate - kanat i mbyllur etj.* Kështu, konkretizohen vizualisht, në mënyrë pamore, me anë të imazheve një mori e pafund idesh, dukurish abstrakte, nocionesh filozofike, historike, morale, estetike, gjendjesh emocionale shpirtërore, procesesh intelektuale, etj. Prandaj lirika e tij, receptohet, kryesisht, nëpërmjet imazheve pamore dhe, po ashtu, ndikon dhe mbetet në vetëdijen e lexuesit.

Me këto tipare lirika e Dritëro Agollit është pikturë e fjalës,^{6, 7)} sepse e bën të dukshme, pamore atë që thotë. Imazhet e saj jo vetëm përvijojnë "relievin pamor" të ndjenjave e të mendimeve, por edhe e zgjojnë atë me ngjyra, tone e nuanca nga më të larmishmet, krijojnë peisazhe, portrete njerëzore të gjalla tek të cilët nëpërlexohen cilësitë intelektuale shpirtërore të tyre.

3. Kulti i ruajtur i bukurtingëllimit

Larmia e madhe e vargjeve, rimave, strofave, llojeve poetike, bukurtingëllimi i pakrahasueshëm përbëjnë një nga vlerat estetike

më të mëdha të saj, kurse, në tërësinë e poezisë shqiptare janë, padyshim, një pasurim i disanshëm dhe riperdorim tërësor i metrikës së saj. Dhe kjo, kur vargu i rregullt metrik u levrua përherë e më pak deri në shpërfillje, jo aq për shkak të risimit dhe të çlirimit të tij, se sa për shkak të manive dhe të paaftësisë. Ndërkaq, është ndër të rrallat, në mos e vetmja në ditët tona që ka ruajtur kultin e bukurtingëllimit, duke vazhduar me këtë parim të lartë klasik, trashëgiminë e Mjedjes, Nolit dhe Poradecit. Madje, në llojin e vet, nuk mund të kuptohet pa harmoninë e gjithanshme të cilësive poetike dëgjimore: ritëm, rimë, varg i rregullt metrik, asonancë, konsonancë, aliteracion etj., nuk mund të kuptohet, pra, pa atë që mund të quhet imazhi dëgjimor. Poeti thotë *"nëse mungon muzika në varg, merr fund poezia"*, prandaj me vetëdije është përpjekur *"për rikthimin e melodizmit në varg, një melodizëm kompleks: ritëm, rimë, asonancë, aliteracion, tingull dhe ngjyrë"*. Për të, Ndre Mjedja dhe Lasgush Poradeci *"janë mjeshtra të muzikës së vargut shqip. Në poezinë shqiptare për muzikalitet askush nuk krahasohet me ata."*⁹⁾

Bukurtingëllimi në të krijohet në dy mënyra që plotësojnë njëra-tjetrën. Si në çdo poezi të rimuar, përftohet, së pari, prej asonancave, konsonancave dhe rimave, të cilat janë të shumta dhe të llojlojshme. Gjithashtu, përftohet prej aliteracioneve, që janë po aq të shumtë dhe të llojlojshëm. Nëse asonancat, konsonancat dhe rimat japin bukurtingëllimin fundor, d.m.th. në fund të vargjeve, aliteracionet japin bukurtingëllimin e brendshëm, d.m.th. në trupin e vargut, me shtrirje, natyrisht, më të gjatë, prandaj edhe me shprehësi më të madhe. Në mjaft lirika, po edhe në strofa, distikë e vargje të veçantë të tyre, gjen disa aliteracione, një varg ose një denduri aliteracionesh dhe, në jo pak prej tyre, në nivelet më të epërme të poezisë shqiptare.

Aliteracionet janë me bashkëtingëlloret më të ndryshme, megjithatë, parapëlqimi më i madh është për bashkëtingëlloret: **k, p, b, d, dh, t, g, gj, s, sh, r, rr, f**, etj. që edhe në vetvete shquhen për forcën jehuese. Me një sërë syresh janë krijuar perla të

bukurtingëllimit në lirikën shqiptare. Funkcionet e tyre janë të ndryshme: thjesht për bukurtingëllim, për jehona imituese që prirën të përngjasojnë me dukuri dëgjimore të natyrës dhe, për të theksuar një kumtim. Aliteracioni që ka funksion parësor theksimin e kumtimit mund të quhet edhe i kushtëzuar, pasi i nënshtrohet drejtpërdrejt brendisë. Zakonisht, formohet duke përdorur në një varg apo strofë, në disa vargje a strofa, *fjalë që kanë tinguj të përbashkët me ndonjë nga fjalët që bart kumtimin kryesor të poezisë*. Përsëritja e tingujve të njëjtë brenda vargut, strofës apo poezisë dallon njëherësh prejardhjen e aliteracionit, pra, fjalën prej nga janë zgjedhur tingujt, si dhe kumtimin e rëndësishëm të kësaj fjale. Të këtij lloji janë edhe aliteracionet në "Peisazhi i rrugës". Mendimi i poezisë *se njeriu piqet në rrugën e jetës* kalon nëpër katër fjalë kryesore: **djalë i vogël, rrugë, burrë**. Edhe aliteracionet kryesore e kanë prejardhjen tek tinguj të këtyre fjalëve, pikërisht, tek disa nga bashkëtingëlloret më kumbuese të tyre. Kështu, **d**-ja (djalë) del gjashtëmbëdhjetë herë dhe **g**-ja (i vogël) tetëmbëdhjetë herë, e cila përforcohet prej **gj**-së nëntë herë që është bijë e saj. Ndërsa **rr**-ja (rrugë, burrë), megjithë përdorimin e kufizuar në shqipe, është shtatë herë. Por rrallësia e saj plotësohet me **r**-në që është mëma e vet dhe del tridhjetë herë. Përdoret dendur **u**-ja (rrugë, burrë) që del tridhjetë herë, pa llogaritur grupet e përafërta: **-ga, -nga, -gë, -gu, -gur, -unë, -rru, -fu, -ur, -tu, -tor, -urtull, -uthull**, që luajnë rol jo të vogël bukurtingëllues. Aliteracionet krijojnë imazhin dëgjimor të një **-u- u- u- u-** je të vazhdueshme: rruga - udha dhe të një oshëtime tronditëse, rrokullisëse, të përbërë nga përzierja: **d, g, gj, rr, t, n, g**, etj., -vështirësia e të ecurit në rrugën e jetës:

Vështroj nga dritarja tek rruga fundoset në vapë,
 Tek ecën një djalë i vogël nga dielli përzhitur
 Tek ngjit të përpjetën e gjatë
 Dhe krahët tund si degë e kokën e mban ngritur.

Ec, o djalë i vogël, i djegur nga gushti.

Ec e rrugën e largët si pelë zbutë.

Në poezi të tjera ka aliteracione me tinguj që nuk janë në përbërjen e fjalëve kryesore. Këta kanë, zakonisht, efekt thjesht bukurtingëllues ose imitativ:

Dhe zë kërcet kurrizi në karrike.

Në tavolinë shuhet një çibuk:

Dhe kulmi i kafenesë si kaikë

Mes degëve të rrapit humb si muzg.

Aliteracionet: **kër-, kurr-, karr-, rra-** janë riprodhim i kërcitjes, i **kërr-, -kurr-, karr-**it të karriges dhe të kockave të lashta të veteranëve që poetizohen në poezinë "Pleqtë e qytetit tim".

Aliteracionet e parreshtura krijojnë serinë e imazheve dëgjimore, krijojnë një bukurtingëllim madhor që e afron lirikën e tij me muzikën.

Afri me poezinë popullore, bartje e përbërësve të saj

Përtëritëse e traditës është poezia e Dritëro Agollit edhe në integrimin e folklorit. Duke përthithur me etje shkollën e Rilindjes Kombëtare dhe të periudhave të mëvonshme, sidomos shkollën e Çajupit, Poradecit, e, mbi të gjitha atë të Naim Frashërit, duke tërhequr në vetvete përvojën e vyer bashkëkohore, është kthyer në sintezë të traditës kombëtare në këtë lëmë, pra, edhe në shkollën e saj më të fundit. Me "fytyrën" e vet folklorike është gjedhja më tipike bashkëkohore. Ajo, krahas bartjes së përbërësve folklorikë më të ndryshëm, e zakonshme në veprën e poetëve shqiptarë më të mëdhenj, ka edhe disa *afri* dhe *ngjashmëri* me të, që e bën të veçantë, jo të zakonshme në poezinë shqiptare. Afritë janë prej mbështetjes në folklor, por janë edhe të vetvetishme. jashtë ndikimit të tij. Sidoqoftë, edhe në rastin e mbështetjes në folklor rëndësi ka *afria* që është krijuar me të, që është fryti i saj.

Afria, para se të vijë prej mbështetjes në poezinë popullore, prej integritit të përbërësve të saj, është përcaktuar nga *tipi i poetit*, individualiteti, funksionimi krijues i tij. Individualiteti i tij punon e krijon vetëm nëpërmjet marrëdhënieve të drejtpërdrejta me jetën shoqërore. Krijimtaria e tij zë fill vetëm në ato ngjarje, ndodhi e gjendje shpirtërore që autori përjeton drejtpërdrejt, d.m.th. është i pranishëm fizikisht dhe pjesëmarrës në to shpirtërisht. Në këtë pikë, s'ka se si mos të të kujtojë poetin popullor. Jo vetëm poetin popullor, por edhe Robert Bërnsin, bardin dhe poetin e famshëm skocez, të cilin e adhuron, e ka shqipëruar dhe përshtatur. Madje të kujton edhe Gëten. *"Të gjitha poezitë e mia, thotë Gëtja, janë poezi "me rast", kanë marrë shkas nga realiteti, prej tij e marrin burimin dhe lëndën. Poezitë që ngjizen me ajër për mua s'vlejnë asnjë grosh... Kjo është pikërisht epërsia e gjinive të vogla, se ke mundësi të zgjedhësh dhe zgjedh atë që njeh, atë subjekt që e ke tëndin."*⁹⁾

Tipi i tillë i poetit, mënyra e krijimit të tij përfton në vepër disa tipare të ngjashme ose të afërta me të poezisë popullore, sikurse janë konkretizimi i madh, individualizimi i hollësishtëm, shprehja poetike e drejtpërdrejtë, plotësisht e hapur dhe e qartë, funksionimi i mekanizmit figurativ mbi përngjasimin me dukuritë, kryesisht, lëndore dhe me objektet më të përdorshëm prej njeriut të punës prodhuese, ndërputja e disa veçorive të ligjërimit bisedor në ligjërimit poetik etj.

Afria me të vjen, po aq, nëpërmjet mendësive të shumta filozofike, etike, estetike, të përthithura në jetën e gjallë popullore dhe në folklor, si dhe përmes qëndrimeve emocionale, ideore a morale, trajtimeve poetike, figurimeve që ato kanë dhënë, të cilat lenë "gjurmë" të forta të modelit dhe të modelimit popullor. "Gjurmët" popullore trashen me motivet, vargjet, mekanizmat e caktuar të figurshmërisë, figurat, llojet e vargjeve, thekseve, rimave, intonacioneve si dhe të një fjalori të tërë të huajtur prej poezisë popullore. *"Unë, sqaron autori, erdha në poezi nga kënga popullore, nuk erdha nga librat. Pastaj hyra në*

libra. Poezinë popullore, përrallën, humorin dhe të gjithë kulturën popullore nuk e mësova, por e jetova. Në fillim unë shkruaja si populli¹⁰⁾

Mendësitë popullore, të shpërndara kudo si lëndë shndërruese dhe rrezatuese, herë janë në rol kryesor dhe herë në rol dytësor. Në plot lirika, mendësia popullore nuk është thjesht një përbërës, aq më pak dekorativ, pasiv, por është vektori orientues i qëndrimeve emocionale, ideore, morale, estetike. ndërkaq, në plot të tjera, ajo mbizotëron, d.m.th. përcakton krejtësisht vlerësimet përkatëse, sidomos për dukuri dhe koncepte themelore të jetës, për njeriun, punën, atdheun, botën njerëzore, moralin, virtytin, vesin, natyrën etj.

Koncepti agolljan për të bukurën. koncepti themelor estetik *zbulon shpesh mendësinë popullore, e cila shkrin në një të dobishmen, të mirën, të moralshmen, të virtytshmen me të bukurën.* Këtë e shpreh edhe barazvlera e fjalëve *i, e mirë dhe i, e bukur* që, në poezitë e tij, shpesh janë sinonime poetike.

E bukur është *puna*, me tërë llojet e saj më të vështira, gjithçka që mban vulën e mendjes dhe të dorës njerëzore: fushat, arat, ugaret, vreshtat, *prodhimet bujqësore*, veçanërisht gruri - simbol i punës së ndershme dhe i jetës së shëndetshme apo qumështi - simbol i përtëritjes dhe i mirëqenies, i pastërtisë morale; *bimët dhe kafshët*, shpendët, shpezët, insektet, veçanërisht kafshët bujqësore: lopa, kali, që ngrihen në shkallën e bukurisë sublime. E bukur është *natyra*: toka, deti, malet, shkrepat, bregdeti, pyjet, shkëmbenjtë, përrenjtë, gurët e drurët, të gjitha ato që përbëjnë atdheun, Shqipërinë. Ajo që është e mirë dhe e dobishme vetvetiu është edhe e bukur. Prandaj janë të bukura edhe duart e bujkut, duart e çara të punëtores që përkëdhel të dashurin, pragu i vjetëruar i shtëpisë atërore, rrobat e grisura të fëmijërisë, balta që ngjitet në këpucë, guri i vendlindjes, madje edhe kur e pengon dhe e rrëzon.

Bukuria njerëzore, *zakonisht, është në botën shpirtërore, e cila harmonizohet me bëmat trupore dhe aftësitë fizike.* Gratë janë të

bukura për dashurinë që u falin burrave, për ngrohtësinë shpirtërore dhe mirëkuptimin që kanë me ta, për ndjenjën e amësisë, por edhe për aftësitë fizike në punë. Gruaja apo e dashura është domosdoshmëri shpirtërore dhe jetike, liman qetësie, çlodhjeje dhe prehjeje shpirtërore, është prehër përkëdheljeje dhe ngushëllimi pas mundimeve të jetës. Gruaja apo e dashura ideale është femra e shëndetshme (krejtësisht popullore në këtë rast), se shëndeti është jo vetëm rrënja e trëndafilut të bukurisë, por edhe rrënja e pemës së madhe të aftësisë për të punuar dhe përballuar jetën. Energjitë trupore i përtërijnë ato, sikurse përtërin pranvera natyrën dhe, kështu, mbeten të njoma e të hijshme. Gratë, siç janë të bukura, janë edhe të virtytshme, por më tepër janë të mira dhe të domosdoshme, sepse janë njëri pol i magnetit të familjes, të dashurisë. Edhe kur nuk konkretizohet, bukuria shpirtërore e grave ose e figurave të tjera njerëzore, ajo, nënkuptohet, meqë dihet se njeriu i punëve të mëdha, sikurse është femra, gruaja, nëna, e dashura, është edhe me ndjesi të mëdha. Ndofta, kjo është arsyeja që, vende - vende, bota e njeriut të punës prodhimtare, ndjenjat dhe mendimet e tij nuk paraqiten drejtpërdrejt, por mishërohen në punën, në veprën e tij.

Mendësia popullore, që njëson të dobishmen me të bukurën, më theksueshëm shfaqet në trajtimin e natyrës, të motit, stinëve dhe të dukurive të tyre si shiu, dëbora, era, bubullima, stuhia, të ftohtit, të nxehtit, të cilat paraqiten të bukura dhe të madhërishtme jo thjesht nga harmonia e ngjyrave dhe e tingujve, nga simetria e formave dhe e përmasave, por sidomos nga dobishmëria. Për këtë arsye, e njëjta dukuri, që në një rrethanë kohore të caktuar është ose paraqitet e bukur apo e madhërishtme, në rrethana të tjera paraqitet e shëmtuar. Në "Peisazh në fund të vjeshtës" dimri shëmbëllet me prindin e kujdeshëm, i cili e mbulon tokën me çarçafin e bardhë të dëborës, që mos të ftohet. Në "Dëbora e pranverës", dëborës i janë zbehur cilësitë e bukura, prandaj përshkruhet si një rrobë e vjetëruar që e grus pranvera me ushtrinë e gjelbër të barit. Dimri, në një poezi tjetër,

“Çerdhet e zogjve në dimër”, është plak cinik e shkatërrimtar, meqenëse zhvesh pemët dhe detyron zogjtë shtegtarë të braktisin foletë. Me mendësinë popullore, vjeshta është stina më e kënduar dhe më e himnizuar, është gjithmonë e bukur dhe e madhërishte, por asnjëherë e shëmtuar, e egër, e keqe. Paraqitet e tillë ngaqë është stina e artë e prodhimtarisë, mbretëreshë e begatisë, me lëvizje të mëdha dukurish atmosferike e vajtje-ardhje njerëzish, natyrisht, edhe me larmi, përsosmëri ngjyrash e tingujsh. Njësimi i të dobishmes me të bukurën ndikon edhe në krijimin e disa përfytyrimeve a figurave “të specializuara” që përputhen, janë fort të përshtatshme me të. Personifikimi i vazhdueshëm i stinëve dhe i dukurive të tjera të motit, pra, njerizimi i vazhdueshëm i tyre është fryti kësaj mendësie. Të personifikuara paraqiten, zakonisht, ato edhe në figurimin popullor. Sikurse shihet, nuk janë të gjitha të bukura ato që paraqiten për të tilla.

E bukura në vështrimin e Dritëro Agollit ka rreze “mbuluese” të jashtëzakonshme. Një mori dukurish të rëndomta dhe prozaike, në mekanizmin tepër veprues të *estetizimit* shndërrohen në të bukura. Ky mekanizëm ushqehet, pikërisht, me mendësinë popullore që njëson të moralshmen, të virtytshmen, të mirën, të dobishmen me të bukurën. Pra, *estetizohen, bëhen të bukura, ngrihen në shkallën e vlerave estetike* dukuritë që janë vetëm të moralshme, të virtytshme, të mira, të dobishme. Me këtë “retinë” në syrin estetizues, fusha e poezisë është e pafundme, çka shpjegon, në një pikëpamje, edhe pasurinë dhe larminë e madhe të saj.

Thujtja e *një fjalorthi të pasur të ligjërimin bisedor*, e afron edhe më poezinë e Dritëro Agollit me poezinë popullore, pavarësisht se mund të jetë fituar ose jo nën ndikimin e saj, pasi mund të jetë edhe prej ndikimit të poezisë së shekullit tonë. Ajo tërheq, gjithashtu, shprehje popullore nga më të ndryshmet. Shprehjet e lira jofigurative si falenderimet, përshëndetjet, urimet, mallkimet, shprehjet sqaruese, fjalët e urta dhe veçanërisht shprehjet e ngurtësuar figurative,

frazeologjizmat vijnë natyrshëm në të, se janë konkretizimi gjuhësor i një parimi themelor të saj - njësimi i unë-it poetik me receptuesin, që, do të thotë se ligjërimi i unë-it poetik të jetë sa më afër ligjërimin bisedor. Frazeologjizmat janë më të pëlqyerat për vetë vlerat e mëdha diferencuese, emocionale dhe shprehëse¹¹⁾, por përdoren në mënyra të ndryshme: në formën e rregullt burimore, të përpunuara lehtë, pjesërisht ose të tjetërsuara, duke ruajtur skemën dhe logjikën metaforike të tyre. Me funksionalizimin e skemës metaforike të frazeologjizmës ligjërimi poetik merr shprehësi të madhe. "Brendia" e vjetër e frazeologjizmës është tani, nëntekst i ligjërimin poetik, e pashkruar, por e pranishme siç është metafora e ngurtësuar e saj një kontur figurativ asociativ, përçark tij. Kështu, ligjërimi poetik, bashkë me ngjyresën e fjalës, merr edhe ngjyresën e figurës, të logjikës metaforizuese popullore. Prandaj, më e rëndësishme, më e veçantë se mbështetja është afria e tipareve të kësaj poezie me poezinë popullore.

Poezia - biografi e poetit

Lirika e Dritëro Agollit, si e asnjë autori tjetër shqiptar, ndofta, të rralla janë dhe në letërsi të tjera, ka të dhëna biografike të shumta, herë të njohura e lehtësisht të identifikueshme, herë më pak të njohura dhe të identifikueshme më me vështirësi. Ajo e ka vulën e biografisë së krijuesit të vet në dy trajta: a) në trajtën e zakonshme, pra, të gjendjeve shpirtërore të poetit, që, padyshim, në tërësinë e tyre, formojnë biografinë shpirtërore të tij, dhe b) në trajtën e pazakonshme, pra, të ndodhive e situatave vetjake, të të dhënave të jetës e të veprimtarisë që formojnë biografinë "historike" të tij, por që, në lirikën e autorëve të tjerë lenë pak gjurmë.

Gjendjet shpirtërore të kapshme, që janë burim i poezisë, i emocioneve dhe i mendimeve, provojnë, tek e fundit, përkatësinë e saj gjinore, d.m.th., që është lirike dhe vazhdimisht lirike, përderisa

lirika kuptohet si shprehje e ndjenjave që poeti provon realisht në rrethana të jetës së tij. Mirëpo, këto gjendje shpirtërore gjurmëlënëse shoqërohen me përbërës të shumtë të "biografisë historike". Kështu, në të ka të dhëna për mjedisin dhe kohën e lindjes së autorit, për fëmijëri - adoleshencën dhe pleqërinë, për arsimimin, kulturimin dhe përsosjen letrare, për shijet estetike, për familjen, të afërmit, miqtë, kolegët, rrallë dhe kundërshtarët, endjet nëpër atdhe (dhjetëra toponime) dhe në botë - me ndodhi e anekdota, për bindjet shoqërore, polemikat politike a debatet letrare, vështirësi të procesit të krijimit, për veçori të karakterit e temperamentit, pëlqimet e përditshmërisë, gjendjen ekonomike dhe mënyrën e jetesës, etj, etj. Konkretisht: "Këtej ju njoh me fshatin tim Menkulas...", "Nëna ime, e bukura Hatixhe", "Rrugicën e shkollës/ unë prapë e marr,/ tani burrë i pjekur, tridhjetëvjeçar", "E ku ta linja një lanete,/ Një xhinde Shkodre, një kaproll", "Dhe si Sokratin plak, më shan Sadija (e shoqja), "Unë e çmova si ju dhe pas gjurmëve e ndoqa Naimin./ Ai ma pushtoi dikur si shënjtë shpirtin tim dhe mendimin", "Jam në bulevardin *Monparnas* / Dhe me vete fjalë frënge flas"(Paris), "Vajta në *Stamboll* të bëj pazar", "Çast në Norvegji", "Në një tavernë atje në Romë, Më hodhi era tek një prift"; "Edhe unë e njoha fatin herët/ Nga kjo njohje sofrë pati bukë,/ veçse më dalloj pak nga të tjerët/ Më dha kalë e fre, më la pa rrugë, etj.

"*Jeta personale, shkruan Dritëro Agolli, luan një rol të madh në krijimtarinë e poetit*"¹²). Natyrisht, nuk është vetëm jeta për vetveten, qoftë edhe në aspektin estetik krijues, por është jeta për të tjerët, sepse kjo lloj jete i shndërron përjetimet vetiake në përjetime universalizuese, përgjithësuese. "*Poezia e një poeti është biografia e tij*"¹³), shprehet gjatë në mënyrë aforistike. Me këto koncepte, sikundër edhe vetvetishëm, kanë vërsuar faktet dhe hollësitë biografike jo për egotizëm a egocentrizëm por nëpërmjet një përftese të posaçme të saj, e cila është e huazuar prej llojit të autobiografisë letrare. E drejta për të paraqitur veten, për të rrëfyer për jetën, për botën e vet mendore

dhe shpirtërore është, pikërisht, e llojit të autobiografisë letrare që njëson autorin, rrëfyesin dhe personazhin në jetën e shkrimtarit¹⁴. Prandaj poezia e tij rrjedh në shtratin e njësimin të autorit me unë-in poetik, dhe si e tillë, krahas projektimit të portretit të autorit, si dhe të shëmbëlltyrave të tjera që i ngjajnë, është edhe një lloj autobiografie, siç është edhe biografi e bashkëkombasve dhe bashkëkohësve të afërt me të. Me këtë përftesë parakuptohet besueshmëria e ligjërit poetik që mbushet me fakte biografike. E, për analogji, në mënyrë iluzive ligjërimi është po aq i besueshëm edhe kur nuk ka të dhëna biografike.

Përbërësit biografikë janë mjete përgjithësimi, universalizimi të mendimeve dhe të ndjesive të saj, dhe, po ashtu, janë fakte realë që e përcaktojnë dhe individualizojnë atë theksueshëm. Atë nuk e denatyrton as përmendja në vargje e emrit të përveçëm Dritëro Agolli, përkundrazi, e detajon në natyrën autobiografike. Befasia e futjes në vargje e emrit të autorit, edhe pse e zakonshme për letërsinë autobiografike, e thëllon karakterin lirik intim, ndërkohë që rrit emocionalitetin, natyrshmërinë dhe besueshmërinë e ligjërit poetik, duke thyer rregullin dhe duke përforcuar origjinalitetin. Madje ka edhe të dhëna biografike të tjetërkujt ose impersonale që janë "përvetësuar", janë *personalizuar*, janë *vetjakizuar* prej poetit, bie fjala, në motivet e luftës partizane, dashurore, politike etj. *Personalizimi*, *vetjakizimi*, nga njëra anë, është mënyrë e zgjerimit të fushës së saj lirike, përtej jetës së autorit, por, duke ruajtur gjithmonë zanafillën lirike, pra, domosdoshmërinë e të jetuarit dhe të përjetuarit të asaj që këndohet, dhe, nga ana tjetër, është një përftesë që emocionalizon, intimizon edhe atë që është larg ose jashtë poetit. Kjo krijon iluzionin sikur të gjithë ata për të cilët këndohet i ka takuar, sikur çdo vis e ka shëtitur, se çdo problem i trajtuar ka qenë i jetës së tij, shkurt iluzioni i besueshmërisë, vlerë dhe cilësi e saj, e vesh atë gjithandej.

Mundësia e funksionalizimit të tyre është në vetëdijen, në tipin e

poetit, në mënyrën e të përjetuarit të tij. Dritëro Agolli ka prirjen e vetvetishme të shkruajë nën shtytjen e gjendjeve shpirtërore, ndodhive, fakteve, problemeve dhe shqetësimeve të tij që kanë rreze të gjerë, që përshkojnë jetën, botën, interesat e shumë e shumë të tjerëve, që karakterizojnë një brez. një kategori shoqërore të madhe, një situatë, një aspiratë, një vuajtje. një pritje të përgjithshme, madje jo rrallë krejt kombin, bashkëkombësit, kohën. Atëherë edhe vetë autori rekëtin a pushon së qëni i veçantë, pushon a rekëtin së qëni Dritëro Agolli, dhe përjeton si shembëlltjërë e intelektualit idealist, misionar veprues, filozof, moralist e poet bashkëkohor. Me cilësi të tilla të *shoqërizueshme*, poeti njësohet me unë-in poetik, të dhënat e jetës së tij i kalojnë pa vështirësi unë-it poetik. pra, biografia e tij shndërrohet në biografi të përgjithësuar të të tjerëve.

“Askush prej nesh, shkruante Hygoi. duke shpjeguar marrëdhënjet midis poetit, unë-it poetik dhe të tjerëve, nuk ka nderin të ketë një jetë që të jetë e tij. Jeta ime është juaja, jeta juaj është imja, ju jetoni meqë jetoj unë; fati (jeta) është një. Merreni. ju lutem. këtë pasqyrë dhe shihni veten tuaj në të... Kur unë ju flas për veten, ju flas për ju. Si, pra, nuk e ndjeni?”¹⁵⁾


Marrëdhëniet e pandashme midis poetit dhe të tjerëve, shkrirjen në një të këtyre dy botëve në poezi, Hygoi i ka universalizuar duke thënë se të *pikturosh*, të *japësh me ngjyra unë-in e poetit do të thotë të pikturosh, të japësh me ngjyra krejt njerëzimin.*¹⁶⁾ Kështu, edhe Dritëro Agolli, duke kënduar veten, këndon të tjerët, duke shkruar biografinë e vet, shkruan biografinë e të tjerëve, bashkëmoshatarëve, bashkidealistëve, bashkëkohësve, bashkëkombasve. Lirika e tij paraqet përjetimet, aspiratat e mëdha të intelektualit bashkëkohor, dhe jo vetëm të autorit; nuk paraqet thjesht vendlindjen e tij, Menkulasin, por fshatin shqiptar tradicional e bashkëkohor, mendësitë e jetesës shqiptare, lidhjet e brendshme të një kategorie të madhe shoqërore, posaçërisht të intelektualit krijues me të etj.

Zhënjimi i madh që përshkon vëllimin “Pelegri i vonuar”, “Lypësi

i kohës”, “Vjen njeriu i çuditshëm” nuk është vetëm zhgënjimi i autorit prej komunizmit, nuk është pika më kritike vetëm e biografisë së tij, por është pika më kritike, zhgënjimi i madh në biografinë e mijëra shqiptarëve dhe të miliona të tjerëve nga popujt më të ndryshëm të botës. Pelegrinë të vonuar janë të gjithë idealistët që mbetën shkretëtirës komuniste.

“Zemra” krijuese e Dritëro Agollit që biografinë e vet e shndërron në biografi të të tjerëve dhe anasjelltas, i ka dhënë atij frymëzim të pashtershëm që të shkruajë gjatë, si asnjë poet tjetër shqiptar, prej djalërisë pasionante deri në moshën e bardhë, e ka mbajtur përherë rinor, plot energji e përkushtim, e, njëherësh, e ka ngarkuar plot me urti fisnike, duke e kthyer në Gëte të poezisë shqiptare.

Bashkim Kuçuku



Datat kryesore të jetës dhe të veprimtarisë së Dritëro Agollit

- 1931** (13 tetor) u lind në fshatin Menkulas të Devollit (Korçë).
- Rizai**, i ati (1891-1966) kishte qenë për një kohë të gjatë emigrant ekonomik në Buenos-Aires (Argjentinë) dhe në Çikago (ShBA) për shkak të borxheve të trashëguara nga i ati. Ai mori pjesë në Luftën Antifashiste, madje ishte dhe kryetar i Këshillit Antifashist të fshatit. Dinte përmendësh poezi të Omar Khajamit dhe të Naim Frashërit, që, për të, ishin më të bukurat në botë dhe asnjë tjetër nuk mund të shkruante ashtu.
- Hatixheja**, e ëma (1908-1986) ishte prej Helmësit të Kolonjës.
- 1938-1942** Dritëroi mori mësimet e para në vendlindje.
- 1943** është korrier i batalionit partizan *Fuat Babani*. Shpinte letra dhe njoftime të ndryshme, ushqime, veshmbathje etj.
- 1945-1948** vazhdoi shkollën në qytetin e vogël të Bilishtit.
- 1948-1952** ndjek mësimet në shkollën e mesme *Asim Zeneli* në Gjirokastrë. Kishte mësues Thoma Papapano, Vehbi Bala, Shaban Demiraj, Luigj dhe Arta Franja për të cilët do të flasë shpesh jo vetëm me admirim por edhe me krenari. Bashkënxënës të tij kanë qenë: Ismail Kadare, Agim Shehu, Bekim Harxhi, Pano Çuka etj. Për profesorët e përgatitur dhe dobitë e diskutimeve letrare të nxënësve të pasionuar, dikur është shprehur se "Shkolla jonë në Gjirokastrë ka qenë Akademi letrare". "Gjirokastra ishte porta e parë e madhe,

- 1947 thotë poeti. Atje zbulova botën dhe artin".
 boton për herë të parë në gazetën *Rinia*. vjershën *Vullnetari i hekurudhës*. Do të vazhdojë të botojë në *Rinia*. *Letrari i ri*, *Literatura jonë* etj., mirëpo ai ëndërronte të bëhej veteriner; për këtë degë kërkoi të ndjekë studimet e larta. Kahreman Ylli (ministër i arsimit) e dërgoi për studime filologjike dhe gazetari, pasi kishte lexuar disa nga krijimet e tij. Ky vendim, sipas poetit, ndryshoi krejtësisht jetën e tij.
- 1952-1957 ndjek studimet e larta në Sant-Petërburg (Leningrad).
- 1952 niset me vapor nga Durrësi në Odesa. Ndoqi studimet në Universitetin shtetëror *Zhdanov* në Sant-Petërburg (Leningrad). Ka banuar pranë lumit Neva, në *Mitninskaja Naberezhnaja 6*, Shtëpia e studentëve *Dom 6*. Profesor ka patur edhe albanologen e shquar ruse Desnickaja, si dhe studiuesin me famë botërore Propp, autorin e famshëm të librit *Morfologjia e përrallës*, të akuzuar për formalizëm. "Sant - Petërburgu është porta e dytë, shumë herë më e madhe për mua", shprehet ai. "Nga udhëtimet në Rusi bota m'u bë e pakufishme". U dha fort pas Pushkinit, Lermontovit, Çehovit, Tolstoit, Gogolit, Buninit, Dostojevskit etj., posaçërisht pas Bagrickit, të cilin filloi ta përkthejë në shqip. Në universitet u njoh me Ehremburgun, Shollohovin, Tvardovskin, Nazim Hikmetin, Jevtushenkon, etj.
 "Në Rusi, e desha më shumë Shqipërinë. E kuptova më thellë, d.m.th. dhe poetikisht pse Naimi në mërgim kishte shkruar aq bukur dhe me aq mall për Shqipërinë. Rusia, shpjegon ai, më bëri më shumë shqiptar".
- 1954 vjen me pushime në Shqipëri, pranë prindërve, por, tanimë, ata ishin vendosur në Sukth (Durrës).
- 1955 martohet me rusen e bukur Nina Novikova, me të cilën kishte rënë në dashuri. Ajo studionte për gjuhë angleze. U martuan në Bashkimin Sovjetik dhe bënë dasëm ruse.
- 1956 shtator u lind djali, Ariani.
- 1957 mbaron studimet shkëlqyeshëm. Atë vit morën diplomën

shkëlqyeshëm edhe dy rusë dhe një gjerman. Dritëro Agolli, së bashku me Ninën dhe Arianin e vogël vijnë në Shqipëri. Nina punoi mësuese e anglishtes në shkollën e mesme *Sami Frashëri*, pastaj në Shkollën e Bashkuar, Tiranë.

- 1957** fillon të punojë gazetar në *Zëri i popullit*.
- 1964** për shkak të prishjes politike të Shqipërisë me BS, e shoqja, Nina së bashku me të birin, Arianin, largohen përgjithmonë. Dritëroi i përcjell me dhimbje të shoqen dhe të birin në aeroport. Drama e tij intime më e madhe.
- 1965** martohet me Sadije Kecaj, lindur në Shkodër, më 1942 (14 shtator), gazetare dhe shkrimtare.
- 1966** (20 korrik) u lind vajza, Elona.
- 1967** shkon në Kinë. Poeti mendon se është fat i madh të shkosh në Kinë, sepse është një botë e madhe, e veçantë: edhe natyra, edhe jetesa, edhe arti, edhe historia (muri i madh kinez). Këto të krijojnë shumë asosiasione, të nxisin fantazinë edhe kur je atje, edhe më vonë. Për Kinën ka botuar poezi më 1972. Edhe në Kinë është botuar një libër me poezi të tij.
- 1969** (13 mars) u lind djali, Artani.
- 1971** shkon në Kongo, në kohën kur shkruante dhe botonte tek *Hosteni* romanin *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, të cilin vazhdoi ta shkruajë edhe atje. Kalimthi, për dy-tre ditë shkon në *Paris*. "Meqenëse kisha lexuar mjaft për Parisin, më dukej sikur kisha qenë, sepse Parisi është qyteti më i njohur në botë nëpërmjet letërsisë. Parisi është personazh në veprën e Balzakut dhe të shkrimtarëve të tjerë".
- 1972** është sekretar për letërsinë në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.
- 1972** shkon në Kosovë, në fillim në mbremjet e poezisë në Gjakovë, pastaj për të lidhur marrëveshje mes dy Lidhjeve të Shkrimtarëve.
- 1973-1992** është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të

Shqipërisë.

- 1974-1998** është deputet në Kuvendin Popullor.
- 1979** sërish në Kosovë bashkë me Shefqet Musaranë, Elena Kadarenë, Eglantina Mandinë dhe Zija Çelën
- 1980** shkon në Turqi ku u njoh dhe u miqësua me shkrimtarët e mëdhenj Jashar Qemal, Azis Nesin si dhe me shkrimtarë të tjerë me emër brenda dhe jashtë Turqisë, me të cilët ka patur letërkëmbime, dedikime etj. Ka qenë në shtëpinë e Jashar Qemalit dhe në çiflikun e Azis Nesinit në Stamboll. Afrimi shpirtëror me turqit, natyrisht, është më i madh si për shkak të lidhjeve të gjata historike, të njohjes më të mirë të traditave dhe zakoneve të tyre ashtu dhe për shkak se atje banojnë qindra mijëra shqiptarë. Prandaj ka shkruar një varg poezish, disa prej të cilave (*Turkeshja, Trëndafilat e turkeshës*) janë ndër më cilësoret.
- 1981** është ftuar në Itali për të marrë pjesë në një kongres për pakicat kombëtare në Hora të Arbëreshëve, ku mbajti edhe një kumtesë.
- 1983** shkon në Francë së bashku me Ismail Kadarenë, Piro Mi-shën dhe Dhimitër S. Shuteriqin. Në Paris, nën drejtimin e shkrimtarit, historianit dhe publicistit Eskarpit u zhvillua një kolokium për letërsinë dhe gjuhën shqipe me intelektualë francezë. Nga mbresat për Parisin shkroi poezinë *Në Monparnas*.
- 1987** bashkë me Androkli Kostallarin, Ismail Kadarenë, Nasho Jorgaqin e të tjerë u ftua në Palermo po në një kongres të pakicave kombëtare. Atje mbajti edhe një kumtesë. Në kongres ishte Martin Camaj, A. Dasnickaja, Ali Podrimja, Rexhep Ismajli, Gani Dobi etj.
- 1987** nga Italia, bashkë me Ismail Kadarenë shkon në Beograd dhe pastaj në Bor, në veri të Jugosllavisë, në një konferencë për nacionalitetet. Në Bor, u njoh me shkrimtarin e njohur serb Bullatoviç, nacionalist dhe antishqiptar.
- 1990** përsëri në Francë së bashku me Sadijen me rastin e botimit

në frëngjisht të romanit *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, i cili u mirëprit mjaft mirë nga kritika franceze. "Këtë herë, verifikova ato që kisha lexuar për Francën dhe Parisin, i cili nuk mund të kuptohet pa muzeumet e artit. Parisi është gërshetim i klasikes me modernen si asnjë qytet tjetër. As në Romë, vendi i artit të madh klasik, nuk është një gërshetim i tillë i klasikes me modernen. Muzeumet e mëdha të artit modern janë në Paris, siç nuk janë në Romë". Në Paris u njoh me Alen Boske, Domenik Fernandez dhe Fransua Nurisie.

- 1990** shkon në Turqi.
- 1992** shkon në Gjermani me një grup shkrimtarësh (Robert Shvarc, Fatos Arapi, Natasha Lako, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo) me rastin e daljes në gjermanisht të një antologjie të poezisë shqiptare. Atëherë ishte botuar në gjermanisht edhe *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* për të cilin u organizua një takim, që u shoqërua me interpretimin e disa pjesëve të zgjedhura. Po ashtu u zhvillua një bisedë me pjesëmarrjen e shkrimtarëve gjermanë, shqiptarë dhe bullgarë. Dritëro Agollin e intervistoi një gazetar nga ish-Gjermania Lindore.
- 1992** shkon në Norvegji, ku janë botuar shumë poezi të tij, si dhe romani *Komisari Memo*.
- 1994** shkon në ShBA së bashku me Sadijen. "Kur vete në ShBA e ndjen veten si të shtypur, shprehet poeti. Vendi i madh, puna e madhe, ushqimi, madje dhe pjatat e mëdha. Poetët shpesh fantazojnë kur shkruajnë për Nju Jorkun që është i zhveshur, vetëm me pallate dhe ndërtesa të larta. Atje ka shumë gjelbërim midis pallatave; në tarraca dhe ballkone të ndërtesave ka lule". Atje shkroi dy poezi.
- 1994** shkon në Itali pasi kishte qenë disa herë që në vitin 1967. Më 1994 shkon me rastin e botimit në italisht të romanit *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*.
- 1995** shkon përsëri në Kinë.
- 1996** shkon në Greqi. Në ishullin Salaminë organizohet një takim

i madh me emigrantët shqiptarë. Në Greqi shkon edhe më 1997 në një konferencë ndërkombëtare kundër racizmit, ku edhe diskutoi.

1998 qershor, shkon në Francë me rastin e aktivitetit tradicional për letërsinë *Les belles étrangères*, ku ishin të ftuar trembëdhjetë shkrimtarë shqiptarë. Me rastin e këtij aktiviteti, D. Agollit i ishin botuar dy libra në frëngjisht. *Zhurma e erërave të dikurshme* dhe *Njeriu me top* (libër xhepi) nga Shtëpia Botuese *Le serpent à plumes* (*Gjarpri me pupla*).

* Janë përdorur të dhëna edhe nga libri *Liriku i tokës, demoni i fjalës* i autorit Moikom Zeqo, Tiranë, 1996.

Libra me poezi të Dritëro Agollit

- *Në rrugë dola*, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1958.
- *Hapat e mia në asfalt*, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1961
- *Shtigje malesh e trotuare*, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1965
- *Mesditë*, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1969.
- *Pleshti*, poemë satirike, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1971
- *Nënë Shqipëri*, poemë, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1974
- *Fjala gdhend gurin*, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1977
- *Udhëtoj i menduar*, Shtëpia Botuese NAIM FRASHËRI, 1985
- *Pelegri i vonuar*, Shtëpia Botuese PROGRESI, 1993
- *Lypësi i kohës*, Shtëpia Botuese ENCIKLOPEDIKE, 1995.
- *Çudira dhe marrëzi*, Shtëpia Botuese TOENA, 1995
- *Vjen njeriu i çuditshëm*, Shtëpia Botuese DRITËRO, 1996
- *Shpirti i gjyshërve*, Shtëpia Botuese DRITËRO, 1996
- *Baladë për tim atë dhe për vete*, poemë, Shtëpia Botuese DRITËRO, 1997
- *Fletorka e mesnatës*, Shtëpia Botuese DRITËRO, 1998

Poezi të Dritëro Agollit janë përkthyer në shumë gjuhë të huaja: frëngjisht (1973, 1996, 1998), anglisht (1993), gjermanisht (1989), italisht (1995), në spanjisht, turqisht, greqisht (përkthyer nga poetja Rita Bumi Papa), në rusisht kur ishte student; një vëllim në Kinë (1972), një vëllim në maqedonisht (1998), suedisht, danisht, norvegjisht, serbisht, maqedonisht.

Shënime

1. Ilija Lëngu, *Aragoni-Agolli*, Drita, 17 prill 1994.
2. Philippe Van Tieghem, *Les Grandes doctrines littéraires en France*, 1974, faqe 183.
3. Dritëro Agolli, *Vjen njeriu i çuditshëm*, Tiranë 1996. Psthënie *Pa divorc; edhe të shkruash, edhe të jetosh*, faqe 241.
4. Etienne Souriau, *Vocabulaire d'esthétique*, PRESSES UNIVERSITAIRES DE FRANCE, 1990, faqe 857.
5. *Dictionnaire des genres et notions littéraires*, ENCYCLOPAEDIA UNIVERSALIS, Albin Michel, 1997, faqe 369-370.
- 6., 7. Roman Jakobson, *Huit questions de poétique*, 1977, faqe 150 etj.
8. Dritëro Agolli, *Baladë për tim atë dhe për vete*, DRITËRO, Tiranë, 1997, pasthënie, faqe 145; 144; 148.
8. Gëte, *Vepra të zgjedhura 4*, NAIM FRASHËRI, Tiranë, 1987, faqe 58.
10. Dritëro Agolli, *Jeta në letërsi*, NAIM FRASHËRI, Tiranë, 1987, faqe 265.
11. Jani Thomaj, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981, faqe 29.
12. Dritëro Agolli, *Jeta në letërsi*, Tiranë, faqe 271.
13. Po aty.
14. Sabri Hamiti *Vetëdija letrare*, Prishtinë, 1989, faqe 325.
15. Philippe Van Tieghem, *Les grandes doctrines littéraires en France*, faqe 183.
16. Philippe Van Tieghem, *Les grandes doctrines littéraires en France*, 1974, faqe 183, cituar sipas studiuesit.

Tryeza e lëndës

MË PRIT SE PO VIJ SHPEJT	7
Më prit se po vij shpejt	7
ZUSKA BOTË	9
<i>Judë e Krisht</i>	9
Hyjmë dhe dalim	10
Njerëzit	11
Moment	12
Pak nga pak	13
Ankimet	14
Inflacion në shpirt	15
Dyert	16
Në pritje	17
Qeni i braktisur	18
Heshtja	19
I harruari	20
Lypësi i kohës	21
Përpyekje e kotë	22
Pela	24
Zuska botë	25
Në vendin tim	26
Ndihmësi i Zotit	27
Dreqi i dreqërve	29
Guri i Shenjtë	30
Vjen njeriu i çuditshëm	31
Ligjërimi i ujkut plak	33
Lëvizja e madhe	34
Mbarim celulash	36
Një dem nën shi	37
Megjithatë nuk është e keqe jeta	38
Peizazhi i rrugës	39
Revolte ndaj pagjumësisë	40
Vitin tjetër	42
Lypsarët	43
Rosat e buta	44